Rruga e Arbërit

10 vjet gazeta Rruga e Arbërit

www.rrugaearberit.com GAZETË E PAVARUR. NR. 6 (122). QERSHOR 2016. ÇMIMI: 50 LEKË. 20 DENARË. 1.5 EURO.

ANALIZË

Si rimëkëmbët Parku Kombëtar i Lurës?

NGA **SELMAN MËZIU** - FAQE 10

OPINION

Genocidi në Dibër të Madhe sipas së drejtës ndërkombëtare

NGA **SAIMIR SHATKU** - FAQE 11

VENDLINDJA

Muhurri - vështrim ekonomik, historik dhe etnokulturor

NGA **SELMAN MËZIU** - FAQE 14-15

STUDIM

Në kërkim të qyteteve të rrënuara të Ilirisë

NGA **ISLAM CANI** - FAQE 21

Qeveria ka edhe pak kohë **të dëshmojë** se nuk po mashtron me **Rrugën e Arbrit**

Deklaratë e Grupit të Lobimit pas interpelancës parlamentare më 9 qershori 2016. EDMOND HAXHINASTO: Rruga është projektuar keq dhe është zbatuar keq. Ofertat kineze të papranueshme. Kur të diskutojmë buxhetin, vendosni ju që të gjithë paratë e buxhetit të shtetit t'i çojmë te kjo rrugë ... MESILA DODA: Rruga e Arbrit bëhet me njerëz serioz, jo me njerëz që para se ta ndërtojnë mendojnë ti taksojnë

Replike

Mashtrimet e Haxhinastos dhe të vërtetat e projektit për Rrugën e Arbrit

E dëgjova intervistën e ministrit Haxhinasto në parlament për rrugën e Arbrit. Mbeta i shokuar! Me të vërtetë nuk e kuptoj se si ka mundësi, që të flasë në atë mënyrë personi që mban përgjegjësinë kryesore për infrastrukturën në Shqipëri.

NGA **FARUK KABA** - FAQE 6

Opinion

Nderi i humbur i deputetëve të Dibrës

Nuk bëhet fjalë për nderin personal, po për nderin publik të Dibrës dhe dibranëve, që këta zotërinj pranuan dhe u zotuan të përfaqësojnë. Çnderimi i tyre ka një emër emblematik: "Rruga e Arbrit", e cila, ashtu, e filluar dhe e pakryer, e dëshmon për faqe të zezë këtë.

NGA **AGRON TUFA** - FAQE 3

Fejton

Logjet për Rrugën e Arbrit dhe Dibra e mbytur

Seanca për Rrugën e Arbrit, logjet e përcjella nga kërkuesja e interpelancës, deputetja e PDIU zonja Doda dhe përgjigjet e ministrit Haxhinasto kanë hedhë mjegull mbi Luginën e Drinit të Zi, mjegull të zezë ku pazaret për ndërtimin me një, dy apo tri diga të hidrocentralit tepër të përfolur të Skavicës janë fshehur në zë e figurë.


NGA **ABDURAHIM ASHIKU** - FAQE 3

Reagimi i shoqërisë civile dhe debati i plotë parlamentar
- LEXONI NË FAQET 2 - 7

Edhe Rruga e Arbrit mund të jetë pjesë e nismës 16 + 1

Bisedë me prof. **Shaban Sinanin**, pjesëmarrësi i vetëm i Shqipërisë në takimin e tretë të 16 vendeve të Europës Qendrore e Lindore plus Kinën, zhvilluar më 8 qershor, në qytetin Ningbo të Kinës jugore

FAQE 6



Në foto: Luginës së lumit të Tiranës. Foto e vitit 2013. © *B.Karoshi*

Investigim

Bonusi për Turqit vë në dyshim garën për HEC-in "Katund i Ri"

Nga **JETONA KOÇIBELLI** | BIRN | Tiranë

Prej 20 vjetësh, djemtë e Shaban Beçës kanë punuar në fushat e duhanit në Itali. Me kursimet e tyre, ata kanë ngritur në fshatin Podgorcë të Dibrës një restorant të këndshëm me gatime tradicionale të zonës, kopshtin, shtëpitë dhe gjithçka kanë – buzë lumit Drin i Zi. Tokat bujqësore të Beçës dhe ato të fshatit janë të punuara me kujdes dhe të mbjella me misër, grurë dhe shalqi. Por e gjithë kjo pasuri, fryt i punës shumëvjeçare të familjes së tij rrezikon të zhduket – e përmbytur nga ujërat e lumit, pas ndërtimit të hidrocentralit "Katund i Ri."

FAQE 8-9

Redaksia e gazetës Ju uron lexuesve dhe bashkëpunëtorëve të saj, Gëzuar Festën e Bajramit të Madh!

Kërkohen korrespondentë në Peshkopi dhe Dibër të Madhe

Të interesuarit për korrespondentë/menaxherë duhet të kenë pasion gazetarinë. Përbën avantazh përvoja në shtypin e shkruar ose në qoftë se kanë mbaruar studimet për gazetari dhe letërsi / marketing. Të jenë të angazhuar për punën në grup dhe të jenë të pavarur politikisht gjatë kohës që bashkëpunojnë me gazetën.
Të interesuarit të shkruajnë email në adresën
<rrugaearberit@gmail.com>
ose të telefonojnë në numrin **069 20 68 603.**

KNAUF Bashkëpunon me komunitetin

www.knauf.al

cyan magenta yelloë black 1

Posta e Rruga e Arbërit

Gazetë e pavarur.
Nr. 6 (122). 1 - 30 Qershor 2016

Redaksia e gazetës falënderon lexuesit dhe bashkëpunëtoret e saj për mesazhet dhe shkrimet e sjella për botim.

Kujtojmë bashkëpunëtorët, të cilët duan që shkrimet e tyre të botohen patjetër në numrin e radhës, të konfirmojnë më parë sjelljen e materialit në numrat e telefonit të redaksisë ose emailin e gazetës.

Shkrimet refuzohen për botim vetëm në rast se merrni përgjigje me email. Për çdo rast tjetër shkrimet priten për botim në numrat e radhës.

Shkrimet në redaksi për numrin e radhës priten deri më **datë 20** të muajit, përveç rasteve të bashkëpunëtorëve të rregullt.

Gjithashtu, ju **kujtojmë bashkëpunëtorëve se shkrimet deri në dy faqe daktilografike kanë përparësi botimi.**

GJITHASHTU, KUJTOJMË SE ÇDO SHKRIM I BOTUAR NË NJË MEDIA TJETËR APO RRJETE SOCIALE NUK KA PËRPARËSI BOTIMI.

JU LUTEMI, SHKRIMET QË VIJNË PËRMES EMAIL-it, TË KENË PATJETËR ZANOREN "ë".

Ju falënderojmë që jeni pjesë e gazetës!

BOTUES:
Musa Riçku
Bujar Karoshi
Shaqir Skarra

Korrespondentë të përhershëm:
Sashenka NDREKA
Hysen LIKDISHA
Abdurahim ASHIKU
Osman XHILI

Kontribuan për këtë numër:
Agron TUFA
Selman MËZIU
Jetona KOÇIBELLI
Shaban SINANI
Faruk KABA
Bujar KAPEXHIU
Muharrem DEZHGIU
Dionis XHAFA
Ermira SHEHU-TOCA
Petrit FETAHU
Gazmend KËRKUTI
Saimir SHATKU
Nexhip EJUPI
Islam CANI
Ahmet KAMBERI
Ira BRUCI
Mevlud BUCI
Ilmi Dervishi
Destan RAMA

Fotoreporter: Fehmi Lleshi

Arkivi i gazetës është PA pagesë në faqen e internetit **www.rrugaearberit.com.**
Falënderojmë z. **AGIM DEVA** për kontributin e vazhdueshëm për mirëmbajtjen e faqes së gazetës në internet dhe arkivin online.
Pajtimet në gazetë mund t'i bëni në çdo kohë duke komunikuar në adresat e redaksisë.
Bëj pajtimin tënd me **PayPal** përmes emailit <rrugaearberit@gmail.com>
Një pajtim vjetor kushton: Në Shqipëri: 600 lekë. Në Europë: 10 Euro. Në SHBA dhe vende të tjera: 15 USD. Pajtimi në Europë dhe SHBA është vetëm në versionin PDF.
Për kontribute për gazetën mund të kontaktoni redaksinë ose mund t'i bëni ato përmes numrit të llogarisë më poshtë:
Raiffeisen Bank
Rruga e Arberit
Nr. llog. në lekë: 4700036640
IBAN: AL90202112190000004700036640

Adresa e gazetës:
Rr. "Zenel Baboçi",
Pall. "Ferar", Tiranë
Tel. +355 4 22 33 283
+355 69 20 68 603
E-mail: rrugaearberit@gmail.com

Opinionet dhe komentet e botuara nuk shprehin domosdoshmërisht qëndrimin e redaksisë

Çdo shkrim apo foto e botuar i nënshtrohet ligjit për respektimin e të drejtave të autorit. Ndalohet riprodhimi, fotokopjimi, shpërndarja apo ribotimi pa lejen e autorit të shkrimit apo redaksisë.



Qeveria Rama ka edhe pak kohë të dëshmojë se nuk po mashtron me Rrugën e Arbrit

Deklaratë e Grupit të Lobimit pas interpelancës së 9 qershorit 2016 të Ministrit të Transportit dhe Infrastrukturës, Edmod Haxhinasto, kërkuar nga deputetja Mesila Doda

Pas debatit të zhvilluar në seancën plenare të datës 9 qershor në Kuvendin e Shqipërisë me objekt "Rrugën e Arbrit", vërejmë me shqetësim se Qeveria Shqiptare nuk e ka marrë seriozisht çështjen e Rrugës, ashtu siç kishte premtuar gjatë fushatës elektorale në vitin 2013 dhe gjatë miratimit të programit të qeverisë.

Seanca e 9 qershorit 2016 ishte një kopje e shëmtuar e debatit parlamentar të zhvilluar për këtë çështje së paku në 10 vitet e fundit; njëra për të fituar kredo politike në kurriz të çështjes dhe tjetra në përpjekje për të justifikuar vonesat.

Debati parlamentar duhet të synonte së paku, zbardhjen e negociatave mes Qeverisë Shqiptare dhe 'China State Construction Company' si dhe të bënte transparentë koston financiare të debatueshme në këto negociata, në zbatim të ligjit nr. 41/2015, dt. 16.4.2015, të miratuar po nga këta deputetë që ishin në sallë.

Ministri i Transportit Edmond Haxhinasto përdori shifra të pasakta, të dhëna të vjetruara, mashtrime me të dhënat teknike të projektit, madje arriti deri aty sa të kërcënonte deputetët e parlamentit se "në qoftë se ata vendosin të investojnë në këtë rrugë, gjithë buxheti vjetor për rrugët do të shkonte te Rruga e Arbrit".

Ky kërcënim është i papranueshëm për ne. Duhet të ishte i tillë edhe për së paku gjashtë deputetë të drejtëpërdrejtë të Dibrës, me në krye Shkelqim Canin, të cilët, ndërsa në prill të vitit të kaluar deklaronin se "qeveria ka vendosur ta ndërtojë rrugën", "rruga e shpresës së madhe" "punimet nisin në 2016", "dibranët ta gëzojnë rrugën" etj,, tani paturpësisht heshtën. Ata duhet të reagonin me një zë kundër spekullimeve të ministrit Haxhinasto.

Në i ftojmë deputetët në parlament që të mos bëhen më aktorë të skenave të tilla të turpshme. Ne i ftojmë ata të ushtrojnë të gjithë të drejtën e tyre ligjore dhe demokratike për të zgjidhur financimin e rrugës në një kohë sa më të shpejtë.

Deklaratat pa përgjegjësi të Ministrit të Transportit, jo vetëm që janë të pasakta dhe spekullative, por tregojnë papërgjegjshmëri të qeverisë lidhur me këtë çështje.

Ky debat parlamentar kaloi pa reagimin e duhur nga opinioni publik, përveç ndonjë zëri të vetmuar të anëtarëve të shoqërisë civile apo atyre që kanë lidhje me çështjen. Ne u kërkojmë projektuesve të rrugës të bëjnë publike projektet dhe kostot financiare. Mospublikimi i projektit dhe kostos financiare të nevojshme për ndërtimin e rrugës, është një mënyrë e duhur për të ndihmuar zhvillimin e aferave korruptive sot dhe në të ardhmen në Rrugën e Arbrit.

Megjithatë, premtimi për Rrugën e Arbrit u është dhënë dibranëve nga Kryeministri Edi Rama dhe deputetit Shkëlqim Cani. Ne kërkojmë prej tyre të distancohen nga deklaratat e Haxhinastos si dhe sa më parë të bëjnë zbardhjen e negociatave me kompaninë kineze. Këto negociata nuk mund të jenë pa fund, por edhe duhet të jenë transparente dhe të ditura për publikun.

Gjithashtu, ftojmë kompanitë shqiptare apo të huaja, të interesuara për ndërtimin e Rrugës së Arbrit, të bëjnë publike ofertat e tyre financiare. Të kërkosh të marrësh përsipër ndërtimin e një objekti publik pa zbardhur ofertën financiare, është një mënyrë abuzive në kurriz të takspagueve shqiptare.

Ne, ashtu si dhe më parë, deklarojmë se nuk mbështesim asnjë parti politike, por jemi të vendosur që të ushtrojmë presionin e nevojshëm ndaj ligjvënësve dhe qeveritarëve, në mënyrë që njëherë e mirë të ndahemi nga e kaluara e premtive boshe. Fushata elektorale e radhës është në prag, por ne nuk do të qëndrojmë indiferencë. Ne jemi të vendosur që çështja e Rrugës së Arbrit nuk do të jetë më temë e premtimeve elektorale në Dibër, Mat dhe në lindje të Tiranës.

Grupi i Lobimit

- Seanca e 9 qershorit 2016 ishte një kopje e shëmtuar e debatit parlamentar të zhvilluar për këtë çështje së paku në 10 vitet e fundit; njëra për të fituar kredo politike në kurriz të çështjes dhe tjetra në përpjekje për të justifikuar vonesat.
- Ministri i Transportit Edmond Haxhinasto përdori shifra të pasakta, të dhëna të vjetruara, mashtrime me të dhënat teknike të projektit, madje arriti deri aty sa të kërcënonte deputetët e parlamentit se "në qoftë se ata vendosin të investojnë në këtë rrugë, gjithë buxheti vjetor për rrugët do të shkonte te Rruga e Arbrit".
- Në i ftojmë deputetët në parlament që të mos bëhen më aktorë të skenave të tilla të turpshme. Ne i ftojmë ata të ushtrojnë të gjithë të drejtën e tyre ligjore dhe demokratike për të zgjidhur financimin e rrugës në një kohë sa më të shpejtë.
- Fushata elektorale e radhës është në prag, por ne nuk do të qëndrojmë indiferencë. Ne jemi të vendosur që çështja e Rrugës së Arbrit nuk do të jetë më temë e premtimeve elektorale në Dibër, Mat dhe në lindje të Tiranës.

Firmos peticionin në linkun e mëposhtëm ose na ndiq në Facebook





https://www.facebook.com/Peticioni-p%C3%ABr-Rrug%C3%ABn-e-Arb%C3%ABrit-1538054103179153/

https://www.change.org/p/complete-the-construction-of-the-arb%C3%ABri-road-nd%C3%ABrtoni-sa-m%C3%AB-shpejt-dhe-me-standarde-rrug%C3%ABn-e-arb%C3%ABrit?recruiter=44387270&utm_source=share_petition&utm_medium=twitter&utm_campaign=share_twitter_responsive&rp_sharecordion_checklist=control

Të gjithë ata që i kanë rënë kryq e tërthor Ballkanit e dinë, se nuk gjendet kund mbi faqe të dheut rrugë më e rrezikshme, rrugë më e keqe, më e gjatë e më e vështirë se rruga torturuese Tiranë-Peshkopi e kthim. Të gjithë e dinë se në çfarë izolimi gjendjet kjo zonë, pa treg, po investime, pa perspektivë të qartë, përveç kërcënimeve futuristike e horroristike, për ta përmbytur më në fund me projektin e Skavicës.

Nderi i humbur i deputetëve të Dibrës

Nga **Agron TUFA**

Nuk bëhet fjalë për nderin personal, po për nderin publik të Dibrës dhe dibranëve, që këta zotërinj pranuan dhe u zotuan të përfaqësojnë. Çnderimi i tyre ka një emër emblematik: "Rruga e Arbrit", e cila, ashtu, e filluar dhe e pakryer, e dëshmon për faqe të zezë këtë. Të rekrutuar në programe platformash politike gjoja të majta e gjoja të djathta, ata bëhen shumë: tok me deputetët e tashëm, janë dhe ata ish-deputetë të legjislaturave të mëparshme. Të gjithë ata, të majtë, të djathtë, të larmë, kanë një të përbashkët: ata e gënjyen vendlindjen e vet, i gënjyen dibranët për 16 vjet me radhë me premtimin palodhshëm për "Rrugën e Arbrit". Nëse në fillim deputetët e Dibrës u besuan gënjeshtrave të partive, më vonë ata me gëzim të madh parapëlqyen të gënjehen vetë. Dhe gënjeshtra u bë rrugë, u bë autostradë me katër korsi dhe e tillë duhet të pagëzohet: Autostrada e gënjeshtrave "Rruga e Arbrit".

Por le ta shohim pak më esëll çështjen. Gjithkush mund të gënjehet. Nga dëshira për të besuar në fuqitë magjike të partisë së vet; nga entuziazmi i sinqertë politik; nga iluzioni se do të gjenden aleatë që do të angazhohen në domosdoshmërinë e ndërtimit të rrugës; nga truku i vrullshëm prej prestigjiatori i adeptëve elektoralë, që në prag të fushatave, ndërkohë fillojnë punën mbi ndonjë segment nën vrojtimin e kamerave dhe transmetimet live; nga propaganda e orkestruar mediatike; nga përpjekjet sinqerta të dy shoqatave të Dibrës....

Por pas gënjeshtrës së parë, duhet të vijë momenti i kthjellimit. Gënjeshtra e parë mund të gëlltitet, por gënjeshtra e dytë, është faj. Ata që morën mandatet me premtimin e ndërtimit të rrugës, shpesh janë kanë qenë të njëjtit, pra kanë shijuar frytet e gënjeshtrës së përsëritur. Megjithatë, për turpin e të gjithë atyre që kanë qenë e janë deputetë dibranë në Parlament, ne nuk pamë asnjëherë, në asnjë rast, qoftë dikënd prej tyre që të ngrihej dhe, me fuqitë e veta të pakta, të protestonte ndaj kësaj gënjeshtre të tejzgjatur e fyese.

Nëse ti si deputet, e ke zbuluar se gjithçka ka qenë gënjeshtër e propagandë, kush të pengon pra, që dhe i vetëm të dish të mbrosh nderin e zonës që të besoi dhe interesin e të cilës përfaqëson? Ne nuk kemi parë asnjë akt të këtillë, që ndonjëri prej deputetëve të Dibrës ta bënte kauzë çështjen e Rrugës së Arbrit. Nuk kemi parë asnjëherë asnjërin që në mënyrë demonstrative të shpallte bllokimin e të gjitha votimeve dhe angazhimeve në Parlament vetëm e vetëm për këtë çështje, e cila, po të citojmë fjalët e filozofit, është "përtej së majtës dhe së djathtës". E duke mos pasur asnjë rast demonstrativ proteste nga asnjëri, kuptohet se as nuk e kanë patur ndërmend një aleancë të tillë, që të mblidhte tok deputetët e majtë e të djathtë të Dibrës, pra një grup numerik solid, për ta bojkotuar Parlamentin, derisa çështja e Rrugës së Arbrit të hynte në agjendën konkrete të zgjidhjes. Dhe sigurisht, profilet e tyre të zbërdhylëta publike e intelektuale do të kishin lënë një mbresë të pashlyeshme historike e shoqërore. Do të mbaheshin mend ndër breza, pavarësisht përkohësisë së mjerë të mandateve. Por ajme, nuk ndodhi e zor se do të ndodh. Deputetët e Dibrës parapëlqejnë me gaz të mashtrohen vetë. Ç'të bësh? Nuk janë nga ajo rracë. Nuk janë nga ajo rracë, fjala vjen e Elez Isufit, që për mospagesën prej disa viteve të rrogave të administratës, ai e rrethoi Tiranën, Parlamentin dhe mbretin, derisa e detyruan t'i përgjigjej me pahir.

Për turp, kësaj radhe në qeveri, deri para pak kohësh, ministër financash ishte një prej ekonomistëve më të shquar, ish-guvernatori i Bankës së Shqipërisë, z. Shkëlqim Cani nga Çidhna e Dibrës. Një dështim i turpshëm mu në mes të luksit! E Rruga e pambaruar e Arbrit, me gjithë premtimet e qeverive, me gjithë gjetjet e fondeve dhe sponsorëve, është prezantuar vazhdimisht si një realitet në mishërim e sipër, por, ajme, vetëm aq. Një realitet si ëndrrat shumë të çmuara, kur njeriu sapo zgjat dorën ta prekë, zgjohet dhe kupton se s'paska qenë gjë tjetër, përpos se një tjetër ëndërr mashtruese.


Të gjithë ata që i kanë rënë kryq e tërthor Ballkanit e dinë, se nuk gjendet kund mbi faqe të dheut rrugë më e rrezikshme, rrugë më e keqe, më e gjatë e më e vështirë se rruga torturuese Tiranë-Peshkopi e kthim. Të gjithë e dinë se në çfarë izolimi gjendjet kjo zonë, pa treg, po investime, pa perspektivë të qartë, përveç kërcënimeve futuristike e horroristike, për ta përmbytur më në fund me projektin e Skavicës.

Se çfarë domethënieje ka kjo rrugë për dibranët, bulqizakët e matjanët, se çfarë resursesh agrobujqësore, industriale, blektorale, kulturore e turistike ofrojnë këto treva, kjo është përsëritur duke shpenzuara kilometra retorikë përgjatë 20 viteve të fundit. Dhe të gjitha ato që janë thënë e të tjera që mund të shtohen, qëndrojnë. Ata e bëjnë edhe më të shpifur, edhe më të neveritshme gënjeshtrën dhe sidomos këmbënguljen me të cilën përsëritet kjo gënjeshtër nga mandati në mandat.

Ditë më parë u shfaq në media i shumëpërvuajturi ministri Haxhinasto dhe e mohoi pa problem gjithë çështjen e Rrugës së Arbrit. Kushton shumë, tha. E bëri këtë shumë thjesht, me qetësi e dashuri, me një gjest, të themi, siç do të dëbonte nga supi i kostumit të tij ndonjë vemje stine. Do të kisha dashur të isha aty, në atë moment. Sa për t'i dhënë një shpullë në faqen e përsosmërisht të lëmuar. Figurativisht, kuptohet. Megjithatë prita, prita, i sigurtë se këtë do ta bëjnë pasardhësit e Elez Isuf Ndreut në Parlament shqiptar. Mbase ka ndodhur, ku ta dish... në hamendësime. Se premtimet për Rrugën e Arbrit dibranëve ua ka dhënë jo Haxhinasto, po kryeministri! Dhe dibranët kanë zgjedhur t'i besojnë kësaj herë gënjeshtrës së Ramës e jo të Haxhinastos (ani pse në thelb gënjeshtër doli). Ç'bëhet kështu?! Tre ditë më parë, po ky ministër na solli nga minierat e Bulqizës ca pamje mallëngjyese me një burrë të thyer, që deklaroi para kamerave, se gjithçka shkon për mrekulli, se ai na marrkësh një rrogë modeste prej 700 dollarësh (!). Pra, përveç autostradës së gënjeshtrave me emrin "Rruga e Arbrit", tashmë, me gjasë, kanë filluar të shtrihen degëzimet arteriale të saj, qytet më qytet e fshat më fshat.

Po deputetët tanë?! Ata që ishin, ata që janë... e ata që e dinë qysh tani se do të jenë... Ata i ka pushtuar një heshtje plot nënkuptime. Një heshtje plot patos e ton të lartë. Heshtin përballë të gjithave. Si peshqit në akuarium. Ndërsa era e zgjedhjeve të reja avitet... E meqë zgjedhjet e reja aviten, meqë brenda një viti do të valëviten histerishëm banderola të reja, retorikë e slogane të goditura, meqë liderët tanë i kanë privatizuar partitë dhe hedhin në arenë vetëm një tip rrace të dëgjueshme, të shalueshme dhe të epshme për të gjitha gënjeshtrat e radhës, unë kisha një propozim për popullin e tradhëtuar e të fyer të Dibrës: ditën e hapjes së fushatës, të nxjerrin në Qafë të Buallit një përfaqësi vullnetare (të pacaktuar nga lart), që t'i presin deputetët e listave me hunj në dorë. Kjo do të ishte dëshira ime për një përgjigje të merituar. Simbolike, vetëkuptohet.

Dhe márrja do të bëhet lule, e të gjithë së bashku - lulja e márres.



Kori pa zë i deputetëve dibranë. Karikaturë nga **BUJAR KAPEXHIU**

> Nëse në fillim deputetët e Dibrës u besuan gënjeshtrave të partive, më vonë ata me gëzim të madh parapëlqyen të gënjehen vetë. Dhe gënjeshtra u bë rrugë, u bë autostradë me katër korsi dhe e tillë duhet të pagëzohet: Autostrada e gënjeshtrave "Rruga e Arbrit".

> Premtimet për Rrugën e Arbrit dibranëve ua ka dhënë jo Haxhinasto, po kryeministri! Dhe dibranët kanë zgjedhur t'i besojnë kësaj herë gënjeshtrës së Ramës e jo të Haxhinastos

Logjet për Rrugën e Arbrit dhe Dibra e mbytur

- **Një "Rrugë e Arbrit" pa Dibrën si e ka krijuar Zoti është një "rrugë për në varreza".**
- **Është koha që deputetët me rrënjë e me prejardhje nga Dibra, të koalicioneve të krahut të majtë e të djathtë, bashkë, në një zë, t'i thonë së pari ndal mbytjes së Dibrës.**
- **Është e vetmja gjë që nuk pret. Inkuizitorët i kanë prehur hanxharët...**

Nga **ABDURAHIM ASHIKU**

Seanca për Rrugën e Arbrit, logjet e përcjella nga kërkuesja e interpelancës, deputetja e PDIU zonja Doda dhe përgjigjet e ministrit Haxhinasto kanë hedhë mjegull mbi Luginën e Drinit të Zi, mjegull të zezë ku pazaret për ndërtimin me një, dy apo tri diga të hidrocentralit tepër të përfolur të Skavicës janë fshehur në zë e figurë.

Nuk ka asnjë dyshim se Lugina e Drinit të Zi do të mbytet dhe populli i Dibrës do të marrë rrugën e njohur të ikjes nga sytë këmbët, ikje që ajo e viteve 1913-1920 do të duket lule. Veçse në këtë rast populli i Tiranës nuk do të ketë derë të hapi dhe Mëhalla e Dibranëve nuk do të ketë odë ti mbledhë. Se ku do të shkojnë dhe ku do të hapin themelet e një jete "me origjinë nga Dibra", nuk dihet, nuk ka asnjë plan dhe askush nuk e thotë një fjalë të vetme.

Komentues në rrjetet sociale nuk munguan të nxitojnë që ta shpallin Zonjën Doda "Bijë të madhe të Dibrës" dhe të betohen se në zgjedhjet që fiks pas një viti do të bëhen, do ta votojnë si deputete të trevës. Sigurisht si deputete e partisë Çame, në mos ndërroftë flamur e ngjyrë, gjë fort e zakonshme për njerëz që hyjnë duke shtyrë me supe në politikë.

Një "Rrugë e Arbrit" pa Dibrën si e ka krijuar Zoti është një "rrugë për në varreza".

Dibrën nuk e nënshtruan dot:

As osmanlinjtë me 18 beteja humbëse në Luginën e Drinit kundër ushtrisë vullnetare të Skënderbeut...

As turqit e shekullit të 19-të me Hajredin Pashën e Hysni Pashën...

As Serbët me armatën e tyre moderne...

As Enver Hoxha i njohur për diktatin "sus".

As Sali Berisha me sloganin "Unë jam i zoti të bëj vepra të mëdha"...

Po e nënshtron me mbytje Edi Rama me Ilir Metën, në koalicion dhe në një zë për ta zhdukë Dibrën nga faqja e dheut me gjithçka.

Në këtë hulli parësore për Dibrën dhe Dibranët është mbrojtja nga "turku" i Luginës së Dibrës.

Zonja Doda që zbulohet se është dibrane nga Reçi, do ta tjerrte mbarë thirrjen publike në Kuvend duke filluar nga ministri Gjiknuri i cili është vënë në ballë të shuarjes së Dibrës duke filluar nga diga mbi Katundin e Ri të Luznisë.

I ndjeri Sabri Godo përmendte shpesh se atdheu fillon nga familja. Megjithëse zonja Doda nuk është republikane por pjesë e një partie që lufton për DREJTËSI, hapin duhet ta hidhte nga "familja e saj" nga Reçi që në mos sot me "Katundin e Ri", nesër "me Skavicën" shuhet nga faqja e dheut.

Ta fillonte atje, për tu thënë "turqve" që duan Skavicën, se e mbara do të ishte që pas tuneleve dhe Rrugës së Kombit, buldozerët dhe makineritë e rënda të firmës së tyre (bekuar edhe nga Erdogani) duhet të shkonin në hapjen e tuneleve dhe në ndërtimin e Rrugës së Arbrit me të njëjtat përmasa dhe cilësi, ani se në të hëngrën sa u frynë si turqit dhe shqiptarët me "duar në mjaltë".

Është koha që deputetët me rrënjë e me prejardhje nga Dibra, të koalicioneve të krahut të majtë e të djathtë, bashkë, në një zë, t'i thonë së pari ndal mbytjes së Dibrës.

Është e vetmja gjë që nuk pret. Inkuizitorët i kanë prehur hanxharët...

Rruga e Arbërit nr. 122

9 qershor 2016. Interpelancë për rrugën e Arbrit në Parlamentin Shqiptar me Ministrin e Transportit dhe Infrastrukturës, kërkuar nga deputetja e PDIU, znj. Mesila Doda

interpoe

Ministri: Rruga është projektuar keq dhe është

Më 9 qershor 2016, deputetja e PDIU, znj. Mesila Doda, zhvilloi një interpelancë në Parlamentin e Shqipërisë me Ministrin e Transportit Edmond Haxhinasto. Interpelanca u shoqërua me debate dhe shumë të dhëna që u përmendën ishin ose të pavërteta ose të interpretuara qëllimisht gabim. Në këtë numër të gazetës kemi disa reagime për këtë çështje, dhe ne, në parim të informimit të publikut në mënyrë të paanshme, vendosëm të botojmë interpelancë e plotë. Materiali është zbardhur i plotë dhe nuk i është nënshtruar redaktimit. Vetëm titujt dhe mestitujt janë të redaksisë. Pjesa tjetër është çfarë është folur në Parlamentin Shqiptar.

MESILA DODA, DEPUTETE E PDIU: ÇFARË PO BËHET ME RRUGËN E ARBRIT?

Më së fundi arritëm që ta bëjmë të realizueshme këtë interpelancë, të cilën kemi javë që përpiqemi ta realizojmë, por për arsye objektive është shtyrë. Kjo është tejet e rëndësishme, sepse besoj se mbas Rrugës së Kombit, projekti më i rëndësishëm për Shqipërinë është projekti i Rrugës së Arbrit, një projekt i cili është premtuar shumë, është punuar shumë, janë sjellë ligje të ndryshme, janë bërë deklarata të ndryshme, por që fatkeqësisht ende sot e shohim si një mundësi e humbur për të gjithë atë zonë, për zonën verilindore, veçanërisht për qarkun e Dibrës dhe gjithë malësisë së Tiranës, nëpërmjet të cilit do kalonte projekti i rrugës së Arbrit.

Projekti i Rrugës së arbrit ka një rëndësi shumë të madhe parë në disa këndvështrime. Ka një rëndësi të madhe parë në këndvështrimin ekonomik, sigurisht, sepse është një zonë që jo vetëm prodhohen shumë, por që sot për fat të keq nuk është e lidhur me tregjet e kryeqytetit dhe më gjerë me tregjet e të cilat kalojnë kufirin shqiptar. Është tejet i rëndësishëm për faktin se është një zonë ka një prodhim industrial jo të vogël. Le të kujtojmë që të gjithë këto prodhime të zonës së Bulqizës, duhet të kishin një treg më të madh dhe kjo do sillte një impakt ekonomik për të gjithë zonën, sepse sot n.q.s. do të shikojmë dendësinë e popullsisë, ajo është rralluar shumë.

Kemi një popullatë e cila po largohet për ditë, dhe kemi pothuajse një shfarosje të popullsisë në të gjithë atë zonë, e cila nuk ka asnjë mundësi ekonomike për të jetuar. Nga ana tjetër është një mundësi turizmi, e cila po humb në atë zonë. Le të kujtojmë që është një nga zonat më të bukura të vendit, është një zonë e cila është e ngarkuar me histori por dhe me bukuri natyrore. Është zona e Liqeneve të Lurës, zona e Kurorës së Lurës, e cila për fat të keq dhe ajo është dëmtuar shumë për gjatë viteve, por që do mund të ringjallej nëse do të kishte një rrugë me kryeqytetin.

Parë në këtë këndvështrim, Rruga do i shërbente thuajse 1 milion e 200 mijë personave, duke pasur parasysh gjithë zonën e Tiranës, malësisë së Tiranës dhe pjesës së tjetër nga ku do të kalonte, Klosit, Bulqizës e deri në Dibër.

Por ka dhe një dimension tjetër, të cilin sot nuk mundet ta anashkalojmë, dimensioni i gjeopolitikës ose më saktë për të thënë bashkimi i bashkëpunimit që do mund të ishte i shqiptarëve matanë kufirit dhe që ka të bëjë me shqiptarët e Dibrës së Madhe dhe të gjithë atij pellgu, do ishte tejet i rëndësishëm. Sot ato kanë mbetur thuajse një ishull i izoluar dhe pa asnjë lidhje me pjesën tjetër të shqiptarëve në brendësi të kufirit.

Por kjo nuk është e vetmja arsye për shkak të cilës ne e thirrëm këtë interpelancë. Gjatë një takimi që ne patëm në qytetin e Peshkopisë, ishte një kërkesë e thuajse gjithë banorëve, dhe sapo kam lajmëruar këtë interpelancë kam patur mesazhe pafund prej tyre, të cilët kërkonin në mënyrë këmbëngulëse që jo vetëm të kishin këtë interpelancë, por që ta mbanim thuajse larg toneve politikë dhe kjo për arsye sepse të gjithë qeveritë që kanë shkuar dhe kanë ardhur, kanë bërë premtimet e tyre në të gjithë zonën, dhe premtimet thuajse kanë rezultuar gjithmonë fals, pra kanë qenë premtime boshe. Dhe pikërisht, për këtë arsye, kërkesa e tyre është kjo: duam të dimë se çfarë ndodh me Rrugën e Arbrit. A do ndërtohet rruga e Arbrit? A do ndërtohet brenda këtij mandati ashtu siç është premtuar? Kush janë problemet e vërteta të kësaj rruge? Ku ka mbetur? Kush janë segmentet që janë ndërtuar dhe ata që priten të ndërtohen? Dhe më së fundi, një prej atyre kalendave që po verifikohen në politikat shqiptare dhe veçanërisht me këtë rast, dhe që kanë të bëjnë me negociatat me firmën kineze, e cila solli një ofertë, erdhi një projektligj në Kuvend, u premtua që do të ishte në terma kohorë mjaft të shpejtë. Por ende sot nuk kemi asnjë rezultat konkret edhe për këtë pjesë të rrugës.

Pikërisht, për të marrë gjithë këtë informacion, por mbi të gjitha për të qenë të qartë me gjithë atë popullsi, e cila sot është e izoluar, e cila sot po vuan indiferencën me varfërinë dhe thuajse një shfarosje hap pas hapi të njerëzve që jetojnë aty që nuk kanë asnjë mundësi tjetër ekonomike njerëzore për të vazhduar të jetojnë dhe të ngrenë jetën e tyre atje, ne kemi kërkuar këtë interpelancë. Pres nga ministri që të flasë për fazat e asaj që kemi pasur mundësi që të kemi deri tani, ku janë fazat që është arritur, nga e kanë marrë projekt, çfarë është bërë përgjatë këtyre 3 viteve dhe çfarë do bëhet deri në fund të mandatit, pra për 1 vit e gjysmë.

EDMOND HAXHINASTO, MINISTER I TRANSPORTIT DHE INFRASTRUKTURËS: PROPOZIMET KINEZE KANË QENË TË PAPRANUESHME PËR NE. PO PRESIM NJË OFERTË TË RE

Faleminderit zoti kryetar! Së pari dua të falënderoj deputeten Doda për sjelljen në interpelancë të kësaj çështje që ka vërtet kohë që diskutohet gjatë. Dëshiroj, gjithashtu, të falënderoj ish ministrin e financave dhe deputetin e asaj zone, zotin Cani për përpjekjet e mëdha për të akomoduar brenda buxhetit të shtetit si në vitin 2016 ashtu në 2015 dhe 2014, detyrimet që presupozoheshin të jepeshin nga ana e atij buxheti për skemën financiare që u propozua nga kompania kineze "China State". Dëshiroj gjithashtu të falënderoj në mënyrë të veçantë dhe deputetin Përparim Spahiu për angazhimin e tij të vazhdueshëm dhe konkret në shikimin dhe vlerësimin e mundësive të tjera për të përfunduar këtë projekt, duke sjellë gjithashtu edhe investitorë potencialë për të parë mundësinë e financimit në këtë vepër.

Tani, dy janë elementët që mendoj të trajtoj sot:

Së pari, ajo që ka të bëjë me ngjizjen e veprës, me tiparet e saj dhe çështja e dytë ka të bëjë me vetë ofertat që na kanë ardhur.

Ky projekt është iniciuar në vitin 2008 dhe parashikon një gjatësi prej 72 km krahasuar me lidhjen e vjetër ekzistuese që është rreth 130 km, pra siç e shikoni është rreth 50 km më e shkurtër. Ka një gjerësi të planifikuar prej 10.5 m, një pjerrësi maksimale 6.99 %, ata që e kuptojnë inxhinierinë e rrugëve do të shikojnë që është një pjerrësi relativisht e lartë. Ka një shpejtësi të planifikuar me 60 km në orë, pra duke pasur parasysh distancën 50 km, koha që shkurtohet është më pak se një orë, që përftohet nga rruga e re. Dhe lartësia e rrugës që varion nga 300 deri në 900 m mbi nivelin e detit. Që do të thotë që në periudha të caktuara rruga do të jetë me një impakt shumë të madh të efekteve të kohës. Deri më sot janë investuar 6 miliardë lekë, në vitin 2013 është investuar duke paguar dhe borxhe 3 miliardë lekë , në vitin 2014 - 1.5 miliardë lekë, 2015 - 1.34 miliardë lekë, gjë që e kam konfirmuar dhe herë tjetër kur është pretenduar në këtë sallë që nuk është hedhur asnjë lekë nga ana e kësaj qeverie.

Disa probleme janë që në konceptim të kësaj rruge.

Së pari, nuk është bërë asnjë planifikim për 50 % të rrugës që në konceptimin e tij dhe së dyti, nga 72 km, 6.5 km nuk janë futur fare në planin e investimit dhe në planin e projektit të detajuar, pra që do të thotë lidhja me kufirin, pra nga Ura e Çerenecit deri në Bllatë, nuk është planifikuar as për studim. Nuk është bërë asnjë koordinim i mëparshëm kur e kemi marrë në dorë dosjen e këtij projekti me palën maqedonase, e cila kishte një rezistencë të madhe për të ndërtuar në pjesën e tyre, pasi rruga kalon në një zonë të mbrojtur. Ndonëse kjo çështje tashmë është e zgjidhur mbasi insistimit tonë të vazhdueshëm.

Vijmë tek propozimet. Janë 5 propozime deri më sot të paraqitura nga një kompani kineze. Propozimi i parë ka ardhur në qershor të vitit 2013 dhe nuk është trajtuar fare. Më pas ka ardhur propozimi i qershorit 2014 dhe kështu kanë vazhduar mbas miratimit të ligjit të posaçëm për ta bërë me prokurim të drejtpërdrejtë, meqë ishte rasti i parë që një kompani vinte me një ofertë të tillë, ishte propozimi i qershorit 2014.

Propozimi i dhjetorit 2014, propozimi i shtatorit 2015, dhe i marsit 2016. Së fundi pas vizitës së zv. kryeministrit të Kinës është premtuar që do të bëhet edhe një propozim i ri nga ana kësaj kompanie.



Mesila Doda

Cilët janë elementet e përbashkët, që përcaktojnë llojshmërinë e këtij projekti dhe sigurisht ku jemi fokusuar dhe ne me vlerësimin tonë.

E para ka të bëjë me ekspozimin vjetor të buxhetit të shteti në skemën financiare që propozohet. Ky propozim ka variuar ndryshëm, sepse struktura financiare e projektit ka qenë e ndryshme. Maksimalja ka shkuar në 37 milionë dollarë në vit, për të bërë pak sens referimi mund t'iu them që i gjithë buxheti i rrugëve aktual i vitit 2016 i miratuar nga ju të nderuar deputetë, është 3.7 miliardë, pra do të thotë 100 për qind e buxhetit që është aktualisht në dispozicion për ndërtimin e rrugëve në Shqipëri. elementi i dytë i rëndësishëm dhe pjesë e shqyrtimit të thellë të propozimeve është interesi i parasë. Kompania kineze, dhe kompanitë kineze përgjithësisht operojnë me garanci sovrane, sepse paratë që merren nga EximBank parashikojnë një garanci sovrane nga shteti ku investohet. Në këtë rast, për herë të parë dhe të vetmen në dijeninë time, është bërë një përjashtim dhe garancia sovrane është zëvendësuar me garantimin e pagesave vjetore në atë masë që unë ju thashë, për herë të parë. Megjithatë, kjo lloj skeme sigurisht rrit koston e parasë. Normalisht kreditë me garanci sovrane ofrojnë interesa shumë më të ulëta ofrojnë interesa zhvillimore, në rastin konkret kemi një kompani komerciale, e cila do të ofrojë një interes komercial dhe llogaritjet tona, interesi i parasë për të gjithë operacionin, shkon diku pak më poshtë se 8 për qindshi që është një kredi mirëfilli tregtare.

Unë mund të futem dhe në detaje n.q.s. keni interes, mund të përshkruaj të gjithë ofertat, por në thelbin e tyre ato nuk ndryshojnë. Ato kanë qenë të papranueshme nga ana jonë që nga vlerësimi i gushtit 2014 nga Ministria e Financave, sepse dua t'ju kujtoj që vlerësimi është bërë nga tre institucione njëkohësisht nga Ministria e Transporteve, nga Ministria e Ekonomisë dhe Ministria e Financave.

Së fundmi, kompania ndërkombëtare prestigjioze e konsulencës "Roland Berger", e cila është kontraktuar nga ana e qeverisë shqiptare për të asistuar qeverinë shqiptare në kuadër të procesit të Berlinit, në kuadër të këtyre proceseve madhore të investimeve, e ka marrë e ka shqyrtuar dhe ka arritur ekzaktësisht atë konkluzion që ka arritur edhe qeveria shqiptare, pra ministritë e ndryshme: Me kosto investimi të lartë, me kosto ndihmëse shumë të lartë dhe me kosto financimi të lartë, pra koston e parasë shumë të lartë.

Së fundmi, ne kemi patur edhe një ofertë nga një kompani shqiptare për ta ndërtuar këtë rrugë, për të investuar vetë dhe për ta ndërtuar këtë rrugë. Është diçka shumë pozitive të cilën unë e përshëndes, por jemi gjithashtu në pritje, jemi në komunikim me të. Shkëmbejmë korrespondencë me ta, derisa ata të përgatisin një ofertë, ndërkohë mund të them në mënyrë prioritare do të vlerësojmë një ofertë që do të vijë së shpejti besojmë nga ana e kompanisë kineze. E përsëris, mbas vizitës së fundit të zv.kryeministrit të Kinës, i cili mori përsipër të shikonte mundësinë e një oferte më të mirë, duke ulur koston e parasë si nga EximBank që jep paranë ashtu dhe koston e kredisë që merr kompania "China States", gjithashtu koston e parasë së vet kompanisë që është 30 për qind e investimit, do të jetë para e hedhur nga vetë kompania.

Vërtetë e përshkrova në prozë këtë, por mendoj se është gjithashtu e rëndësishme të keni edhe një ide pak grafike të gjësë, dhe nëse mund ta shikoni në këtë hartë janë segmentet e kësaj rruge, është segmenti i parë nga Ura e Brarit deri te tuneli i Tujanit, është 5.4 km, do rreth 3 milionë për t'u përfunduar sepse është vetëm trase e pashtruar me asfalt. Është segmenti i dytë për të cilin po flasim kryesisht rreth 27 km me një vlerë që varion rreth 200 milionë euro, gjithë diskutimi për këtë bëhet. Është segmenti nga Ura e Vashës deri të Qafë Bualli 10 km, kjo është e përfunduar. Është segmenti Qafë Buall-Ura e Qerenecit, është 16.9 km, kërkon rreth 2 milion shtesë për t'u përfunduar. Dhe ai që u thashë nga Ura e Qerenecit deri në doganën e Bllatës, rreth 20 milionë duhen për ta përfunduar. Pra, përveç shumës që ju thashë që kërkon segmenti prej afërsisht 26.7 km, është edhe kosto për përfundimin e kësaj rruge rreth 30 milionë euro të tjera. Pra, në këto rrethana jemi. Për sa i takon kohës së nevojshme për realizimin e kësaj rruge, ajo është 3 vjet. Në të gjitha ofertat që na kanë ardhur koha e realizimit të veprës është 3 vjet.

Sigurisht, që modeli financiar i ofruar ka pasur alternime të tij. Kthehem dhe njëherë te modeli financiar, e përsëris që kërkon një angazhim përtej mundësive aktuale të buxhetit të vendit. 30 - 37 milionë varionin ofertat e ndryshme, ndërkohë që ju përsëris që paratë në dispozicion për programin e rrugëve në vitin 2016 janë 3.17 miliardë lekë që do të thotë rreth 37 milionë dollarë. Kjo është situata, jam i bindur si unë, si ministri i transportit dhe infrastrukturës, si zoti Cani që ka qenë i angazhuar dhe i ka parë mundësitë në ekstremin e tyre për të financuar nga buxheti i shtetit, si deputeti Spahiu por besoj dhe ju, jeni shumë të interesuar për ta realizuar këtë vepër, ka rëndësi shumë të madhe. Jo vetëm ajo zonë, por gjithë shqiptarët janë të interesuar për këtë projekt, por sigurisht në momentin e krijimit të mundësisë financiare dhe të marrjes së një skeme e cila ka efikasitet në përdorimin e parave publike do të ishim të gjithë shumë të lumtur që ta realizonim.

> Më vjen shumë mirë në fakt që sensibiliteti, më së fundi sensibiliteti i ministrit arriti të zgjohej dhe të thyente dhe rregullat e procedurës së interpelancës, që sot për herë të parë ka tejkaluar atë që paraqitet në rregullore. Megjithatë, e ripërsërsis edhe njëherë këtë fakt. Asgjë nga kjo që kam thënë unë sot nuk ka lidhje me përfitimet partiake. Duhet ta mësoj dhe zotin ministër që ca gjëra bëhen dhe që mos të përfitosh në mënyrë partiake, por duhet t'u thoni njerëzve të vërtetën. Rruga e Arbrit nuk është bërë, dhe rruga e Arbrit nuk po bëhet dhe nuk ka ndërmend të bëhet me gjithë mentalitetin që ju i keni vënë këtij projekti madhor për Shqipërinë dhe për shqiptarët.

MESILA DODA: RRUGA E ARBRIT SOT E KËSAJ DITE DO TË VAZHDOJË TË MBETET MES KATËR RRUGËVE

Faleminderit zoti kryetar, faleminderit zoti ministër për ekspozenë që bëtë deri tani.

Së pari, doja të thoja që nuk është një projekt që duhet të ketë tone lokaliste dhe nuk besoj se është e udhës që të themi vetëm deputetët e Dibrës apo deputetët me origjinë nga Dibra duhet të kenë interes për këtë projekti, i cili tejkalon jo vetëm qarkun. Unë jua shpjegova, që ashtu siç është një mundësi e munguar për Dibrën, që të ketë mundësi që të ketë një lidhje më të afërt dhe më të shpejtë me kryeqytetin me tregjet industriale me tregun turistik por edhe me gjithë

debat

Haxhinasto: E theksoj dhe njëherë dhe këtu e mbyll. Kjo rrugë është konceptuar keq që në fillim. Është planifikuar vetëm 50 për qind e saj me projekt e le më pastaj për të tjerat. Është investuar në 3 vjet 6 miliardë po nevojat janë për shumë më tepër. Vetëm për të përfunduar pjesët e bëra më përpara, jo segmentin aktual, duhen 30 milionë euro, të cilat nuk i ka buxheti i shtetit.

zbatuar keq. Ofertat kineze të papranueshme

pasuritë që po i privohen Dibrës, po ashtu edhe Tirana po privohet nga një pasuri që ka dhe që është në kufi me të. Nga ana tjetër, zoti ministër, vura re se interpelanca juaj është thellësisht me tone financiare dhe nqs do kishte qenë thjesht çështja për të mësuar se kush ishin shifrat që i ishin afruar dhe kush ishin ato që ne nuk ishim pranuar sigurisht që do ia kisha kërkuar ministrit të Financive, sepse besoj se do kishte argumente teknikë të përqendruar në këtë pjesë. Në të vërtetë ajo që unë ju kërkova është shumë e thjeshtë, sot që të shkosh nga Tirana në Peshkopi duhen rreth 5 orë, ashtu siç thatë dhe ju është diçka e patolerueshme që 70 km që do krijonin mundësinë që të bëhej për 1 orë kjo rrugë arrin të pesëfishohet koha vetëm e vetëm sepse ka patur një ngecje të projekteve dhe të premtimeve elektorale.

Unë do doja që të kërkoja disa gjëra konkrete në atë që ju shpjeguat dhe që kishte me pjesën e dytë ose thënë ndryshe me pjesën grafike. Thatë që Ura e Vashës – Bulqizë, një segment prej 9.8 km është mbaruar. Zoti ministër unë e kam bërë këtë rrugë, kjo pjesë nuk është futur në punë, kjo pjesë nuk është përfunduar, nuk shfrytëzohet sot, dhe në fakt problemi i madh është se aty ka dhe një tunel, i cili ka përfunduar, tuneli i Qafës së Buallit, i cili nuk është futur dot në shfrytëzim, është një trase e përfunduar, janë disa shtresa që duhet të hidhen dhe me një investim normal nga ana e qeverisë shqiptare, me një investim që do mund ta përballonte edhe buxheti i shtetit jo në ato terma që ju thatë, në terma shumë më modestë, do kishte mundësi që të kursesh me të paktën gjysmë ore rruga e sotme, por jo vetëm, do kishte mundësi që një terren shumë i vështirë gjatë stinës së dimrit të evitohej.

Nga ana tjetër ju folët për disa oferta që kanë ardhur, dhe me sa dëgjova ishin oferta të tilla që shkonin që në qershor 2013, më pas në vitin 2014, në shtator 2015, në mars 2016 etj., të gjitha nga kompania "China State Construction" të financuar nga Exim Bank. Unë kisha disa pyetje që i kam ende të paqarta sot e kësaj dite. Ju keni sjellë me urgjencë një ligj në parlament dhe ligji ishte në prill 2015. Keni miratuar një ligj i cili është unikal për nga lloji i tij. E kam lexuar me kujdes dhe parashikon që thuajse brenda 60 ditësh të përfundonte procesi, a ishit të sigurt ju kur e sollët këtë ligj në parlament. Çfarë sigurie patët, çfarë garancie patët? Kë firmë paguat, kë konsulent ligjor paguat? Kush ishin këta të cilët sollën këtë garanci kaq të madhe sa ju t'ia sillnit në parlament, në seancë plenare, nëpër komisionet, siguroni të garantoni shqiptarët që do bëhej në një kohë rekord dhe që ishte e detyrueshme që të vinte një projekt i tillë në mënyrë kaq urgjente.

Pikërisht, ky është një nga momentet që unë e quaj jo vetëm shumë joserioz por e quaj një problem të madh në marrëdhënie me parlamentin, marrëdhënie me legjislativin pasi është një akt i veçantë për nga lloji i tij dhe duhet të vinte në një moment në të cilin ishin të sigurt të gjithë hallkat e shtetit që ishte një proces që po vinte drejt përfundimit.

Këto dy momente besoj se janë diçka të cilët nuk gjejnë përgjigje në ato që ju sapo shpjeguat. Shpjegimi juaj ishte thellësisht financiar dhe pak politikë. Tani, unë do mundohem që të sjell përpara jush disa nga ato deklaratat të cilat unë i kam gjetur me shumicë kohët e fundit, por që do jua sjell përpara vëmendjes për të kuptuar se si ka evoluar kjo ide dhe çfarë i keni thënë shqiptarëve, dhe veçanërisht asaj zone që janë thellësisht të interesuar për projektin gjatë kësaj kohe. Do e filloj me deklaratën e kryeministrit në 16 dhjetor 2014, "jemi në fazën përmbyllëse të negociatave për një marrëveshje koncensionare për realizimin e segmentit kryesor të rrugës së Arbrit". Deklarata tjetër, zoti Haxhinasto në dhjetor 2014: "u nënshkrua memorandumi i bashkëpunimit me chinese exim bank përhapi në një kantiere projektesh në Shqipëri me financime kineze. Projekti i parë do të jetë Rruga e Arbrit që do nisë vitin e ardhshëm". Deklarata e tretë e zotit Ahmetaj: "nënshkrimi i memorandumit në 6 janar 2015. Për hapjen e disa projekteve në Shqipëri me financime kineze, projekti i parë i këtij bashkëpunimi do jetë rruga e Arbrit, do nisë vitin e ardhshëm". Deklarata tjetër "në fushën e transporteve risi është ndërfaqja e koncesioneve për ndërtim. Do të përmend dy projekte që janë tashmë duke u përpunuar si kontraktim publik e privat, një është ndërtimi i segmentit të Rrugës së Arbrit, që besoj që jetë risi e funddimrit, besoj në fund të shkurtit do jetë në tenderim". Është thënë



Edmond Haxhinasto

për ATSH më 29 janar 2015. Deklarata tjetër e juaja më 20 mars 2015, kompania kineze "China status contruction" do ndërtojë rrugën e Arbrit, kjo u bë e ditur për ATSH nga ministria e Transporteve dhe infrastrukturës dhe ju keni deklaruar se besoj se brenda muajit prill do miratojmë ligjin përkatës, në fakt ligji u miratua, për akordimin e kontratës së Rrugës së Arbrit, ende nuk ka bërë publike detajet e ofertës. Më pas kemi më 14 prill 2015 ka qenë në fakt në rastin e mbrojtjes së projektligjit në parlament. "Projektligji do jetë i veçantë duke qenë se kompania kineze i ka mundësitë financiare, për këtë segment kjo vlerë është 28.7 miliardë, është vlerë i projektit i llogaritur rreth 25 për qind më e ulët po atë ditë më 14 prill 2015 kjo rrugë nuk parashikon taksim, Rruga e Arbrit është nga projektet e parashikuara nga qeveria aktuale". "Fillimi e punimeve pritet të jetë në 2016, parashikohet të përfundojë brenda 3 viteve", këtë e ka thënë zoti Ahmetaj më 16 prill 2015. "Do të duhet të theksohet se projekti që kompania kineze ka sjellë është projekt i cili do të negociohet. Sa do të jetë kosto, sa transparente do të jetë? Besoj se ky parlament dhe institucionet e tjera kanë mundësi të ndjekin gjithë procedurën e negociatës", keni thënë ju më 16 prill 2015 dhe në fakt nuk kemi pasur mundësi që të marrim vesh asgjë se çfarë është bërë me procedurën e negociatën. Më pas kemi po një deklaratë tuajën i cili thotë se "me miratimin e procedurës së rrugës së Arbrit, i cili ka filluar që në vitin 2007, sot jemi në realizimin 50 për qind, taksimi i kësaj rruge potencialisht do vijë vetëm si rezultat i konkluzioneve të strategjisë të taksimit të rrugëve, pra po flitet edhe për strategjinë e taksimit ndërkohë që ende rruga e Arbrit nuk ekzistonte". Zoti Ahmetaj më 23 maj 2015: "miratohet ligji për përcaktimin e procedurës së veçantë për kontratën koncensionare ndërmjet shtetit shqiptar dhe shoqërisë "China state construction" tek infrastruktura mos harroni sot që është një formulë fituese që është "ëin-ëin" për shtetin shqiptar, për qytetarët shqiptarë, por edhe për kompanitë". Nuk e di çfarë kanë fituar kompanitë, por qytetarët shqiptarë dhe shteti shqiptar deri tani nuk ka fituar asgjë. Më pas kemi një deklarim të zotit Cani në Bulqizë më 8 qershor, "nga vjeshta fillon rruga e Arbrit me tunelin e dytë, pra po mendohej tuneli i dytë, se pari kishte përfunduar", shumë më i gjatë se ky dhe me Urën e Vashës që është shumë më e gjatë dhe një nga veprat e rralla në Shqipëri. ky është premtimi kryesor që ne kemi për gjithë qarkun e Dibrës, e keni mbajtur këtë premtim për qarkun e Dibrës? Më pas deklaratë e Kryeministrit Edi Rama në qershor 2015 " me këtë tunel jepet mesazh shumë i qartë për gjithë Dibrën që rruga e Arbrit nuk është më fantazim elektorale që shfaqet vetëm nëpër fushata, por është realitet mbi të cilin ne po punojmë fort, kemi siguruar dhe financimin në pjesën më të vështirë në një kompani ndër më të mëdhatë e Kinës. Ka shumë e shumë të tilla, zoti Haxhinasto në shtator të vitit 2015, në nëntor të vitit 2015, 2 dhjetor 2015, e fundit më 7 dhjetor të vitit 2015.

Po t'i lexoja të gjitha do të detyroheshim që të ishim dhe ne pak rutinor sepse do përsërisnim të njëjtën gjë. I vetmi problem që ka lindur për gjatë kësaj kohe është ky, rruga e Arbrit, sot shqiptarët duhet ta dinë nga ato që ju thatë, nuk do të bëhet dhe duhet të jemi të qartë për sa kohë nuk vendosnim të gjithë bashkë këtu në parlament, që është projekti më i rëndësishëm dhe duhet të gjejmë fondet aty ku mund të gjenden fondet, ashtu siç u gjetën për rrugë të tjera të rëndësishme siç ishte Rruga e Kombit mandatin e kaluar, por edhe rruga e Lumit të Vlorës, Qafë Plloçë – Qukës, pra për të gjitha segmentet që kanë një rëndësi të madhe. Kjo është me rëndësi primare sepse e keni premtuar 72 herë, është me rëndësi primare sepse janë njerëz të cilët po shfarosen, sepse nuk gjejnë mundësi tjetër për të jetuar në vendin e tyre, është me rëndësi primare sepse është një mundësi ekonomike që nuk po zhvillohet sot në vend, është me rëndësi primare sepse Dibra është një rajon që ka prodhuar histori. Është e kotë që sot të vijmë dhe t'i bëjmë elozhe njëri-tjetrit, të gjithë ne këtu jemi deficitar, mungojnë diçka, në të gjithë atë zonë, që është nga zona që po shkon drejt varfërimit çdo ditë dhe kjo vetëm e vetëm sepse nuk kemi pasur vëmendjen. Thënë ndryshe, rruga e Arbrit sot e kësaj dite do të vazhdojë të mbetet mes katër rrugëve, faleminderit.

EDMOND HAXHINASTO: KUR TË DISKUTOJMË BUXHETIN, VENDOSNI JU QË TË GJITHË PARATË E BUXHETIT TË SHTETIT T'I ÇOJMË TE KJO RRUGË ...

Me sa duket nuk shpëtojmë nga politizimi dhe i infrastrukturës, pavarësisht se kjo rrugë është përtej interesit të një partie ose një tjetër. Por mund të them që ju falënderoj shumë për citimin e deklaratave të mia, që konfirmuan dy gjëra: e para ndjeshmërinë e jashtëzakonshme që ka kjo rrugë, që e përçon dhe qeveria në deklarimet e shumta, e dyta konsistencën e qëndrimeve të cilat përpurthen totalisht me ofertat që na kanë ardhur. Tani po e shikoja, ka një përputhje dhe një konsistencë të jashtëzakonshme, mund ta verifikoni, në çdo rast jeni shprehur në varësi të procesit të negociatave. Kjo është e qartë e zeza mbi të bardhë. Bëtë disa pyetje që mendoj se duhet t'i përgjigjemi. Së pari, për çështjen e negocimit, sigurisht që ishte një rast i veçantë, unë e thashë vetë, dhe e veçanta e tij vjen se një kompani ofrohet me paratë e veta për të ndërtuar një rrugë dhe nuk mund të bëhet as me proces konkurrimi tjetër, përveçse me një negocim të drejtpërdrejtë, por kjo s'do të thotë që negocimi i drejtpërdrejtë të na bëjë ne të papërgjegjshëm dhe të mos kemi asnjë lloj meraku apo ndjeshmërie për mënyrën se si shpenzohen paratë publike. Sigurisht që procesi i negociatave këtë parashikonte, që ne të shkonim tek oferta më optimale dhe ofertë optimale siç janë paraqitur nga qeveria kineze nuk mund të arrihej. Prandaj kërkoheshin vazhdimisht oferta të reja. Cituat një moment që isha shprehur për çështjen e taksimit të rrugës. Po. Absolutisht që po. Sepse propozimi i qershorit 2014 është që investimi të kthehet nga taksa. Dhe sigurisht mund të shprehem që kemi një strategji kombëtare për taksimin. Është një dokument i cili ka përfunduar dhe po absorbohet nga niveli politikbërës dhe teknik i Ministrisë së Transporteve. Gjërat bëhen përgjithësisht me strategji, veçanërisht kur bëhet fjalë për taksim të rrugëve, që do të thotë që të kesh ndjeshmëri dhe kujdesin e duhur, prudencën e duhur që mos të taksosh ato segmente të cilat nuk mund ta mbajnë këtë taksim dhe jam shumë i kënaqur që është bërë një nga konsulencat më serioze. Numri i deklaratave, pa diskutim, është çështje shumë e ndjeshme për gjithë deputetët e zonës, por jo vetëm për deputetët e zonës, për gjithë shqiptarët. Është një çështje e rëndësishme dhe dua të theksoj dhe një herë tjetër që më shumë se sa ta trajtojmë këtë çështje nga këndvështrimi partiak politik, bëjmë mirë që kur të diskutojmë buxhetin, ta ngremë aty këtë çështje, të dalim të gjithë në një qëndrim të përbashkët dhe të gjithë paratë e buxhetit të shtetit t'i çojmë te kjo rrugë në qoftë se ju gjykoni kështu. Por unë mendoj që Shqipëria ka shumë nevoja dhe sigurisht duhet të gjejmë formulat më optimale me qëllim që çdo cent të publikut shqiptar ta trajtojmë në mënyrën më të përgjegjshme të mundshme. faleminderit.

MESILA DODA: RRUGA E ARBRIT BËHET ME NJERËZ SERIOZ, JO ME NJERËZ QË PARA SE TA NDËRTOJNË MENDOJNË TI TAKSOJNË

Më vjen mirë, në fakt, që të paktën tani filluam të vijmë në terma konkret se kush janë problemet, pse kanë ardhur deri tani, dhe kush dhe çfarë vërejmë. Akoma nuk e dimë pse 10 kilometërshi nuk është vënë akoma në shfrytëzim, dhe këtë s'ka ndonjë arsye, edhe mos të ma shpjegoni mua, por atyre banorëve të zonës që i kalojnë muajt e dimrit duke kaluar në atë rrugë të vështirë duhet t'ua shpjegojmë. Kjo ishte çështja e parë.

Çështja e dytë, zoti Haxhinasto folët këtu për këto 70 deklarata të dhëna gjatë kësaj kohe dhe thatë që është sensibilizim. Është sensibilitet i madh i juaji për këtë çështje, ok po e pranoj dhe këtë, por e di çfarë më kujton kjo. Kjo më kujton një fakt që nga njëherë vajza ime që kur shkon në shkollë dhe mundohet të përgatitet shumë për një test nuk ja bëjnë atë ditë, ja bëjnë ditës tjetër dhe vjen gjatë gjithë kohës me idenë që duhet ta kryejë këtë testin. Ne nuk jemi fëmijë këtu zoti Haxhinasto, ju kur sollët atë projektligj në parlament ju do ta kishit përfunduar, dhe kur të vinit këtu në parlament duhet të vinit të sigurt që kishte një projekt i cili do përfundonte brenda 60 ditëve siç ia kishit sjellë parlamentit. Por çfarë arsye e sollët në mënyrë urgjente dhe e miratuat në mënyrë urgjente, i dhatë para shtesë konsulentit n.q.s. nuk e kishit ende të qartë se drejt çfarë të panjohure po shkonit. Për çfarë arsye keni vite e vite që çdo tre muaj thoni që do e përfundojmë projektin, do e përfundojmë këtë çështje, dhe prapë arrijmë drejt zeros, dhe prapë arrijmë që themi është një projekt që të shikojmë edhe ca kohë mund ta shtyjmë por edhe ca kohë të tjera nuk e dimë a do bëhet apo jo. Kjo ka vetëm një emër, dhe kjo është per të bërë politikë me një projekt, i cili ka të bëjë me jetën e njerëzve dhe, politikë me jetën e njerëzve nuk bëhet. Përsa përmendet faktin që po përdoret politikisht etj etj., duhet të them vetëm një gjë: unë nuk kam lindur në atë zonë dhe nuk jam deputete e asaj zone, unë kam një origjinë nga ajo zonë por kjo nuk ka asnjë lidhje me këto që po ju kërkoj, unë po ju them vetëm diçka: Ata njerëz meritojnë që të kenë një mundësi në jetë, dhe mundësia e tyre është lidhja me kryeqytetin, mos e harroni dhe mos bëni as sarkazëm dhe as ironi kur thoni që ka dhe rrugë tjera, sigurisht që ka dhe rrugë të tjera Shqipëria, por është një zonë që është nga më të varfrat në vend dhe kjo falë mosseriozitetit të të gjitha qeverive që shkojnë e vijnë, premtojnë rrugën e Arbrit dhe rruga e Arbrit nuk ekziston kërkund as virtualisht. Ky është serioziteti me të cilën duhet të shfaqemi me njerëzit dhe t'u themi të vërtetën, rruga e Arbrit bëhet me njerëz serioz dhe nuk bëhet me njerëz të cilët thjeshtë e imagjinojnë vepra të tilla dhe para se t'i imagjinojnë mendojnë edhe se si do t'i taksojnë. Kjo nuk është serioze, kjo nuk është politikë, kjo nuk është bërit të ketë një kontakt serioz dhe një kontakt njerëzor me njerëzit. Faleminderit.

EDMOND HAXHINASTO: KJO RRUGË ËSHTË KONCEPTUAR KEQ QË NË FILLIM

Edhe ndërhyrja juaj ishte jashtë procedurës, por reagimi këtu ishte sikur mos të kishte dëgjuar fare shpjegimin që unë dhashë. Ju thashë shumë qartë se sa janë investuar në këto 3 vjet. Ju thashë shumë qartë që çdo segment i kësaj rruge, jua tregova dhe në mënyrë grafike, ka nevojë për para të tjera. N.q.s. për ju këto nuk kanë rëndësi dhe mendoni se duke trajtuar, e përsëris, politikisht këtë çështje mund të fitoni ndonjë kredibilitet politik, është çështja juaj. E theksoj dhe njëherë dhe këtu e mbyll. Kjo rrugë është konceptuar keq që në fillim. Është planifikuar vetëm 50 për qind e saj me projekt e le më pastaj për të tjerat. Është investuar në 3 vjet 6 miliardë po nevojat janë për shumë më tepër. Vetëm për të përfunduar pjesët e bëra më përpara, jo segmentin aktual, duhen 30 milionë euro, të cilat nuk i ka buxheti i shtetit.

MESILA DODA: RRUGA E ARBRIT NUK PO BËHET DHE NUK KA NDËRMEND TË BËHET ME MENTALITETIN QË JU KENI

Më vjen shumë mirë në fakt që sensibiliteti, më së fundi sensibiliteti i ministrit arriti të zgjohej dhe të thyente dhe rregullat e procedurës së interpelancës, që sot për herë të parë ka tejkaluar atë që paraqitet në rregullore. Megjithatë, e ripërsërsis edhe njëherë këtë fakt. Asgjë nga kjo që kam thënë unë sot nuk ka lidhje me përfitimet partiake. Duhet ta mësoj dhe zotin ministër që ca gjëra bëhen dhe që mos të përfitosh në mënyrë partiake, por duhet t'u thoni njerëzve të vërtetën. Rruga e Arbrit nuk është bërë, dhe rruga e Arbrit nuk po bëhet dhe nuk ka ndërmend të bëhet me gjithë mentalitetin që ju i keni vënë këtij projekti madhor për Shqipërinë dhe për shqiptarët.

Rruga e Arbërit nr. 122



Mashtrimet e Haxhinastos dhe të vërtetat e projektit për Rrugën e Arbrit

Nga **FARUK KABA***

Edëgjova intervistën e ministrit Haxhinasto në parlament për rrugën e Arbrit. Mbeta i shokuar! Me të vërtetë nuk e kuptoj se si ka mundësi, që të flasë në atë mënyrë personi që mban përgjegjësinë kryesore për infrastrukturën në Shqipëri.

Në fakt ai ka vepruar me koshiencë, pasi faktet janë flagrante dhe ai si Ministër për këtë mban përgjegjësi. Por, si dhe herë të tjera, zgjodhi një rrugë tjetër, dinakërinë, duke zgjedhur këtë herë përbaltjen e projektit, për të justifikuar, jo vetëm zgjatjen pafund dhe ndoshta me koshiencë të veprës, dështimin dhe paaftësinë e tij dhe të vartësve, por edhe për të vazhduar me teorinë e shtyrjes në "Kalendat Greke" të këtij projekti të rëndësishëm, që sikur edhe sot të përfundonte, do të duhej konsideruar shumë i vonuar.

Po i rendis kronologjikisht ato që tha dhe faktet si qëndron e vërteta:

- Ministri deklaroi se rruga është filluar në vitin 2008. Në të vërtetë fillimi është që në vitet e fundit të monizmit, kur filloi (por nuk u arrit të përfundojë) Masterplani i Rrjetit Rrugor të Shqipërisë, pra që në vitin 1988 (sot Ministria, që ai drejton, akoma punon pa një Masterplan të rrugëve). Në vitin 2003 filloi realizimi i këtij projekti me kryerjen e Studimit të Fizibilitetit dhe deri në vitin 2008 ishin realizuar disa punime dhe përfunduar seksioni Bulqizë-Ura Cerenecit. Nuk mund të themi se nuk ka rëndësi deklarata e mësipërme pasi ai është ministër dhe nuk mund të dalë para parlamentit (nënkupto para gjithë opinionit qytetar) dhe të thotë pasaktësira të tilla.

- Ministri tha se rruga Arbërit shkurton 50 kilometra rrugën egzistuese. Edhe kjo një tjetër pasaktësi, që jo rastësisht përkon pak a shumë me atë më lart dhe duket që është në të njëjtën linjë të nënvlerësimit të këtij projekti, pasi rruga në të vërtetë shkurton 81 kilometra fizike. Edhe nëse nuk e di zoti Ministër mund t'ja kishin thënë "ekspertët" e tij. Madje, në një tregues, që përdoret rëndom në inxhinieri, që quhet gjatësia virtuale dhe që është gjatësia e vërtetë e rrugës, ky shkurtim është më shumë se 100 kilometra. Nëse Ministri nuk e di mund t'ja vërtetojmë edhe me llogaritje, që ta ketë në konsideratë. Thënia e tij për shkurtim prej vetëm 50 kilometra është një pavërtetësi jo e rastësishme. Dhe është paksa ironike të mendosh se vetëm para disa muajsh ai ka deklaruar në media, për një investim absurd siç është rruga Qukës - Qaf Plloçe, kur tha se shkurton 50 minuta kohë udhëtimi (!) (që do të thotë afërsisht 60-70 kilometra rrugë). Në fakt shkurtimi i kësaj rruge, besoj të gjithë duhet ta dinë, nuk është veçse 2-3 kilometra! Nuk e tha me kilometra se i dilte e pavërteta, por e tha me kohë udhëtimi! Por le ta trajtojmë një herë tjetër këtë çështje.

- Ministri tha se rruga kalon në kuotë 930 metra mbi nivelin e detit dhe do të ketë aq e kaq probleme dimri etj. etj. sajesa të pavend. Edhe rruga nacionale në Qaf Thanë kalon egzaktësisht në këtë kuotë dhe çfarë ka ndodhur? Asgjë e veçantë. Dhe për më tepër kjo lartësi është vetëm në një pikë, ndërkoha që rruga ulet në mënyrë të ndjeshme në të dy anët e saj, krejtësisht e evitueshme nga problemet e dimrit. Por nga ana tjetër, zoti Minister, ju sapo keni filluar së ndërtuari një rrugë nga Qukësi në Qaf-Plloçë, e cila kalon jo më në një pikë të vetme, por për rreth 20 kilometra është në lartësi mbi 1000 metra mbi nivelin e detit dhe në mëse 3 kilometra në lartësi mbi 1250 metra?! Çfarë do të ndodhë me atë rrugë? Kjo është krejt e pandershme dhe në këtë rast përgjegjësia është shumë e lartë.

Ministri tha se rruga Arbrit shkurton 50 kilometra rrugën egzistuese. Rruga në të vërtetë shkurton 81 kilometra fizike. Thënia e tij për shkurtim prej vetëm 50 kilometra është një pavërtetësi jo e rastësishme. Dhe është paksa ironike të mendosh se vetëm para disa muajsh ai ka deklaruar në media, për një investim absurd siç është rruga Qukës - Qaf Plloçe, kur tha se shkurton 50 minuta kohë udhëtimi (!) (që do të thotë afërsisht 60-70 kilometra rrugë). Në fakt shkurtimi i kësaj rruge, besoj të gjithë duhet ta dinë, nuk është veçse 2-3 kilometra!

Ministri tha se rruga kalon në kuotë 930 metra mbi nivelin e detit dhe do të ketë aq e kaq probleme dimri. Kjo lartësi është vetëm në një pikë, ndërkoha që rruga ulet në mënyrë të ndjeshme në të dy anët e saj, krejtësisht e evitueshme nga problemet e dimrit. Por nga ana tjetër, zoti Minister, ju sapo keni filluar së ndërtuari një rrugë nga Qukësi në Qaf-Plloçë, e cila kalon jo më në një pikë të vetme, por për rreth 20 kilometra është në lartësi mbi 1000 metra mbi nivelin e detit dhe në mëse 3 kilometra në lartësi mbi 1250 metra?! Çfarë do të ndodhë me atë rrugë? Kjo është krejt e pandershme dhe në këtë rast përgjegjësia është shumë e lartë.

- Ministri nuk tha të vërtetën kur shpjegoi se rruga e Arbrit nuk është planifikuar për 6.5 kilometrat e fundit. Edhe kjo është sarkastike. Por kujt po i qaheni ju zoti Ministër? Ju që keni qenë zëvendës ministër i po kësaj ministrie disa vite më parë dhe tani ministër! Është e vërtetë, që akoma edhe sot pas gati 13 vjetesh, që është realizuar dhe miratuar zyrtarisht nga Qeveria Shqiptare studimi i Fizibilitetit të kësaj vepre, që kanë përfunduar projektzbatimet e segmenteve të tjerë, një segment i fundit nga Ura Cerenecit deri në kufi (në Gjoricë), është akoma pa projektzbatimi, njëkohësisht dhe planifikim. Kjo është përgjegjësia juaj totale, pasi këtë fakt ju duhej ta dinit, që në momentin e marrjes së detyrës si ministër dhe asgjë nuk ju justifikon. Kjo tregon harresën dhe neglizhencën tuaj, që për t'ja hedhur fajin të tjerëve e bën 6.5 kilometra, kur në të vërtetë s'është veçse 3.7 kilometra nga Ura Cerenecit deri në kufirin shtetëror dhe kjo për fajin e tuaj dhe strukturave që drejtoni.

- Ministri disinformon kur thotë se 10 kilometra (në fakt janë jo 10 por 13.2 kilometra) nga Ura Vashës deri në Bulqizë janë të përfunduara. Por këtë "e kapi" deputetja Doda, e cila ja tha troç, se ky segment nuk është aspak i përfunduar. Investimi i bërë në këto 13 kilometra, që prej disa vitesh është lënë i pa shfrytëzuar, përbën një dëm ekonomik, megjithë mundësinë e shmangies dhe vënies në eficence, që ka qenë plotësisht e mundur. Kjo tregon që, ose ai nuk thotë të vërtetën ose nuk e njeh gjendjen. Njëra më keq se tjetra! Në këtë segment është prezent edhe një çudi tjetër: tuneli i Qaf Bullit, i projektuar me gjatësi 890 ml, "u shkurtua" në 300-350ml! Një veprim skandaloz nga pikpamja teknike dhe i qëllimshëm, për afera jo te pastra. Ndoshta është bërë nga administrata e mëparshme, por kjo nuk ndryshon asgjë dhe nuk e shfajëson ministrin dhe administratën e tij. Rëndësi ka fakti që me këtë është kryer një masakër teknike, e cila do të duhej të ndëshkohej në mënyrë shembullore, ndërsa për ministrin tonë këto nuk kanë fare rëndësi dhe ky segment quhet i përfunduar?! Ai qoftë.

- Ministri përmendi një kompani fantazmë, që gjoja paska marrë përsipër të ndërtojë rrugën e Arbrit, për aq e kaq muaj, me një çmim shumë më të ulët se kinezët etj. etj. Për mendimin tonë papërgjegjësira pa fund. Unë nuk i besoj dhe nëse është e vërtetë, përse nuk e publikon? Jam i bindur se të gjithë shqiptarët do të jenë dakord, që ta marrë dhe të fillojë sa më parë. Por sigurisht, që kjo nuk është kështu siç e paraqet ministri ynë. Ligji shqiptar i Koncesioneve është i qartë: propozuesi duhet të bëjë një kërkesë zyrtare dhe qeveria duhet ta publikojë dhe më pas të hedhë edhe në tender. Sjelljet e tjera lenë vend për dyshime dhe afera jo të sinqerta. Në të njëjtën kohë, zotit ministër Haxhinasto i është dorëzuar zyrtarisht një propozim konkret, shumë realist, nga ekspertë të fushës dhe jo nga anonimë, për ndërtimin e rrugës së Arbrit nga Shteti Shqiptar me nje shifër shumë më realiste se oferta "cinike" kineze. Propozimi supozon ndërtimin paraprakisht të një bajpasi në vend të tunelit të Murrizit, që do të shkurtonte jovetëm buxhetet e nevojshme, por edhe afatin e ndërtimit, për realizimin e veprës dhe hapjen e rrugës në 15 deri 18 muaj.

replikë

Ai që hedh baltë tani për projektin deri në parlament, jo vetëm që nuk ka as më të voglin kontribut, jo vetëm nuk e njeh këtë lëmë të ekonomisë, por po të jetë me të vërtetë i bindur, le të ballafaqojë të dy palët, projektuesit dhe ata që i fryjnë në vesh, për të parë si qëndron e vërteta. Madje, zoti Minister, kinezët që në fillim të njohjes me këtë vepër, tentuan të bëjnë ndërhyrjen në këtë projekt, duke dyshuar në saktësinë dhe cilësinë e tij. Por dështuan plotësisht dhe nuk ja arritën. Këtë e kemi me fakte, pasi edhe në propozimin e fundit të dërguar dikasterit tuaj, kanë paraqitur disa propozime, që përkeqësojnë karakteristikat e rrugës dhe nuk i përmirësojnë ato.

Ministrit Haxhinasto i është dorëzuar zyrtarisht një propozim konkret, shumë realist, nga ekspertë të fushës, për ndërtimin e rrugës së Arbrit nga Shteti Shqiptar me një shifër shumë më realiste se oferta "cinike" kineze. Propozimi supozon ndërtimin paraprakisht të një bajpasi në vend të tunelit të Murrizit, që do të shkurtonte jovetëm buxhetet e nevojshme, por edhe afatin e ndërtimit, për realizimin e veprës dhe hapjen e rrugës në 15 deri 18 muaj.

A i është bërë e ditur kjo Kryeministrit? Kemi dyshimin se jo. Hapja e tunelit të Murrizit është e pashmangshme, por në vështirësitë, kohën e gjatë dhe buxhetet e konsiderueshme, që kërkon ky tunel, ndërtimi i një bajpasi do të ishte një zgjidhje e pranueshme dhe racionale. Por zoti Ministër nuk pati as impenjimin më të vogël, për të urdhëruar specialistët e tij, që të merrnin në konsideratë dhe të jepnin një përgjigje për këtë propozim. Dhe në Parlament nuk shtron këtë propozim shumë të vlefshëm dhe realist të bërë nga ekspertë, por sjell diçka, që nuk është as serioze, as e rregullt. Nuk na mbetet veçse te themi edhe një herë: Ai qofte!

Së fundi, do të desha të sqaroj diçka shumë të rëndësishme për projektin dhe për opinionin, që në fakt e kishte vendin në krye të këtij shkrimi: Projekti i rrugës së Arbrit është dhe mbetet një zgjidhje e jashtëzakonshme, e guximshme dhe shumë e suksesshme inxhinierike shqiptare. Ishte kjo dhe argumentimi profesional inxhinierik dhe shkencor, që bindi qeverinë dhe ministrin e fillim viteve 2000, si një ekspert i vërtetë i rrugëve dhe i punëve të transportit, që trajtoi me kujdes dhe kompetencë projektin dhe e miratoi atë brenda të gjitha rregullave, legjislacionit dhe strukturave të Shtetit Shqiptar. Ai që hedh baltë tani për projektin deri në parlament, jo vetëm që nuk ka as më të voglin kontribut, jo vetëm nuk e njeh këtë lëmë të ekonomisë, por po të jetë me të vërtetë i bindur, le të ballafaqojë të dy palët, projektuesit dhe ata që i fryjnë në vesh, për të parë si qëndron e vërteta. Madje, zoti Minister, për dijeninë tuaj, jo miqtë tuaj pseudoprojektues, që ju flasin "pas veshit", por edhe kinezët tuaj, që në fillim të njohjes me këtë vepër, tentuan të bëjnë ndërhyrjen në këtë projekt, duke dyshuar në saktësinë dhe cilësinë e tij. Por dështuan plotësisht dhe nuk ja arritën. Këtë e kemi me fakte, pasi edhe në propozimin e fundit të dërguar dikasterit tuaj, kanë paraqitur disa propozime, që përkeqësojnë karakteristikat e rrugës dhe nuk i përmirësojnë ato. Nëse do të dëshironit për këtë çështje zoti Ministër, mund të sillni edhe një audit të huaj (mundësisht jo nga ata që kanë bërë paçavure me rrugët tona si me rrugën Memaliaj - Gjirokastër, Bajpasin e Fierit, rrugën e Kombit në pjesë të veçanta të saj etj.) dhe atëhere do të bindeni edhe vetë nëse keni edhe vetë dyshime dhe se si është e vërteta.

Shënim: *Shkrimi i mësipërm nga Ing. Faruk Kaba, i është dërguar për informacion kryetarit të shoqatës "Bashkësia Dibrane", Bujar Kapexhiu, i cili ka përdorur ndikimin e tij në gazetën "Mapo" për tu botuar. Një version i redaktuar dhe shkurtuar është botuar në "Mapo" më 14 qershor 2016. Shkrimi i botuar më sipër është i plotë dhe pa shkurtime. Titulli dhe nëntitujt anë të redaksisë.*

Shqiptarët janë optimistë dhe besojnë se kjo nismë kino-shqiptare do të ketë perspektivë dhe do të realizohet si një projekt konkurrent, që siguron jo vetëm një komunikacion komod midis pjesëve të Shqipërisë, por, në perspektivë, edhe daljen në korridorin vertikal të Ballkanit Beograd-Selanik.

Edhe Rruga e Arbrit mund të jetë pjesë e nismës 16 + 1

Më 8 qershor, në qytetin Ningbo të Kinës jugore, një nga zonat e lira ekonomike më të hershme të Kinës, u zhvillua takimi i tretë i 16 vendeve të Europës Qendrore e Lindore plus Kinën, nismë e njohur me emrin 16 + 1.

Në kuadër të këtij takimi, në të cilin u përqafësuan në nivele zyrtare dhe shkencore të gjitha vendet e 16-shes, pa Shqipërinë, ishin planifikuar disa veprimtari, të gjitha shprehje të një vullneti të ri të qeverisë kineze, që shenjohet në sloganin *Një brez, një strategji,* dhe gjithashtu shprehje e vullnetit të vendeve të 16-shes europiane për ta parë këtë nismë si një alternativë bashkëpunimi me interes të ndërsjelltë. Përveç takimeve në nivel të funksionarëve qeverisës, në Ningbo u zhvillua edhe Forumi Intelektual Ndëruniversitar për Bashkëpunim në fushat e edukimit dhe të shkencës, për t'iu përgjigjur nismës 16 + 1 edhe me përgatitjen e dyanshme të ekspertëve. Paralelisht, në të njëjtin qytet u hap ekspozita e prodhimeve të vendeve të 16-shes, në të cilën mori pjesë dhe Shqipëria, kryesisht me biznese të industrisë ushqimore. Pati dhe disa aktivitete të tjera, shkencore dhe diplomatike.

Në Forumin Intelektual Ndëruniversitar për Bashkëpunim në fushat e edukimit dhe të shkencës, me interesimin e drejtuesve të *Beijing Foreign Studies University,* ku gjendej si pedagog i ftuar që nga mesi i muajit maj, mori pjesë dhe studiuesi Shaban Sinani, i cili njoftoi shkurtimisht për *Rrugën e Arbërit:*

Universiteti ku isha i ftuar, pohoi për *Rrugën e Arbërit* z. Sinani, i shqetësuar se në këtë forum nuk kishte asnjë përfaqësues nga Shqipëria (madje as përfaqësimi prej ambasadës së Shqipërisë në Pekin ishte i pamundur, për shkak të mungesës së plotë të funksionarëve), më propozoi që të ndërprisja për tri ditë mësimdhënien dhe të merrja pjesë në këtë forum, në të cilat 15 vendet e tjera europiane përfaqësoheshin prej delegacionesh të plota, kryesisht rektorë të universiteteve dhe kërkues shkencorë. E pranova ftesën jo thjesht për të mos e lënë bosh vendin e Shqipërisë, por edhe me dëshirën që së paku të shprehja një vullnet pozitiv bashkimi me nismën e njohur, në të cilën ka pasur përfaqësues zyrtarë në dy takimet e mëparshme, por edhe për të



Në foto: Prof. Shaban Sinani në takimi i tretë të 16 vendeve të Europës Qendrore e Lindore plus Kinën, nismë e njohur me emrin 16 + 1.

Duke vlerësuar sinjifikancën e nismës për themelimin e Lidhjes Ndëruniversitare "Rruga e Mëndafshit", sipas formulës 16 + 1, përmenda në takim se Shqipëria ka arsye historike, kulturore dhe pragmatike të jetë pjesë e këtij themelimi. Kanë qenë dy perandorë ilirë: Diokleciani dhe Justiniani, ata që nxorën urdhrat më të hershëm në histori për përdorimin e mëndafshit në veshjet perandorake, çka do të thotë se qysh në shekujt IV-V, drejtpërsëdrejti apo tërthorazi, Kina ishte e njohur në pellgun e Mesdheut.

Rruga e Mëndafshit më sjell ndërmend një nismë tjetër, dypalëshe, shqiptaro-kineze, shumë e diskutuar në Shqipëri, nismën për ndërtimin e Rrugës së Arbrit, e cila e përshkon vendin në drejtim tangencial, si një korridor i ndërmjetëm midis projektit amerikan të njohur me emrin Korridori 8, që në fakt nuk është bërë dot një korridor i vërtetë, dhe Rrugës së Kombit, që hë për hë zgjidh probleme vetëm për komunikimin Shqipëri-Kosovë.

sjellë në Tiranë të rejat rreth saj. Në fjalën time të shkurtër theksova se mungesa e një përfaqësuesi zyrtar të Shqipërisë nuk duhej kuptuar si mungesë interesi prej saj për t'u ripërfshirë në nismat 16 + 1 dhe *Një brez një rrug*ë. Falënderova Universitetin e Gjuhëve të Huaja të Pekinit, që më kishte mundësuar pjesëmarrjen, dhe përmenda se Shqipëria ka jo vetëm interes të drejtpërdrejtë ekonomik, por edhe arsye historike, që lidhen me një traditë miqësie e bashkëpunimi prej dy dekadash, që njihet nga të gjithë. Përmenda se nismat kineze, sidomos në infrastrukturë, si autostrada Adriatik-Jon, ose rindërtimi i rrjetit hekurudhor në gadishullin tonë, mund të lehtësojnë edhe kapërcimin e vonesave krejt të mirëkuptueshme për rajonin e Ballkanit, në të cilin për 500 km autostradë duhet të nënshkruajnë marrëveshje 7-8 shtete. Duke iu referuar përvojës kineze në hekurudha u kujtova të pranishmëve se për të udhëtuar nga Pekini në Shangai duhen vetëm tri orë e gjysmë, kurse nga Podgorica në Beograd duhen 24 orë, megjithëse distanca është më pak se një e dhjeta.

Në përmbyllje të Forumit u themeluar nisma për Lidhjen e Universiteteve të "Rrugës së Mëndafshit", e cila u pranua me optimizëm dhe me vullnet pozitiv nga të gjitha delegacionet. Pas kthimit në Tiranë jam duke u përpjekur që personalisht dhe në rrugë zyrtare edhe disa universitete të Shqipërisë të jenë të bashkuara me këtë nismë, po ashtu dhe të Kosovës, si të vetmet vende pa përfaqësues zyrtarë në takim. Shpresoj që kontaktet mes tyre të vendosen dhe më tej bashkëpunimi të shkojë mirë.

Duke vlerësuar sinjifikancën e nismës për themelimin e *Lidhjes Ndëruniversitare "Rruga e Mëndafshit",* sipas formulës 16 + 1, përmenda në takim se Shqipëria ka arsye historike, kulturore dhe pragmatike të jetë pjesë e këtij themelimi. Kanë qenë dy perandorë ilirë: Diokleciani dhe Justiniani, ata që nxorën urdhrat më të hershëm në histori për përdorimin e mëndafshit në veshjet perandorake, çka do të thotë se qysh në shekujt IV-V, drejtpërsëdrejti apo tërthorazi, Kina ishte e njohur në pellgun e Mesdheut. *Rruga e Mëndafshit* më sjell ndërmend një nismë tjetër, dypalëshe, shqiptaro-kineze, shumë e diskutuar në Shqipëri, nismën për ndërtimin e *Rrugës së Arbrit*, e cila e përshkon vendin në drejtim tangencial, si një korridor i ndërmjetëm midis projektit amerikan të njohur me emrin *Korridori 8*, që në fakt nuk është bërë dot një korridor i vërtetë, dhe *Rrugës së Kombit,* që hë për hë zgjidh probleme vetëm për komunikimin Shqipëri-Kosovë. Shqiptarët janë optimistë dhe besojnë se kjo nismë kino-shqiptare do të ketë perspektivë dhe do të realizohet si një projekt konkurrent, që siguron jo vetëm një komunikacion komod midis pjesëve të Shqipërisë, por, në perspektivë, edhe daljen në korridorin vertikal të Ballkanit Beograd-Selanik.

Ç'kemi asaj Dibre!

Nga **BUJAR KAROSHI**

Ky muaj nisi me debatin për Rrugën dhe mbaroi me lajmet për Rrugën. Si gjithmonë, "tigani në zjarr - lepuri në zabel"... "Do ta fillojmë, do ta bëjmë, por s'kemi lekë"...

Dibrania e PDIU e ngriti çështjen e Rrugës në parlament. Ashtu si paraardhësit e saj. Shumë zhurmë për rrugën për asgjë. Ama, ndoshta me këtë ua merr mendja se mund të marrin bashkinë. Se në fund të fundit, Dibra me Çamërinë të njëjtën plagë kanë... Tani e më pas është mirë të themi se "Jam çam prej Dibre"...

Pas seancës parlamentare të gjithë u janë sulur deputetëve dibranë. "Çimën prej çulli sun e çesin". Por, kot u biem në qafë... Ata deputetë janë dhe deputetët nuk merren me ndërtime rrugësh... Ata ndërtojnë të ardhmen e ndritur...

Ministri tha se janë ofruar kompani shqiptare për të ndërtuar rrugën e Arbrit, por se kush janë dhe sa ofrojnë nuk e thotë. Ndoshta nuk kanë rënë dakord për përqindjet... Deri atëherë e shtyjmë më shprehjen "presim oferta të reja nga Kina".

Nga Kina nuk ka lajme të reja, se ose nuk ka kush i sjell, ose nuk shkon kush ti marrë... Takimi i vendeve "16+1" tani do të kthehet në "15+1", pasi Shqipëria jo vetëm nuk shkon, por edhe kur e merr mundimin shkojnë me duar në xhepa: pa ide e pa projekte...

Rama ishte në Bulqizë, sigurisht jo për Rrugën... Për Rrugën do shkojë kur të vijë fushata. Tani ishte për Kromin dhe për Dritat. Bulqizakët nuk kanë para t'i paguajnë, ama linjën elektrike e kanë moderne dhe sahatin e kanë fringo të ri...

Por, ndërsa ata që s'kanë marrin borxh t'i paguajnë, ata që paguhen me rrogë nga shteti marrin vërtetime fallso sikur janë pa punë... Kështu që, qeveria edhe rrogë u jep, edhe i ndihmon të mos paguajnë dritat...

Qeveria po ia qan shumë hallin koncensionarit të kromit. Kështu që ia rriti marrëveshjen edhe 10 vjet. Dikush do t'ia rriste afatin, kështu që më mirë t'ia rrisë Rilindja...

Rezultatet e para të mbjelljes së pishave në Lurë dolën... Nuk e kam fjalën për investigimin e BIRN që nuk mbinë pishat që u mbollën me lekë. E kam fjalën që Bashkia Mirditë ka bërë një projekt ta asfaltojë rrugën për Lurë. Kështu që ne nga Tirana do kemi mundësi të shkojmë ndonjëherë për fundjave, ndërsa ata nga Dibra të presin edhe pak, sa të zgjedhin kryetarin e ri dhe sa të mbarojnë projektet në Facebook.

Protestat kundër Skavicës i kemi ndërprere njëherë. Nuk ia del dot qeverisë: Ajo është e fjalës së mbajtur, pa i shkuar deri në fund nuk ka në plan të dëgjojë. Punë e madhe se përmbytet Dibra...

Andej nga Dibra ka filluar vapa dhe freskun e gjen vetëm po të marrësh malet... Por këtë radhë më kështilluan në Peshkopi që malet t'i marr nga shtatori e pas, sa të mbarojë periudha e korrjeve... "Se nuk i dihet, më kështilluan, mund të të marrë aparati ndonjë foto me kanabis dhe të gjen belaja"...

Pavarësisht këtyre çështjeve, ky ka qenë një muaj i bekuar... S'kemi lënë restorant pa parë e ushqim pa provuar... Na janë bërë iftarët si dasmat: restoranteve... Megjithatë, Gëzuar!



Apelimi i Drinit

Unë, Drini i soçëm, jam fort i qëmoçëm,
Ç'them, e them me çiltërsi të pasqyrtë,
Mos m'i trazoni kohrat, o të soçëm,
Në të gjitha kohrat rrjedh i njëngjyrtë...

Vërshoj, rivërshoj, përmbys, ripërmbys,
Në shtratin ku rrjedh, nuk dua ngacmim.
Po më ngacmuat, zemërimthi ju ngrys,
Shtratin e kam të vetmin amshim...

Për ç'më dëmtuat, ju bëj riqortim,
Juve, që s'duroni në sy një halë
Dhe kam të drejtë për apelim,
Unë, i qëmoçmi, që vazhdoj t'ju fal!...

Nexhip Ejupi

Rruga e Arbërit nr. 122

investigim

Shënim i redaksisë:
Shkrimi i mëposhtëm është një punë disamujore investiguese e gazetares Jetona Kocibelli. Redaksia e gazetës i vendosi në dispozicion autores gjithë materialet e saj të botuara ose jo në lidhje më çështjen e HEC mbi Drin. Duke përdorur edhe burime të tjera të informacionit, ajo ka arritur të shkruaj një raport të hollësishëm rreth çështjes, duke nisur që nga koha e komunizmit deri te e vërteta e sotme në terren. Ky material është botuar në reporter.al dhe në disa media të tjera online, por për shkak se kjo çështje është aktuale dhe me ndjeshmëri të lartë për rajonin e Dibrës, vendosëm ta ribotonim. Me këtë rast, falënderojmë autoren për punën e mirë dhe shpresojmë që raporti i saj të ndikojë pozitivisht pranë organeve vendimmarërse në dobi të banorëve.

Rrjedha e lumit Drin i Zi, ku pritet të ndërtohet diga e hidrocentralit "Katund i Ri" | *Foto nga : Jetona Koçibelli*



"Promovimi i dukshëm dhe problematik i kompanive, për mua të panjohura, siç është rasti në fjalë, pa i paragjykuar aspak ato, me gjasa do të mbajë larg pjesëmarrjen e kompanive të mëdha europiane në këtë projekt".

Bonusi për Turqit vë në dyshim garën për HEC-in "Katund i Ri"

Tenderi i hapur nga qeveria për ndërtimin me koncension të hidrocentralit "Katund i Ri" vihet në pikëpyetje nga akuzat për favorizimin e kompanive turke, mungesën e transparencës dhe konsultimin me komunitetin – i cili ka frikë se tokat dhe shtëpitë që pritet të përmbyten nga diga, do të shpronësohen me çmime qesharake.

Nga **JETONA KOÇIBELLI** | BIRN | Tiranë

Prej 20 vjetësh, djemtë e Shaban Beçës kanë punuar në fushat e duhanit në Itali. Me kursimet e tyre, ata kanë ngritur në fshatin Podgorcë të Dibrës një restorant të këndshëm me gatime tradicionale të zonës, kopshtin, shtëpitë dhe gjithçka kanë – buzë lumit Drin i Zi. Tokat bujqësore të Beçës dhe ato të fshatit janë të punuara me kujdes dhe të mbjella me misër, grurë dhe shalqi.

Por e gjithë kjo pasuri, fryt i punës shumëvjeçare të familjes së tij rrezikon të zhduket – e përmbytur nga ujërat e lumit, pas ndërtimit të hidrocentralit "Katund i Ri."

"Unë prekem shumë, sepse kam biznes, kam edhe shumë prona, 60 dynym [tokë] që më përmbytet komplet," thotë Shabani, i cili nënvizon se restoranti i dhimbset më tepër, për të cilin ka vite që kujdeset së bashku me djemtë.

"Nuk kam informacion për kompensim, por më e rëndësishmja, nuk kam dalë në shitje," shtoi ai, duke shpjeguar se askush nuk kishte ardhur për t'i takuar dhe se dyshonte se banorët po "tradhëtoheshin."

Më 24 maj, ministria e Energjisë dhe Industrisë, MEI, hapi një tender ndërkombëtar për dhënien me koncension të hidrocentralit "Katund i Ri", pasi më parë i kishte dhënë një bonus bashkimit të përkohshëm të kompanive turke "Nurol" dhe "Suzer," si ofertë e pakërkuar.

Ekspertët e kundërshtojnë bonusin si të pabazuar në ligj, duke e akuzuar qeverinë për mungesë transparence dhe favorizim të qartë të kompanive turke për fitimin e tenderit për ndërtimin e HEC-it – pjesë e njërës prej veprave më të rëndësishme hidroenergjetike në vend.

BIRN gjithashtu ka mësuar që përveç kompanive turke, qeveria ka marrë edhe dy propozime për hidrocentrale në lumin Drin nga kompani Kineze për të ashtuquajturin projekti i Skavicës së Madhe –ku HEC-i "Katund i Ri" bën pjesë – por ofertat e tyre nuk janë marrë parasysh.

Ndërkohë, banorët e Dibrës – tokat e të cilëve pritet të preken nga ndërtimi i digës së hidrocentralit – ankohen se nuk kanë marrë majftueshëm informacion mbi projektin dhe skemën që do të aplikohet për shpronësimet e mundshme të pronave të tyre.

Ata shtojnë se konsultimet publike nga ana e qeverisë për projektin kanë munguar, duke u shtuar ankthin që pronat e tyre nuk do të vlerësohen drejt.

E pyetur nga BIRN, ministria e Energjisë u shpreh se edhe pse kishte mbajtur një dëgjesë publike mbi projektin, ajo nuk ishte përgjegjëse për konsultimet me publikun – një detyrim që sipas saj i përket kompanisë koncensionare që do të fitojë tenderin për hidrocentralin.

NGA PROJEKTI I SKAVICËS, TE "KATUND I RI"

Hidrocentrali "Katund i Ri" është pjesë e projektit energjetik të Skavicës, i cili u propozua për herë të parë në fillim të viteve 60.' Ky projekt konsistonte në ndërtimin e një dige pranë fshatit Skavicë, midis Dibrës dhe Kukësit, me një kapacitet të instaluar prej 350 MW.

Në fillim të viteve 80', kohë kur Shqipëria po përfundonte së ndërtuari hidrocentralin e Komanit, Skavica u mendua se do të shërbente për dy qëllime njëherësh: të prodhonte energji dhe të krijonte një liqen të ri me kapacitet të konsiderueshëm, duke sjellë rritje të prodhimit edhe në tre hidrocentralet më poshtë në kaskadën e Drinit.

Hidrocentrali pritej të shtonte prodhimin e energjisë në vend me mbi 1.8 miliardë kWh në vit, ku përfshihej prodhimi i vetë HEC-it dhe pjesërisht falë rritjes së eficencës hidrike në hidrocentralet e tjerë.

"Skema e shfrytëzimit të Drinit të Zi, për ndërtimin e hidrocetralit të Skavicës me parametra maksimale është miratuar dy herë në qeveri, në vitin 1963 dhe në fillim të vitit 1964 është miratuar në Byronë Politike, ka kaluar në Qendrën Shkencore të Institutit, të ministrive, e me radhë," thotë inxhinier Emin Mysliu, projektues midis të tjerave i HEC-eve të Shkopetit dhe Bistricës dhe zbatues në projekte si HEC Fierza dhe Vau i Dejës.

Megjithë projektet e tanishme të qeverisë, të cilat synojnë të minimizojnë shpërnguljet e mëdha të popullsisë, inxhinier Mysliu vazhdon të mbështesë propozimin për ndërtimin e "Skavicës së madhe" dhe ankohet se qeveria nuk ua ka vënë veshin ekspertëve vendas.

"Nuk është argument shpërnguja e madhe e njerëzve, kur në fakt, vazhdimisht janë shpërngulur mbi një milion njerëz," thotë ai. "Ata e bëjnë këtë zgjedhje për ndërtimin e "Katundit të Ri," sepse nuk duan të marrin vesh të vërtetën, sepse nuk pyesin, nuk duan të informohen," shtoi Mysliu.

Projekti i "Skavicës" hasi në fillim kundërshtim nga fqinjët, pasi po të ndërtohej siç ishte parashikuar, përmbyste sipërfaqe të konsiderueshme toke në Shqipëri dhe Maqedoni –në atë kohë, pjesë e ish-Jugosllavisë. Por me rënien e regjimit komunist dhe tranzicionin e vështirë me të cilin u përball Shqipëria, projekti mbeti në letër.

Në vitin 2005, qeveria socialiste e ish kryeministrit Fatos Nano arriti një marrëveshje me kompaninë Italiane Tassara-Geotecna Progetti-Kinglor Srl, TKG, për rigjallërimin e projektit të Skavicës.

Kompania italiane hoqi dorë nga krijimi i digës dhe hartoi një projekt që do të shfrytëzonte Drinin me rrjedhje të lirë nga kuota 411 metra në kuotën 285 metra, pra në të gjithë lartësinë nga kufiri me Maqedoninë deri pranë Kukësit. Në nëntor 2007, qeveria e qendrës së djathtë e ish kryeministrit Berisha e miratoi projektin e TKG, duke i dhënë një bonus prej 10 pikësh si propozim për koncension të pakërkuar.

Megjithatë, edhe projekti i TKG dështoi. Në vitin 2009, me financimin e Bankës Botërore kompania franceze e konsulencës, Sogreah prodhoi një studim për Koorporatën Elektroenergjetike Shqiptare, KESH, për vlerësimin e potencialit hidrik të lumenjve shqiptarë. Në studimin e Sogreah jepen tre variante për ndërtimin e projektit të Skavicës në rrjedhën e lumit Drini i Zi.

Varianti i parë parashikon ndërtimin e vetëm një hidrocentrali, Skavica 441. Sipas të dhënave teknike të studimit, ky variant do e kishte koston 662.4 milionë euro ndërsa prodhimin vjetor 768 GWh, për një fuqi të instaluar 193MW. Kostoja e investimit për kapacitet të instaluar arrin në 3.43 milionë Euro/MW. Ndërkaq, sipërfaqja e përmbytur nga ky variant arrin në 5,861 hektarë tokë. Numri i personave të zhvendosur shkon sipas këtij varianti në 10 mijë. Për shkak të këtyre efekteve të mëdha me ndikime mjedisore dhe sociale, studio konsulente konstaton se ky variant është i shumë i vështirë për t'u financuar.

Varianti i dytë parashikon ndërtimin e dy hidrocentraleve: Katund i Ri, 445 dhe Skavica 395. Sipas këtij varianti, në total numri i të zhvendosurve shkon në 1,560 persona ndërsa sipërfaqja totale e përmbytur arrin në 2,297 hektarë tokë. Vlera totale e investimit për dy HEC-et shkon në 347.8 milionë euro, ndërsa prodhimi vjetor i përbashkët 694 GWh.

Varianti i tretë parashikon ndërtimin e dy hidrocentraleve: Katund i Ri 445 dhe Skavica 385. Sipas këtij varianti, numri i të zhvendosurve në total shkon në 800 persona ndërsa sipërfaqja totale e përmbytur arrin në 1,788 hektarë tokë. Vlera totale e investimit për dy HEC-et shkon në 313.8 milionë euro, ndërsa prodhimi vjetor i përbashkët 673 GWh.

Tenderi i hapur nga ministria e Energjisë bazohet në variantin e tretë të propozuar në studimin e Sogreah, dhe përfshin dhënien me koncension të vetëm njërit prej hidrocentraleve.

BONUSI I PAKËRKUAR

Në prag të Krishtlindjeve, me datë 23 dhjetor 2015, qeveria miratoi në heshtje një bonus prej 8 pikësh për kompanitë turke "Suzer" dhe "Nurol," për propozimin e tyre të pakërkuar për marrjen me koncension të formës BOT të hidrocentralit "Katund i Ri."

Vendimi i qeverisë nuk u publikua në faqen e saj zyrtare kryeministria.al bashkë me vendimet e tjera të marra në të njëjtën mbledhje, por u zbardh në 7 janar në Fletoren Zyrtare – pasi Partia Demokratike në opozitë e pati cilësuar dhënien e bonusit si një aferë korruptive.

Në Fletoren Zyrtare, vendimi i Këshillit të Ministrave për bonusin nuk u botua me një relacion shoqërues. Në të thuhej vetëm se bonusi për bashkimin e përkohshëm të kompanive turke jepej "për ndërtimin e hidrocentralit "Katundi i Ri", mbi lumin Drini i Zi, në kuotën maksimale të ujit, 445 m.m.n.d, në kufirin shtetëror të Republikës së Shqipërisë me ish-Republikën Jugosllave të Maqedonisë".

Në të njëjtën kohë me vendimin e qeverisë shqiptare, kompania turke "Suzer" publikoi në faqen e saj të internetit lajmin se hidrocentrali i ri do të jetë me kapacitet 70 MW dhe pritet të kushtojë 110 milionë euro.

Dhënia e bonusit nga ana e Këshillit të Ministrave është bazuar në pikën 1 të nenit 7, të ligjit 125 të vitit 2013, "Për Koncesionet dhe Partneritetin Publik Privat," ku thuhet se : "Projektet për dhënien me koncension të prodhimit dhe shpërndarjes së energjisë elektrike mund të realizohen në bazë të një propozimi të pakërkuar, ku propozuesit të propozimit të pakërkuar mund t'i jepet një bonus deri në maksimumin prej 10% të pikëve për pikëzimin e llogaritur në përputhje me kriteret e dhënies se koncesionit/partneritetit publik privat të përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe në njoftimin e kontratës për dhënien e një kontrate të tillë."

Megjithatë, në pikën 2 të të njëjtit nen saktësohet se rregullat për mënyrën e identifikimit, vlerësimit dhe të realizimit të projekteve të përshkruara në pikën 1 të këtij neni miratohen nga Këshilli i Ministrave.

Për këtë arsye, në 10 korrik 2013 është miratuar VKM. Nr 575 "Për Miratimin e Rregullave Për Vlerësimin dhe Dhënien me Koncesion/Partneriteti Publik Privat." Sipas nenit 10, pika 2 të këtij vendimi, një propozim i pakërkuar nuk mund të lidhet "me një projekt, për të cilin tashmë ka filluar ose është shpallur procedura për dhënien e tij."

BIRN iu drejtuar ministrisë së Energjisë me një kërkesë, bazuar në ligjin për të drejtën e informimit për të zbardhur propozimin e pakërkuar të "Suzer" dhe "Nurol" për ndërtimin e



Planimetria e Skavicës së madhe | Foto kortezi nga: Emin Mysliu



Shaban Beça duke treguar shtëpitë e fshatit Podgorcë | Foto nga : Jetona Koçibelli

Kreu i shoqatës për "Mbrojtjen e Pellgut të Drinit të Zi," Nazmi Idrizi është i një mendjeje kur thotë se dibranët do të rezistojnë me çdo formë, në qoftëse shpronësimet do jenë të padrejta.

hidrocentralit, si dhe vendimin e komisionit të posaçëm për miratimin e bonusit. Përgjigja e MEI-t ishte negative.

Ilir Ciko, një ekonomist i edukuar në Harvard dhe ish-zëvendës ministër i ekonomisë argumenton se propozimi i kompanive "Suzer" dhe "Nurol" nuk mund të trajtohet me bonus, sepse rrjedha e sipërme e Drinit është studiuar më parë dhe nuk ka asnjë hapësirë për të cilën mund të bëhet një propozim i pakërkuar.

"Këtu hyn në lojë roli i institucioneve, të cilat në këtë rast duket se jo vetëm bëjnë të paditurin për ekzistencën e studimeve të mëparshme, jo vetëm se 'harrojnë' që çështje të tilla janë diskutuar plot herë në zyrat e shtetit e për të cilat janë marrë vendime, jo vetëm nuk ngrenë zërin për të treguar se në rastin e rrjedhës së sipërme të Drinit nuk ka as edhe një grimë vend për ndonjë propozim të pakërkuar, pasi gjithçka është trajtuar e madje edhe vendosur më parë, por shkojnë shumë më tej, duke e pranuar një ujdi të tillë dhe dhuruar bonusin përkatës," tha Ciko.

Sipas tij, dhënia e bonusit nga qeveria ishte jo vetëm dëshmi i një akti të paligjshëm, por edhe të degradimit të institucioneve publike në Shqipëri.

"Nuk është shqetësues favorizimi i një kompanie, kjo ka ndodhur, ndodh çdo ditë e do të vazhdojë të ndodhë për gjatë. Është nëpërkëmbja e vlerave intelektuale, rrënimi i institucioneve dhe degradimi i administratës që si një rreth vicioz prodhon më pas dështimin e plotë në dy elementët e tjerë të rëndësishëm – transparenca dhe konkurrenca në proces," shtoi ai.

Kreu i Qendrës Shqiptare për Kërkime Ekonomike, Zef Preçi, e cilëson gjithashtu si absurd vendimin e dhënies së bonusit për HEC "Katund i Ri," duke nënvizuar se ky projekt ishte studiuar më parë në themel.

"Koncepti i propozimit të pakërkuar është një mekanizëm i përdorur dy dekada më parë në atë kohë kur vendet e varfra nuk kishin kërkesë për të investuar në to, pra investitorët nuk i njihnin dhe presupozon që qeveria është në nevojë për të vënë në dispozicion asete të caktuara publike me synimin që të tërheqë teknologji bashkëkohore, dhe të fusë në qarkullim ekonomi dhe pasuri të fjetura, siç është në rastin konkret uji," shpjegoi Preçi.

"Në rastin e 'Skavicës' mendoj se është i pakuptimtë zbatimi i çfarëdolloj bonusi, për faktin e thjeshtë që ndërtimi i këtij hidrocentrali është studiuar me imtësi gjysmë shekulli më parë, që në periudhën e regjimit komunist, pra përdorimi i bonusit në këtë rast është i panevojshëm," shtoi ai.

Sipas Preçit, copëzimi i projektit të "Skavicës," duke filluar me ndërtimin e HEC "Katund i Ri," nuk shkon në të mirë të interesit publik.

'Copëtimi i sotshëm krijon terren për të favorizuar investitorin, i ul koston atij," tha ai.

Problemi tjetër, sipas Preçit është mungesa e transparencës në procesin përzgjedhës, ç'ka mund të prodhojë kosto të fshehta për ekonominë.

"Kjo çon në përzgjedhje jokualitative të kompanive, duke bërë që të vijnë investitorë jo seriozë. Duke mos qenë transparentë, procesi nuk ka konkurrencë midis kompanive, për rrjedhojë ka kosto të fshehta në dëm të interesave të ekonomisë publike," shtoi Preçi.

Ekspertët thonë se trajtimi në mënyrë preferenciale i një kompanie mund të shoqërohet edhe me koston e mpirjes së investitorëve të tjerë. Kjo sjell edhe kosto të eficencës në treg, sepse një kompani mund të jetë e aftë për të ofruar një ide të mirë, apo një propozim të pakërkuar interesant, por jo detyrimisht është ajo kompani më e aftë për të marrë përsipër zbatimin e projektit në fjalë.

"Nuk duhet harruar një element i rëndësishëm që është lënë në harresë këto kohë; ndonëse studimi i Sogreah parashikon ndërtimin e HEC "Katundi i Ri," rekomandimet e këtij studimi mbështesin njëkohësisht ndërtimin e HEC Skavicë – i cili sipas këtij studimi duhet ndërtuar përpara atij të "Katundit te Ri," dhe kjo gjë nuk po ndodh," tha Ciko.

"Promovimi i dukshëm dhe problematik i kompanive, për mua të panjohura, siç është rasti në fjalë, pa i paragjykuar aspak ato, me gjasa do të mbajë larg pjesëmarrjen e kompanive të mëdha europiane në këtë projekt," përfundoi ai.

PROPOZIMET KINEZE

Përveç propozimit të dy kompanive turke "Suzer" dhe "Nurol" për ndërtimin e HEC-it "Katund i Ri," dokumentet e siguruara nga BIRN tregojnë që qeveria ka marrë dhe oferta nga kompani kineze për ndërtimin e hidrocentraleve në rrjedhën e sipërme të Drinit të Zi.

Kompania kineze "Power China" ka propozuar në shator të vitit 2014, ndërtimin për llogari të Koorporatës Elektroenergjetike Shqiptare, KESH, të projektit të Skavicës në nivelin 485 metra, ose i ashtuquajturi "Skavica e madhe."

Propozimi i saj vinte pas kontakteve të kryeministrit Rama me kryeministrin Kinez Li Keqiang në Forumin Ekonomik në Davos si dhe pas takimit me 10 shtator 2014, midis dy liderëve në qytetin kinez, Tijanin.

Sipas një draft memorandumi mes "Power China Chengdu Engineering Corporation Limited" dhe "China Hope Energy Investment Limited," KESH dhe ministrisë së Energjisë; Li Keqaing dhe Rama kanë arritur një marrëveshje për financimin dhe ndërtimin e hidrocentralit të Skavicës nga kinezët.

Kapaciteti i instaluar i hidrocentralit do të ishte 350 MW, dhe përveç gjenerimit të energjisë elektrike, parashikonte uljen e rriskut të përmbytjeve nga lumi Drin në Shqipëri dhe Mal të Zi.

Sipas Geri Selenicës, përfaqësues në Shqipëri i "Power China", investimi kapte vlerën e mbi 1 miliardë eurove, nga të cilat 600 milionë për ndërtimin e digës dhe mbi 500 milionë euro për shpronësimet dhe rehabilitimin mjedisor dhe ekonomik të zonës së përmbytur.

Projekti parashikohej të financohej nëpërmjet një kredie të butë për KESH, që do të paguhej në formë "leasing" në një periudhe 15-vjeçare nga Korporata, bazuar në të ardhurat e gjeneruara nga eksporti i energjisë.

Në fillim të tetorit 2014, përfaqësuesit e kompanisë kineze të udhëhequr nga Presidenti i saj, Jianyue Zhang kanë ardhur në Shqipëri dhe kanë mbledhur të dhëna mbi kaskadën e Drinit si dhe projektin e Skavicës.

Sipas Selenicës, qeveria shqiptare ka marrë oferta për ndëtimin e HEC Skavicës edhe nga dy kompani të tjera të mëdha kineze, GeZhouba dhe Norinco Group. Norinco group i ka ofruar Kryeministrit Rama një kredi të butë për ndërtimin e HEC-it me afat kthimi 35 vjet, me 2 % interes dhe 7 vitet e para falas.

Megjithatë, Selenica thotë që qeveria nuk i ktheu kurrë përgjigje kinezëve. Madje, sipas tij kryeministri Edi Rama as nuk doli t'i priste në zyrën e tij presidentin e "Poëer China" dhe drejtuesit e lartë të firmës kineze, të cilët e kishin mikpritur një muaj më parë në Pekin.

"Kompanitë kineze "Power China," "GeZhouBa" dhe "Norinco" që janë interesuar, qeveria i ka gënjyer dhe nuk i ka njoftuar me kohë për këtë tender, madje u ka thënë që të largohen," tha Selenica.

"Ndërsa turqit kanë pasur mbi 1 vit kohë që ta vlerësojnë këtë projekt dhe nga një investim gjigand për Skavicën 485m me rezervuar ujor 7 miliardë m3, me 400MW fuqi [të instaluar], me prodhim 2 milionë GWh në vit dhe 1 miliardë euro investim, e katandisën tek 'Katundi i Ri' me rezervuar ujor 580 herë më të vogël dhe me 10% të prodhimit të 'Skavicës së madhe," shtoi ai.

E pyetur nga BIRN, ministria e Energjisë nuk komentoi nëse ka pasur propozime të tjera për projektin e Skavicës, përveç propozimit të pakërkuar nga "Suzer" dhe "Nurol." Gjithashtu, zyra e kryeministrit Edi Rama nuk iu përgjigj pyetjeve specifike mbi ofertat e kinezëve dhe akuzave të Selenicës.

FRIKË NGA PËRMBYTJET

Më 21 shkurt, ministria e Energjisë dhe Industrisë, në bashkëpunim me bashkinë e Dibrës organizoi takimin e parë konsultativ në formën e dëgjesës publike mbi ndërtimin e "HEC Katund i Ri".

Takimi u zhvillua në një klasë shkolle në fshatin Katund i Ri – aty ku do ndërtohet diga e hidrocentralit, por që nuk përmbytet asnjë pëllëmbë tokë – ku zëvendësministri Ilir Bejtja informoi qytetarët në lidhje me projekt-idenë për ndërtimin e hidrocentralit të Katundit të Ri, çfarë parashikon ky investim prej mbi 100 milionë eurosh dhe impakti ekonomik që do të ketë në zonë.

"Kemi parë të gjitha mundësitë se si mund të zhvillohet nga pikëpamja energjitike pjesa e sipërme e Drinit përmbi Fierzë. Nga të gjitha, i vetmi segment që na ka rezultuar i mundshëm për t'u bërë me shumë pak dëme, por me përfitime për zonën si në punësim, ashtu edhe nga pikëpamja e balancimit të energjisë, furnizimit me cilësinë e duhur të energjisë elektrike është Katundi i Ri," citohet të ketë thënë Bejtja në një deklaratë të shpërndarë nga zyra e shtypit e Ministrisë.

Në fshatin Podgorcë, një nga pesë fshatrat e zonës së Dibrës që ndryshe nga Katundi i Ri pritet të preken nga përmbytjet prej ndërtimit të hidrocentralit, banorët janë të nervozë.

"Në takimin me banorët nuk kanë nxjerrë zërat kundër, por thjesht thanë [se] mendohet të krijohet hidrocentrali për përfitim kombëtar," thotë Shaban Beça.

Nga 50 familje që ka ky fshat, 12 shtëpi dhe tokat e punueshme të shumicës së fshatit pritet të përmbyten nga projekti gjigand energjetik.

"Flitet për 1,500 lekë të vjetra metri katror. Ne nuk jemi dakord. Ku do të shkojmë ne? Ku do të hamë? Ç´vlerë ka kompesimi," pyet Osman Dani, një tjetër banor i këtij fshati.

"Le të marrë tokën me koncension shteti, sikurse jep edhe koncension," shtoi Dani, duke nënvizuar që të vetmin informacion e ka marrë nga televizioni.

Për shkak se Shqipëria nuk ka politika të shpërnguljes së detyruar të qytetarëve që preken nga projekte në interes publik, Zef Preçi propozon që Banka Botërore të bëhet pjesë e financimit të HEC-it "Katund i Ri."

"Nëqoftëse investimi do të kryhej me paratë e Bankës Botërore, procesi i shpronësimit kryhet me principet e Bankës Botërore, ç'ka do të thotë që respektohet kushtetuta për një kompensim të drejtë, të ndershëm dhe bazuar në mekanizmat e tregut," tha Preçi.

"Marrja në këtë rast e një kredie të butë lehtëson shumë pozitën e fshatarëve që afektohen nga procesi i shpronësimit, ndërsa ofrimi tek një firmë private është më keq se sa ta bëjë vetë qeveria, pasi çmimi që ajo ofron është shumë i ulët," shtoi ai.

Gradeci është një tjetër fshat i kësaj zone që pritet të preket nga përmbytjet e hidrocentralit. Banorët janë gjithashtu të shqetësuar aty dhe shprehen se kanë pak informacion për projektin.

"Askush nuk ka ardhur të na informojë. Asnjë lloj informacioni nuk kam se ku do strehohemi. Asnjë takim, asnjë informim, as nga pusheti vendor, as nga ai qendror," thotë kryetari i fshatit, Dilaver Elezi.

"Ne të gjithë jemi të shqetësuar për ndërtimin e HEC-it të Katundit të Ri. Ne duhet të lëvizim prej këtu. Banorët nuk janë të mendimit për të lëvizur. Kanë dhënë edhe firma në peticion, kundër ndërtimit të hidrocentralit," shtoi ai.

Nazmi Idrizi, një burrë tradicional dibran është kreu i shoqatës për "Mbrojtjen e Pellgut të Drinit të Zi."

Përveç protestave që kanë nisur që në muajin shkurt, peticioneve të nënshkruara në kundërshtim me ndërtimin e projekteve energjetike Skavicë dhe Katund i Ri, shoqata e drejtuar nga Idrizi ka më shumë se një dekadë që kundërshton procedurat e ndjekura nga qeveria shqiptare për dhënien me koncension të hidrocentraleve në lumin Drin i Zi

"Zv. ministri erdhi fshehurazi në takim, ka ardhur dhe dy herë të tjera mbrapa dhe është regjistruar me televizione pa dijeninë tonë," ankohet Idrizi. "Gjithkush hesht. A nuk kemi të drejtë ne të gjykojmë si popull, se po merremi nëpër këmbë, pa u pyetur e pa diskutuar për asgjë," shtoi ai.

Përsa i përket konsultimeve me banorët, ministria e Energjisë dhe Industrisë i tha BIRN se bazuar mbi ligjin për "Koncesionet dhe Partneritetin Publik-Privat," në fazën aktuale të identifikimit të ofertës së pakërkuar dhe hapjes së garës, ministria nuk ka një detyrim për kryerjen e konsultave me komunitetin lokal.

"Sipas ligjit, këtë detyrim e ka kompania e cila do të rezultojë fituese e garës. Është kompania ajo e cila përpara se të aplikojë tek institucionet përkatëse për marrjen e lejes mjedisore e më pas lejes së ndërtimit duhet të konsultojë banorët," tha zëdhënësi i MEI-t, Dardan Malaj.

Pavarësisht kësaj, Malaj shtoi se mbështetur në legjislacionin për informimin publik, me nismën e saj ministria e Energjisë dhe Industrisë në bashkëpunim me bashkinë e Dibrës ka ndërmarrë një fushatë informimi për qytetarët e zonës.

"Më datën 20 Shkurt 2016, në njësinë administrative Luzni (fshati që preket më shumë nga projekt propozimi i miratuar me bonus), është mbajtur një takim konsultativ me banorët në të cilën morën pjesë perfaqësues të ministrisë së Energjisë dhe Industrisë si dhe të ministrisë së Mjedisit në bashkëpunim me bashkinë Dibër," tha Malaj.

"Banorët pjesëmarrës në takim vinin jo vetëm nga fshati Luzni, por edhe nga shumë fshatra të tjerë," nënvizoi ai.

Megjithë përpjekjet e qeverisë për t'i bindur për rëndësinë e projektit, dibranët mbeten skeptikë dhe dyshues për ndikimin që hidrocentrali do të ketë mbi zonën.

Një prej anëtarëve të shoqatës për "Mbrojtjen e Pellgut të Drinit të Zi", Murat Kolkreta, shprehet se nga ndërtimi i hidrocentralit nuk do të preken vetëm banorët që do t'u përmbyten tokat dhe pronat, por e gjithë Dibra.

"Në të dy anët e liqenit, në perëndim dhe në lindje, në gjatësinë 2 km majtas edhe djathtas, ndikimet në ndryshimet e faktorëve klimaterikë, që sot janë në unitet me njëri-tjetrin dhe prodhojnë këto që prodhojmë ne në Dibër, prishen," tha ai.

"Detyrimisht dibranët detyrohen të ikin. Pra boshatiset Dibra. Dibrës i mbetet vetëm një varg malor në perëndim, një varg malor në lindje dhe ca kodra joproduktive," shtoi Kolkreta.

Përveç rreziqeve që mund të vijnë nga ndryshimi klimës, Kolkreta është gjithashtu i shqetësuar për ndikimin e HEC-it në vlerat historike, kulturore dhe arkeologjike të zonës.

" Nuk duhet nënverësuar trashëgimia shumë e madhe historike, fatkeqësisht e pastudiuar e kësaj treve," thotë ai, duke nënvizuar se në luginën e Drinit të Zi është dokumentuar jeta që në neolitin e hershëm dhe janë disa qytete që përfaqësojnë qytetërimin Ilir.

Sipas tij, pas ndërtimit të hidrocentralit, qyteti Ilir i Gradecit – i fortifikuar me pesë mure rrethues – do të zhduket përfundimisht nga harta.

"Kjo trashëgimi kaq e pasur nuk duhet të bëhet kurban i një vepre," përfundoi Kolkreta.

Kryetarit i fshatit Gradec, Dilaver Elezi thotë se tradita e zonës shkruan që toka shitet dhe nuk blihet. Elezi shprehet se me atë pak informacion që ka, pret që shpronësimet të "jenë të hidhura."

"Ne do mundohemi të vijojmë me protesta, do ikim në Tiranë, do takojmë drejtues, mund të bëhemi edhe kamikazë për të mbrojtur pronën," tha ai.

Kreu i shoqatës për "Mbrojtjen e Pellgut të Drinit të Zi," Nazmi Idrizi është i një mendjeje kur thotë se dibranët do të rezistojnë me çdo formë, në qoftëse shpronësimet do jenë të padrejta.

"Unë do t'i dal zot truallit të trashëguar nga babai im," paralajmëroi ai.

(www.reporter.al)

Rruga e Arbërit nr. 122

analizë

Si rimëkëmbët parku kombëtar i Lurës?



Nga **Dr. SELMAN MËZIU**

Një punëtor që kishte punuar në sektorin e shfrytëzimit Lurë më tregonte - e fillon bisedën gazetari Shaqir Skara, - se aty nga fillimi i viteve tetëdhjetë të shekullit të kaluar, na erdhi rasti të prisnim një arnen me diametër dy metër e gjysmë. Kur e rrëzuam me motosharrë u dridh toka si tërmet. Me një trup e ngarkuam skodën me traktor, jo me vinç, duke e afruar atë në skrapatën e rrugës automobilistike. Ajo udhëtoi drejt kombinatit të drurit në Laç. Kjo ishte një pasuri qindravjeçare. E mbylli bisedën ai.

Ndërsa pas viteve '90 të shekullit që perëndoi, mafia e gjelbër e organizuar me armë zjarri, thika dhe motosharra, filloi shkatërrimin barbar të pyjeve madhështor të Lurës duke përfshirë edhe Parkun Kombëtar. Më pas për të zhdukur gjurmët e krimit iu vihesh zjarri. Kjo ishte dinamika e një masakre e pa regjistruar në historinë e natyrës shqiptare e botërore.

STUDIME UDHERRËFYESE

Po e kaluara e këtyre pyjeve si paraqitet? Shkruajmë: "Shumica e pyjeve me arnen nuk kanë më tepër se 250-300 m³ lëndë për ha me një moshë prej 150- 200 vjet. Rrallë gjenden pyje që kanë një volum më të madh siç është rasti i arnishteve të Lurës që kanë një fuqi lëndore 400-450 m³/ha.

Mbi ndërtimin e arnishteve për shfrytëzim le të krahasohen shifrat e poshtëshënuara sipas një prove (50 x 50 m) të bërë në Neshtën e Lurës.... Diametri në 1.30 m i drurit mesatar 48cm, lartësi ae drurit mesatar 23 m. Numri i drurëve për ha. 268, volumi për ha (me gjithë lëvore) 436 m³. Mosha 180 vjet... (Ilia Mitrushi,"Arneni (Pinus peuce Gris) në Shqipëri.,, Bul. Për shk. natyrore, 1952, n.3 f. 49-58)

Kjo ishte gjendja silvobiologjike, këto ishin parametrat dentrometrik, të arneshteve të Lurës në vitin 1952, kur studiuesi Mitrushi kryente ekskursionet dentrologjike në çdo pëllëmbë të pyjeve shqiptare. Një pasuri madhështore e natyrës, dhuratë për popullin e Lurës

Për t'iu përgjigjur sa më saktë pyetjes së gazetarit Kamber Farruku, po citojmë një tjetër studiues dhe ja: "Kurora e Lurës dhe shpati lindor i saj, deri poshtë në gropën e Setës, dallohet për vegjetacion interesant për të cilin luajnë rol një sërë faktorësh, si veprim akullnajor, përbërja litologjike, klima, kundrejtimi etj. Llojet kryesore që krijojnë fizionominë e pyjeve të këtij Parku janë ahu, pisha e zeze, arneni e rrobulli. Takohet gjithashtu i përzier me ahun edhe bredhi i bardhe në grupe të vegjël ose në individ të vetmuar. Në kullota përveç bimëve barishtore takohen edhe shkurre të rralla, si Juniperus nana, Rosa sp. etj.,, (Prof. Vasil Marku dhe Mersin Mersimllari "Vegjet. pyjor i Park. Komb. "Lure" f.137-142; në Bulet. i shk. Bujq. N. 4. 1997)

Të paraqesim një mendim të një studiesi tjetër e pikerisht të Dr. Injac Gj. Ndoja mbi formacionin shkëmbor dhe tokën: "Petrografilisht europtivët përbahen prej diferencime të magmit bazik, prej të cilave janë veçuar gabro, pireksenité e peridotite. Dy të parat përbëjnë masive të vegjël të veçuem e dalin në shesh kryesisht në pjesët më të thella të thundrave periodike (p.sh. në luginën e Mollës).,, (Dr. Injac Gj. Ndoja, Vrejtje petrografike mbi disa shkëmbinj eruptive të shqipnisë. f. 60. Në Bulet. për shk. Natyrore. N. 1. 1952)

Dhe tani një studim tjetër më i hollësishëm, më konkret për të njohur kushtet klimatike e tokësore: "Faktori edafik është nga përbërësit më të rëndësishëm dhe konstant të biogjeocenozës pyjore, konsideruar si produkt i jetës së bimëve me shkëmbin tokëformues. Ajo është shtresa që mbulon shkëmbin amnor dhe është rezultat i alterimit të tij, nën veprimin e kombinuar të faktorëve atmosferikë e biologjikë. Toka zhvillohet sipas natyrës së shkëmbit amnor, topografisë së vendit dhe tiparëve të klimës. Toka është përbërësi më i qëndrueshëm i bioqenozës pyjore, jo vetëm sepse ruan ndryshimet e regjistruara nën ndikimin e bimësisë edhe pas zhdukjes së saj, por edhe sepse është pjesë, mbi të cilën mund të veprohet nga njeriu për rritjen e prodhimtarisë së bimësisë.,, (Prof. V.Marku, M. Mersimllari, po aty f.138)

Politikanët shqiptar të një çerek shekulli, popullsia e mbetur e fshatrave të Lurës, inxhinierët e teknikët e pyjeve që ishin nga ai vend dhe të tjerë që kanë shërbyer pyjeve masiv gjelbërta të krahinës së Lurës dhe të Parkut Kombëtar (1100 ha pyje) në veçanti, kanë përpara syve, një peisazh të shëmtuar, mjeran, mijëra hektar tokë të zhveshur plotësisht, që rënkon, një "gjah" i lodhur edhe nga gërryerjet, rezultati veprimit të faktorëve atmosferik. Pra kanë një natyrë të sëmur që duhet shëruar medoemos dhe urgjentisht.

Kemi një suksesion regresiv bioekologjik i cili vazhdon të keqësoi kushtet pedologjike e morfologjike të tokës duke provokuar një pozicion shkretimi dhe të pashprese rikthimi bimësie barishtore, shkurrore e drunore. Pra natyra është në pikën e vdekur.

Valle si do të arrihet vendosja e ekuilibreve bioekologjike të humbura plotësisht? Cilët janë faktorët politikë, shoqërorë që duhet të ndihmojnë? A mund të arrihet që pamjen rrënqethese, tabllot me ngjyrën gri e drurët e shtrirë e cungjet e mbetura, t'iu rikthejme të gjelbertën?

FORMAT E ORGANIZIMIT

Tanima lurjanët banorët e sotëm të Bories, Fushë Lurës, Krej Lurës, Gjur Lurës, Pregjës, pas një çerek shekulli demobarbarizem, demovjedhje investimesh, demo gënjeshtrash, duhet ta kenë kuptuar se nga qeveritë nuk po ndryshon natyra. Edhe nga kjo e fundit që vuri disa tabela shëmtirë, që hapi disa qindra gropa (premimi për të mbjellë 2 milionë fidanë) e mbolli në ngastrën N. 7, 45 820 fidana Pishë e Zezë, Hartinë e Hormoq ku ka një zënie 90 përqind, dhe me kaq e ndalën vrapin.

Prandaj duhen gjetur, kërkuar, menduar e shfrytëzuar mundësitë e brendshme, duhet të rizgjohen e vihen në veprim energjitë e fshehura tek banorët e këtushëm, lurjanët emigrant në Shqipëri dhe në botë. Kërkohet një bashkëpunimi të gjithëve, për të rimëkëmbur natyrën e tyre, duke bashkëvepruar ngushtë me njëri-tjetrin në lëmin organizativ, teknik e financiar.

Këto realizohen kur të vihen në ballë mësuesit e shkollave, nxënësit dorë-përdore me prindërit, nëpërmjet edukimit të dashurisë mbi natyrën dhe reagimit konkret në ripërtëritjen e pyjeve sipas biocenozave të para katastrofës.

Prandaj kërkohet:

1- Krijimi i shoqatave të ndryshme, me statuse të rregullta dhe të ligjëruara dhe vendosja e bashkëpunimit për ripërtëritjen e pyjeve, e zbukurimin e peisazheve në mes tyre dhe me organizma ndërkombëtare.

2- T'iu bëhet thirrje inxhiniereve e teknikëve të pyjeve lurjanë për bashkëpunim me shoqatat dhe me popullin e Lurës duke hartuar projekte te vogla ripërtëritëse artificiale e natyrale për çdo pellg ujëmbledhës të liqeneve.

3- Kërkimi i fondeve në rrugë e mënyra të ndryshme, që vetë lurjanet në bazë fisi apo vëllezërish të marrin përsipër një sipërfaqe pellgu liqeni për ta mbjellë e ruajtur.

4- Kryetari i njësisë administrative, anëtarët e këshillit të aktivizohen në kërkimin e fondeve për rregullim rrugësh, e ripërtëritje artificiale të parcelave të ndryshme të parkut apo të pyjeve të tjera përreth krahinës.

5- Në bazë të ligjeve të fundit mbi pyjet e kufijve të vjetër të kryhet ndarja e pyjeve sipas pronarëve privat që i kanë pasur, të cilën duhet ta programoi e kryej bashkia.

6- Për të gjithë këtë veprimtari, bashkia me shoqatat të hartojnë një program të qartë, afatshkurtër dhe afat gjatë mbi rikrijimin e peisazheve pyjore të Parkut Kombëtar dhe të gjithë pyjeve të krahinës

TEKNIKAT E THJESHTA

Vetëm me zhdërvjelltësi, me teknika të thjeshta, bazuar në shkencën e silvikulturës duhet dhe mundet qe natyrës lurjane ti shërohen plagët e dhimbshme ekologjike. Dhe ja:

"Por ajo që do të kështilloj për të tilla raste është: merr me vete një qese të vogël me një përzierje të arnenit, pishës së zezë, rrobullit, hartinës, bredhit pse jo dhe pak hormoq. Do të kuptoni se për një kohë të shkurtër ..... mund të arrish të mbjellësh shumë jetë (10-100 apo 1000).

E mira e farave është që nëse gjejnë kushte stacionale të favorshme, mbijnë dhe e kanë të sigurtë se bimëza do të rritet më e sigurt, pasi lind e hedh rrënjët e veta aty ku ka vegjetuar dikur." (Inxh. Haki Kola 02.04.2016 FC)

Sipas këshillave të silvikultorit Kola mund të ndërtojmë skeletin e një projekti:

1- Studimi i bimësisë pyjore të sipërfaqes ujëmbledhëse të liqenit. Rilevime dentrologjike në terren. Plani i mbarështrimit i inxh.Ismail Latifit

2- Në bazë të kartelave të mësipërme caktohet formula e ripërtëritjes me farë, ar + rro + ha oe ah + br. etj

3- Njohja e periodicitetit të frutifikimit të llojit të drurëve që i kanë shpëtuar shtrëngatës shkatërrimtare.

4- Mbledhja e farave sipas llojeve, tharja e ruajtja në vende pa lagështi. Caktimi i fshatarëve që të mbledhin farat si njohës të llojeve dhe të terrenit. Norma p.sh. për pishën e zezë është, 2.5 - 3 kg për një hektar.

5- Mbjellja në vjeshtë, me gropëza ku hidhen dy deri tre fara për gropëz. Mbulohen vetëm 2 cm dhe. Atje ku ka dru që farëzojnë në vitin e frutifikimit të gërvishte toka nën kurorat e tyre me njollëza, breza ose gropëza ku gjendet fara të mbulohet me dhe.

6- Gropëzat hapen pranë cungjeve të paprerë, në drejtimin jugor, në mes shkëmbinjve, përgjatë trungjeve të prera. Shkulen barërat përreth. Skema e çrregullt, të cilën ta dikton terreni.

7- Ujitja ne dy apo tre vitet e para e fidanëve të mbirë, mbrojtja nga barërat invadues apo qe e mbysim me masën vegjetative, duhet të shkulen me rrënjë.

8- Llogaritja e kostos së punimeve, për çdo mikroprojekt

Të kryhen shërbime kulturale, ujitje, si dhe të mbrohen jo vetëm nga shkurret e barërat por edhe nga zjarret e kullotja me bagëti.

Sa për heqjen e drurëve të shtrirë, ndoshta me makine grirëse siç propozon silvikultor Hakiu (e cila është e pamundur për kushtet ekonomike të vendit tonë) kërkohen fonde të mëdha ose te lihen aty, duke u kalbur gradualisht e transformuar në humues pasi të grumbullohen në vende të caktura të prera me motosharra.

CILËT E KANË HARRUAR LURËN?

Ashtu siç harron fëmija i rritur prindin e vetë e cila ndodhte rrallë, edhe masivet bukurishumta së bashku me Parkun Kombëtar me shtatë liqene e kanë harruar e braktisur:

Politikanët dhe ithtarët e tyre që jetojnë edhe sot në krahinën e Lurës. Inxhinierët, e teknikët e pyjeve që punuan, e u shkolluan me pëlqimin e firmat e lurjanëve. Ato u harruan nga fshatarët lurjane qe u shpërngulën në Shqipërinë bregdetare e qëndrore, si dhe nga vetë emigrantët që jetojnë e punojnë në vende të ndryshme të botës. Ajo u braktisë nga profesorët e Fakultetit të Shkencave të Natyrës dhe të Fakultetit të Shkencave Pyjore, që duhesh ta kishin kthyer në laborator kërkimesh në shkencën e tipologjisë, të ekologjisë, të suksesionit bimor, të silvoteknikës.

Atë e kanë harruar artistët, biznesmenët lurjanë, inteligjenca e saj brenda dhe jashtë vendit, të cilët dëshirojnë zhvillimin e turizmit e ringjalljen e peizazheve të mrekullueshme, por nuk veprojnë konkretisht, nuk organizohen, nuk preokupohen, nuk i përkushtohen natyrës lurjane të shkretueme.

MBYLLJA

Arneni që u pre me motosharrë në vitet '80, sigurisht ka lënë pasardhësit e tij, prandaj duhet t'i ruajmë nga zjarret, blektoria, sopata e vete lurjanëve dhe të ardhurëve, që të rriten shtatëlart se kështu iu shërbejnë atyre vetë. Ndërsa aty ku mungojnë si bujku i mirë lurjanë, si pylltari i apasionuar të fillojmë të riveshim shpatet e zhveshura me teknikat e thjeshta, pa pritur që nga lart të na ndihmojnë.

Të gjithë ne që braktisëm natyrën lurjane t'i afrohemi e ta ringjallim, ta ripërtërijmë, t'i veshim rrobën e blertë: "Lura nuk mund të krijohet duke mbjellë fidana pyjorë, këto janë ëndrra që shikon Ministria e Mjedisit që harron se mjedisi është KLOROFIL dhe ku klorofila është vetë pylli, i cili krijohet në kushte natyrale ndërsa njeriu duhet ta drejtoi atë në shërbim të tij." (Dr. F.Llubani, 25.06.2016 FC).

Lurjanët duhet të aktivizojnë burimet e brendshme materiale e njerëzore e të tiganisen me dhjamin e vetë.

Përndryshe...



Reporter.al — Mediat e tjera për Dibrën

FAQJA E PARE | INVESTIGIME | ANALIZA | LAJME | REPORTAZHE | OPINION | INTERVISTA | RA...

Faqja e pare » Postime » Investigime » **Fidanët e brishtë të projektit për rehabilitimin e Lurës përndi**

INVESTIGIM 23 Jun 2016

Fidanët e brishtë të projektit për rehabilitimin e Lurës përndiqen nga akuza

Një projekt i ministrisë së Mjedisit për rehabilitimin e Lurës, i shoqëruar nga akuza për nepotizëm dhe abuzime me fondet, ka dështuar t'i ndryshojë pamjen parkut kombëtar – skenë e një masakre mjedisore të konsumuar gjatë dy dekadave të fundit.

Autor: Lindita Çela | Tiranë

Invstigimin e plotë mund ta lexoni në linkun: **http://www.reporter.al/fidanet-e-brishte-te-projektit-per-rehabilitimin-e-lures-perndiqen-nga-akuza/**

Populli shqiptar, nuk e njeh si risi elementin juridik të genocidit, ai ka qenë mëse i dukshëm, e i përdorur qartë përgjatë 100 vjetësh në trojet shqiptare, por sidomos edhe në zonën e Pollogut, në Kosovë, në Dibër të Madhe etj.

Genocidi në Dibër të Madhe sipas së drejtës ndërkombëtare publike

Nga **SAIMIR SHATKU***

Kur flasim për kryengritjet Shqiptare në përgjithësi, e ato të shtatorit të 1913, kemi parasysh jo vetëm faktin se ato kishin si pretekst shkëputjen nga ish-Perandoria Osmane, por dhe përshpejtimin e mëtejshëm të veprimtarive me karakter politiko-ushtarak në zgjidhen e çështjes kombëtare. Pa dyshim, genocidi nga pikëpamja juridiko-ndërkombëtare paraqet një veprimtari kriminale, me një shkallë rrezikshmërie të lartë shoqërore, sepse ai nuk drejtohet vetëm ndaj një individi apo një grup individësh, por ndaj një komuniteti të gjerë njerëzish, që për nga pikëpamja e organizimit të tyre territorial, etnik, fetar, ideologjik, paraqesin ndryshime të dukshme ndaj një grupi tjetër social. Populli shqiptar, nuk e njeh si risi elementin juridik të genocidit, ai ka qenë mëse i dukshëm, e i përdorur qartë përgjatë 100 vjetësh në trojet shqiptare, por sidomos edhe në zonën e Pollogut, në Kosovë, në Dibër të Madhe etj.

Në Arkivin e Shtetit Shqiptar, gjenden të pluhurosura dhe të anatemuara nga rrethanat e kohës, mijëra faqe historike, që argumentojnë me fakte dhe prova se ndaj popullsisë civile shqiptarëve historikisht është kryer genocide dhe krime antinjerëzore, të cilat kanë qenë sistematike, me forma të ndryshme, e më të lakmueshme nga militarë dhe paramilitarë bullgar e serb.

Po të lexojmë me kujdes, doreshkrimin Arkivor të Haki Stërmillit "Dibra në prag të historisë" 1940 (A-VIII-63, Nr: Inventari: 1323), në faqen 151 thuhet shprehimisht se: Këtu po mundohemi të përshkruajmë ato pjesë që kalendari kombiar i motit 1912, botoi mbi masakrat sërbe të bamë në qarkun e Dibrës mbas kryngritjes së Malësisë dhe kryengritjes së përgjithshme të Dibrës. Nga këto që u thane e u shënuan, mëndja e njeriut mund të kuptoj mërinat dhe tmerinat që as u pane e as u dëgjuan, se smbeti gojë për me i tregu.-Nga këtu kuptohet qartë se gjaku i derdhur dhe jetët e marura kanë qënë një xhest mëse i pranueshëm për shpirtrat military serb. Në pjesën e Dibrës së Poshtme përshkruhen masakra në familjet e Ahmet Alisë dhe të vëllanë; Nazir Sulejmani dhe Mehmet Salisë etj. Në Valikardhë ditën dhe në darkë herët dhe përpara të gjithëve u vranë e u shpuan me bajonet me qindra familjar, kryefamiljar e anëtar të tjerë të familjes.

> Është detyrë e shtetit vuajtës, e në këtë rast e Shqipërisë, që të mund të kërkojë në çdo kohë, që personat, familjet, qytetet e dënuara dhe të shkrumosura nga krimet e genocidit serb, e sidomos Dibra, të përfitojnë nga dëmshpërblimi, qoftë ai monetary, por që ka gjasa të mos ndodh, se vendet e ballkanit janë në krizë moralo-financiare, por dhe nga një deklaratë juridiko-kushtetuese ku shtetet si: Serbia, Bullgari, Mali i Zi, i kanë një borxh të madh Shqipërisë natyrale.

RËNDËSIA E DËNIMIT TË GENOCIDIT NGA PIKËPAMJA JURIDIKO NË ÇDO KOHË.

Në Dibër në qytet, pa asnjë komunikim e as një forme gjykimi, u ekzekutuan me urdhër të Prefektit serb, kurse komandatit të ushtrisë zuri rob 18 persona nga paria, të cilët edhe këto pa-asnjë forme gjykimi u vendosën përball tytës së pushkës e bajonetës. Referuar kuadrit juridik kombëtar, Legjislacionit penal, kuadrit juridik ndërkombëtar, të drejtës humanitare të luftës dhe të drejtë penale ndërkombëtare, krimet e luftës, ato kundër njerëzimi, shfarosjet etnike, racial, me karakter fetar, politik e ideologjik, janë dhe do të jenë kurdoherë të dënueshme si në sensin material, ashtu dhe në atë shpirtëror dhe moral. Po me krimet e genocidit a janë të padënueshme edhe pse kanë kaluar kaq shumë vite nga realizimi i tyre? Absolutisht që po. Krimet e genocidit, janë sipas së drejtës ndërkombëtare publike e ajo penale, kurdoherë, të dënueshme, të paparashkrueshme, e që kjo kërkese nuk mund të shmanget në kohë dhe hapësire. Po si vallë me masakrat shekullore ndaj shqiptarëve, është shkruar shumë pak apo aspak? E sidomos ka munguar një bashkëpunim, midis evidentuesve të këtyre masakrave, që janë historianët dhe atyre që studiojnë shkallën e përfshirjes apo të implikimit të faktorëve të jashtëm në të tilla vrasjesh masive.

Po sipas të drejtës ndërkombëtare, indiviđët apo grupet e personave që kanë ideuar masakrat, nuk jetojnë më por "veprat e tyre shtypëse dhe dhunuese" vazhdojnë të botohen dhe ribotohen në serbi, greqi etj. A mos është vallë ky një genocit intelektual me paramendim, apo një genocid i dënueshëm me mosveprim, por që pasojet e rrezikshme i ka dhënë përgjatë 2 shekujve të kaluar.

Është detyrë e shtetit vuajtës, e në këtë rast e Shqipërisë, që të mund të kërkojë në çdo kohë, që personat, familjet, qytetet e dënuara dhe të shkrumosura nga krimet e genocidit serb, e sidomos Dibra, të përfitojnë nga dëmshpërblimi, qoftë ai monetary, por që ka gjasa të mos ndodh, se vendet e ballkanit janë në krizë moralo-financiare, por dhe nga një deklaratë juridiko-kushtetuese ku shtetet si: Serbia, Bullgari, Mali i Zi, i kanë një borxh të madh Shqipërisë natyrale.

E që ka gjasa se dhe një deklaratë e tillë të mos ndodh, edhe për hir të një fare supermacie të disa shteteve, është detyrë e enteve publike, e atyre akademike shqiptare, e instituteve e qendrave kërkimore-shkencore, që genocidin ndaj shqiptarëve ta dënojnë dhe ridënojnë, sepse kjo është një e drejtë themelore, që buron nga çdo Kushtetutë që njeh e afirmon të drejtat e njeriut, por dhe nga Karta e Lidhjes së Kombeve, e vitit 1933, nga D.D.Nj. e OKB, e vitit 1948, Këshilli i Europës, e nga një seri konventash kundër genocidit, etj. Përmes këtij materiali, synova të evidentoj domosdoshmërinë e ristudimit të genocidit, e domosdoshmërinë e publikimit të këtyre të dhënave në një manual kombëtar;

** Lektor, Universiteti i Tiranës*

Diaspora dibrane koprace për qytetin e vet

Nga **PETRIT FETAHU**

Dibra e Madhe ka komunitetin më të shumtë të shpërndarë nëpër Evropë, por numri më i madh i tyre është vendosur në SHBA, saqë me të drejtë thuhet se aty matanë oqeanit ka edhe një Dibër tjetër. Dyndja u iniciua nga pushteti shovenist ish Jugosllavisë, por që vazhdoi edhe më tej diskriminimi i shqiptarëve në periudhën e demokratizimit nga pushteti maqedonas dhe nga politika e papërgjegjshme e partive shqiptare në Maqedoni, që krejtësisht janë anashkaluar për të investuar në këtë qytetet të lënë krejtësisht pas dore. Mendohet se në SHBA aty janë mbi pesëmbëdhjetë mijë, që po të kontribuonin, qoftë shuma të vogla edhe nga një dollar për frymë në muaj do të ishin mbledhur shuma të mëdha dhe do të kishin mbushur nevoja urgjente sociale, ekonomike të popullatës dhe do të kishin kontribuar në zhvillimin e perspektivës të qytetit. Edhe pse kanë kaluar një kohë e gjatë ndihma e tyre për këtë popullatë të varfër dhe të harruar nga qeveritë e kohëve për të financuar në ngritjen e ndonjë reparti apo fabrike s'kanë derdhur asgjë për të kompensuar këtë inferiotet dhe indeferentizëm politik për të zbutur sado pak nevojat, papunësinë dhe të ndalin eksodin, ikjen e vrullshme të të rinjve që po zbrazin qytetin që nesër s'do të mbetët asnjë.

Në vend që mjetet financiare të orientohen në këtë drejtim, shuma marramendëse janë derdhur në ndërtimin e objekteve të kultit,saqë në këtë qytet të zvogëluar janë ngritur shtatë, në çdo lagje. Kjo s'them se është e dëmshme, por janë të tepërta, ngase frekuentimi i tyre nga besimtarët mysliman shqiptarë është i vogël, saqë mund të përfshiheshin në dy-tri të tilla, ndërsa ato shuma mund destinoheshin për nevoja urgjente jetësore, si në strehimin të familjeve pa çati mbi kokë, stimulimit të talentëve apo për qëllime të tjera zhvillimore të qytetit.

Dibranët dallohen për prirjet e tyre në lëmitë e ndryshme të artit, si shkrimtarë, piktorë, muzicientë, këngëtarë etj., por për shkak të mosinteresimit tendencioz të pushtetit, të rinjtë të talentuar me aftësi të tilla s'gjejnë përkrahje financiare nga organet kompetente të shkollohen në institucione të larta të vendit apo jashtë dhe nga pamundësia ekonomike e tyre ata shuhen, që në vend që qytetit dhe kombit do t'i jepnin vepra me famë ndërkombëtare, ngase çdo hap drejt kulturës, është hap drejt lirisë.

NJË SHEMBULL I MIRË



Kur vjen fjala për të kontribuar FISNIK DACI është i pari. Që nga vitet e '90 Fisniku nuk ka munguar në protestat për pavarësinë e Kosovës që bënim në Washington DC e deri te protestat të sotme për ndaljen e devijimit te Radikës në New York. Ka kontribuar në art, kulturë, sport dhe janë të pafund kontributet personale financiare nëpër vite. Mjafton të përmend punën vullnetare që ka bërë në Shoqatë këto 20 vjet. Me një rrogë modeste ka kontribuar më shumë sesa 10 biznesmenë bashkë! Vetëm disa muaj më parë u angazhua që ta dërgojmë në Dibër një kuti me pajisje sportive.

Birazer, bashkimi bën fuqinë, NUK JEMI VETËM! Burim Fida, - dua që ta dish, - nuk më mori para për transportin! Alit Paumi dhe Rimi Papraniku na dha një top. Korabi Indoor Soccer, 2 topa tjerë. Ndërsa Habib Klloboçishta nga Dibra shkoi në Durrës me shpenzimet e veta dhe shpërndau këto pajisje atje ku ka pasur më shumë nevojë.

Faleminderit për kontributin dhe në emër të të gjithëve... Zoti ua shpërbleftë!

Në foto: Unforma dhe topa për fëmijët në Dibër të Madhe. / ***Gazmend Kërkuti***

Gjithashtu, qyteti ka mjaft nxënës, studentë me suksese në shkollim të shtresave të varfëra që nga pamundësia të vazhdojnë janë të detyruar t'i ndërpresin studimet e mëtutjeshme. Ka mjaft krijues, që kanë vepra në sfera të shumta të interesit kombëtar letrar, historik, muzikor etj., për të vu një gur në themelet e identitetit artistik të kësaj popullate në lëmitë e shkencës, historisë, folklorit, muzikës etj., që kërkojnë përkrahje minimale, që kanë munguar. Edhe pse u janë drejtuar shoqatës dibrane për të financuar, por janë injoruar me papërgjegjësi, kur dihet se institutet maqedonase s'janë të interesuara për botimin e veprave me karakter kombëtar. Sidomos, kur dihet se atje ka mjaft dibranë biznesmenë që disponojnë ndërmarrje të fuqishme me fitime marramendëse, që janë të shumtë, disa dhjetëra, por këto milionerë s'kanë hedhur asnjë metelik për vendlindjen e tyre, që i ka rritur ata dhe prindërit e tyre. Ka prej tyre që derdhin me thasë për këngëtaret shalëzhveshur nëpë lokale, apo me vete kur vijnë në vendlindje derdhin shuma të mëdha duke sjellë vetura të shtrenjta, për të kënaqë megallomaninë e vet, në vend që një pjesë të tyre t'i derdhin tek bashkëvendasit do të ishin ndihmë e konsiderueshme. Ndërsa nëpër rrjetat sociale

> Ka prej tyre që derdhin me thasë për këngëtaret shalëzhveshur nëpë lokale, apo me vete kur vijnë në vendlindje derdhin shuma të mëdha duke sjellë vetura të shtrenjta, për të kënaqë megallomaninë e vet, në vend që një pjesë të tyre t'i derdhin tek bashkëvendasit do të ishin ndihmë e konsiderueshme. Ndërsa nëpër rrjetat sociale thërrasin: "Nëno mos kij frikë se ke djemtë dhe vajzat në Amerikë!", që duket hipokrite se realiteti është krejt ndryshe.

Diasporë është e përfaqësuar nga Shoqata Atdhetare "Dibra" që duhej të ishte organizatë mbartëse e aktivitetit human dhe ideor për financim për të dëshmuar misionin patriotik që përmban edhe vetë emërimi, por kurrë nuk e ka dëshmuar në vepër këtë epitet, ngase s'ka as strategji, as vizion, as program e veprimtarisë patriotike dhe të mbështetjes saqë edhe ia turpëron këtë epitet.

Por, nuk kanë munguar iniciativa individuale, që sado pak kanë dhënë një shtytje ekonomike dhe në zbutjen e papunësisë, siç është rasti i Ibrahim Kolarit me hapjen e punishtes të llaçit, i cili gjithashtu ka qenë donator të aktiviteteve letrare, artistike, përvjetorëve të Pavarësisë të Shqipërisë, botimin e librare, përurimeve etj., që është i pa kursyer. Apo familja Dobrova me hapjen e fabrikës së koftorëve, e të disa punësimeve në shërbimet të internetit të porosive të picave edhe pse mundësive të të tjerëve janë më të mëdha.

Diaspora dibrane përbën shumicën e emigrantëve ne SHBA, ndaj duhet te jetë mbartëse e angazhimit dhe inkuadrimit në problemet e atdheut e të qytetit të tyre në zgjidhjen e shumë çështjeve politike, ekonomike, kulturore, sociale dhe duhet të dalë nga inferioriteti dhe pasiviteti i gjertanishëm, sidomos kur gjendje e shqiptarëve është e rëndë në çdo aspekt të jetës, pasi reagimet e tyre ndaj shumë padrejtësive luajnë rol të rëndësishëm në sensibilizimin ndërkombëtar.

Më datë 5 qershor, në mjediset e Pallatit të Kulturës në Peshkopi, u prezantua libri "Margaritari i Kurorës", shkruar nga Osman Xhili dhe kushtuar Myftiut të Dibrës, Ahmet Çaushi.

Libri është një rrëfim i Çaushit në disa kohë, që nga shpërngulja me dhunë e familjes së tij nga Dibra e Madhe në fillim të shekullit të kaluar, deri në ditët e sotme. Ky rrëfim është njerëzor, pa tepri e vetëmburrje, duke treguar një plagë të shoqërisë dibrane gjatë gjithë këtij shekulli.

Të pranishmit që morën fjalën vunë në dukje kontributin e Myftiut në ruajtjen e vlerave më të mira të besimit Islam, si dhe në ndihmën e tij në demokraizimin shoqërisë. Myftiu ka qenë një aktivist për Ndërtimin e Rrugës së Arbrit si dhe kundërshtar i ndërtimit të HEC-eve mbi Drin.

Libri është botuar nga Botimet M&B dhe botimi i tij është sponsorizuar nga z. Musa Riçku.

Për lexuesit po përcjellim një fragment nga libri.



Gruaja gjermane

Nga **OSMAN XHILI**



Një ditë, vazhdon tregimin myftiu, isha duke punuar tek zyra e myftinisë, kur dëgjoj trokitje në derë. Kur ato u përsëritën, thashë një "Hyr", instiktive dhe u ngrita të hap derën. Dy gra përpara meje. Njëra prej tyre, shqiptare, trupshkurtër, prezantoi veten, shoqen e saj gjermane dhe qëllimin e vizitës. Gjermania, që ishte misionare në Këshillin e Europës, donte të pyesë myftiun për disa çështje në lidhje me fenë dhe islamin.

- Kam dëgjuar disa herë një thirrje që bëhet nga minaret e xhamive, do të desha të di cili është kuptimi i saj.

I shpjegova se ajo thirrje bëhej në orë të caktuara, pesë herë në ditë dhe quhej ezan.

-Më thuaj të lutem, cili është kuptimi i atyre fjalëve?

Unë i mora vargjet një nga një, duke i shpjeguar pa u nxituar.

Allahu është më i madhi.
Allahu është më i madhi.
Nuk ka Zot tjetër veç Allahut.
Muhamedi është i dërguari i tij.
Ejani në paqe, ejani në shpëtim.
Allahu është më i madhi dhe nuk ka Zot tjetër veç Allahut.

Gjermania u impresionua kur mësoi kuptimin e ezanit dhe tha: - Qenka thirrje e bukur!

- Për të ardhur në xhami, - vazhdova unë dhe pak shpjegimin, - çdo njeri duhet të pastrojë rrobat, trupin dhe shpirtin.

Këtu gjermania kërkoi ndjesë për ndërprerjen dhe u konsultua dhe njëherë me përkthyesen shqiptare. Kishte ndonjë lapsus të vogël të myftiut, kishte përkthyer gabim shqiptarja apo ajo vetë nuk e kishte dëgjuar saktë. Mirë rrobat dhe trupi, po shpirti si mund të pastrohej?

- Po zonjë e nderuar dhe shpirti pastrohet. Sa herë që besimtari dëgjon thirrjen, falenderon Zotin. Sa herë që i afrohet ujit për të marrë abdes lutet, që nëse ka mëkatuar me gjymtyrët e tij, t'i lajë e t'i pastrojë ato nga papastërtitë dhe mëkatet. I kërkon falje Allahut për gabimet e bëra me shpresën për të mos i përsëritur ato.

- E mrekullueshme! – shpërtheu gjermania. - Vërtet e mrekullueshme. Po ezanin kush e thërret?

- E thërret një i verbër, që është hafiz kurani, Pajazit Tafa. E merrja me mend që ajo nuk e dinte çdo të thoshte termi hafiz Kurani, ndaj i tregova se ky është një titull, për ata që e kanë memorizuar Kuranin në mendje.

Ajo ishte mjeke okuliste dhe donte ta vizitojë hafizin e verbër, që atë ditë nuk ishte i pranishëm. Të nesërmen në atë orë, ajo erdhi sërish dhe e vizitoi hafiz Pajazitin. Bëmë dhe një fotografi së bashku. Biseduam dhe për probleme të tjera e më tha se islami ka vlera të plota njerëzore për çdo vend e për çdo kohë. Ajo vetë kishte dy vajza, që i dërgonte në një kurs për mësim feje, pasi i pëlqenin normat morale islame. Në ikje, më la një kartëvizitë që tregonte adresën e saj në Berlin të Gjermanisë. E mora atë copë karton të shtypur dhe pse nuk besoja se do të më hynte në punë për ndonjë telefonatë e aq më pak për ndonjë vizitë të mundshme në Berlin. Sidoqoftë e falenderova zonjën për respektin dhe dashurinë që tregonte ndaj fesë tonë, islamit.

Këto ishin vetëm disa nga ato dhjetëra e dhjetëra kontakte me të huaj që kishin vërtet një përshtypje të mirë e një qëndrim dashamirës për fenë islame e unë besoja se shumë pak punojmë ne myslimanët për këtë fe të bukur që Allahu na e dhuroi e të parët tanë na e përcollën deri këtu.

(Shkëputur nga libri
"Margaritari i Kurorës)

"Kohë e trazuar" Ymer Keta!

Shënime për romanin me të njëjtin emër



"Tri ditë e tri net Erlindi buzë shkëmbit të shkretë lau me lot e me gulshe vaji morekujenë e kohës së trazirave, i vetëm me mortjen, qiellin e zi dhe me vikamën e Eljanës !

Më vrau koha Erlind !

Dashuria Eljanë – Erlind ishte një metaforë dashurie njerëzore e pa diktuar më parë. Koha dhe mëkati gatoi tragjizmin..."

Janë rreshtat e fundit të romanit "Kohë e trazuar" të publicistit, studiuesit dhe shkrimtarit me rrënjë, zemër e shpirt dibrani Ymer Keta që nuk e harron Dibrën, nuk e harron Bulqizën ku lindi afro 75 vjet të shkuara e ku bashkë me ujin e pastër të burimeve dhe qumështin e deleve mori jetën që e ka përcjellë në dymbëdhjetë vepra, njëra më e veçantë se tjetra.

Me arsim ushtarak dhe juridik, njohës i galerive të minierës së Bulqizës e të sondave në kërkim të mineralit të kromit maleve të larta të Dibrës,Ymer Keta na sjell në një seri botimesh "Bulqizën në shekuj", "Bulqizën dhe Bulqizakët", "Rrëfime në Odën Dibrane", "Njerëzit e mi në rrjedhë të historisë (Monografi e fisit Keta), "Heronjtë e nëntokës"-një monografi me minatorë të rënë në galeritë e minierave Bulqizë, Batër e Kurbnesh". Monografinë "Fisi DEDA i Kaçinarit", "Shënime nga ditari im", "Drama e një jete", "Antologji e Poezisë Dibrane", "Rrëfime të gdhendura në kujtesë", vëllimin me poezi "Zemrën atje e kam" për ta vijuar tërë këtë punë kolosale intelektuale me romanin "Kohë e trazuar".

Dy duar që s'pushojnë së trokitura mbi tastierën e kompjuterit, një penë që si mbaron kurrë boja, një njohës deri në përkryerje të shpirtit të njeriut-hero i një kohe të mbrapshtë.

Pak me ndrojtje, si në çdo lexim libri, hyra faqeve të romanit në një kohë të pazakontë, një "Kohë të trazuar", më e trazuara, më e egra dhe më e turpshmja e historisë së Shqipërisë. Djajtë dolën nga shishja ku i kishin mbyllur. Dolën me gjithë mëninë dhe shëmtirën, me pisqolla në brez, hanxharë mesjetarë e kallashnikovë modernë në duar për të marrë jetë njerëzish.

Heronjtë e romanit, Erlindi dhe Erjana jetojnë dikund midis Qytetit të Mollëve dhe Qytetit të Erërave. Jetojnë "një dashuri që se ka parë bota", do të thoshte Shekspiri në ndërrim emrash dhe kohësh, në ndërrimin e Romeos në Erlind dhe të Zhuljetës në Erjana. Në të njëjtën kohë një tragjedi që e jeton bota, tragjedi që e le me "duar në gji" Bardhokun dhe Lezen në atë humbje të dhimbshme të dy djemve dhe vajzës...


Në pamje duket se autori i ka mëshuar më shumë kriminales se sa njerëzores, vrasjeve brenda e jashtë vendit dhe dashuria e dy të rinjve mbetet e izoluar në një ishull përballë tallazesh që kapin majat. Nuk është ashtu. Vlera e romanit të Ymer Ketës qëndron në dijen e kohës, një kohe që na duket sikur iku me "një vit të mbrapshtë" por që jeton në të përditshmen e jetës sot, jeton me krisma, me therje, me drogë, prostitucion, me një shtet në kulmin e korrupsionit...

Një kohë që nuk është e lidhur me një vit të mbrapshtë, por me një kohë të mbrapshtë...

Lexuesit me siguri do të derdhin lot faqeve të shkruara të "Kohë e trazuar".

A.Ashiku

BOTIME TE REJA



Gëzim Elezi u lind në Gradec, një fshat i vogël buzë Drinit të Zi, në rrethin e Dibrës, më 21 shkurt 1994.

Ka mbaruar shkollën e mesme e "Sadik Stavileci" në Yrshek. Filloi Universitetin në Durrës për Shkenca Kompjuterike dhe pas dy vjetësh u detyrua ta braktisë.

Në janar të vitit 2015 filloi punë në Abu Dhabi, Emiratet e Bashkuara Arabe, ashtu si shumë të rinj shqiptarë që kanë zgjedhur rrugën e mërgimit si zgjidhje të problemeve të tyre. Sot jeton dhe punon në Dubai.

Ka shkruar disa poezi gjatë kohës së 9-vjeçares, ndërsa në shkollë të mesme filloi të shkruajë rregullisht. Edhe pse në mërgim dhe koha e lirë është e pakët, poezia është pjesë e pandashme e tij.

ISBN: 978-9928-172-74-7
Çmimi: 500 lekë



Jeta nuk do gjumë - Poezi
Botimet M&B
ISBN: 978-9928-172-71-6
Çmimi: 500 lekë

Balliu është përfaqësuesi i atij brez të rinjsh të Shqipërisë që braktisi bankat e shkollës për të siguruar një jetë më të mirë. Atë që ky vend nuk u ofroi në rininë e tyre, ata e gjetën në një vend tjetër. Por malli dhe dashuria për vendlindjen e rritën ndjeshmërinë dhe dashurinë ndaj Atdheut. Dhe Astriti e ktheu këtë ndjeshmëri në nivelin më të lartë artistik: poezinë.

Të dy librat mund t'i gjeni pranë librarisë "M&B", te Selvia.
Tel: 069 20 68 603

cyan magenta yelloë black

Pajtohu në gazetën *RRUGA E ARBËRIT*

Merr versionin PDF ose kopjen print duke filluar me 50 lekë/muaj



Gazeta ofron faqet e saj për REKLAMA apo NJOFTIME të ndryshme për biznese dhe individë.

ÇMIME TË ARSYESHME për faqet me ngjyra dhe bardh e zi.

Për individët, njoftimet deri në 50 fjalë (1/16 e faqes) ofrohen falas!

Për informacion:
E-mail: rrugaearberit@gmail.com
Tel: +355 69 20 68 603

Klinika Mjekësore "VENIS"

Klinika mjekësore "VENIS" është klinika e parë private e Shëndetit Mendor në Shqipëri, e licencuar nga Ministria e Shëndetësisë, regjistruar në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit (QKR) si një aktivitet i tatueshëm.

Në klinikën "VENIS" ofrohet një shërbim i standarteve bashkëkohore si përsa i përket diagnostikimit dhe opsioneve të trajtimit mjekësor jo vetem me skemat e mjekimeve më të reja me barna por dhe me aplikimin e terapisë biologjike të elektrokonvulsoterapise ECT-Thymatron IV (Teknologjia më bashkëkohore), për trajtimin e pacientëve, te të cilët trajtimi i mëparshëm me barna nuk ka dhënë rezultatet e duhura.

1. **DIAGNOSTIKIM**. Procesi i diagnostikimit të çrregullimeve psikologjike apo psikiatrike realizohet pas një ekzaminimi të kujdesshëm nga specialistët e shëndetit mendor të cilët janë psikiatrit ose psikologët klinikë.
2. **TRAJTIM I DEPRESIONEVE REZISTENTE.** Procedura e ECT-së është një procedurë që realizohet vetëm në klinikën "VENIS" në Shqipëri dhe në trojet e tjera shqiptare.
3. **TRAJTIM MJEKËSOR.** Në klinikët tonë ruhet privatësia e individit, respektohen dhe mirëkuptohen orientimi seksual, përkatësia etnike, gjinore, apo preferencat fetare.
4. **KONSULENCË PROFESIONALE LIGJORE.** Klinika mjekësore "VENIS" ju ofron informim dhe ndihmë konkrete ligjore mbi të drejtat e pacientëve.

MOS KINI PARAGJYKIME! Sa më herët të kërkohet ndihma e specializuar, aq më shpejt trajtohen çrregullimet e çdo lloji.

"Venis" ju ofron mbështetjen e duhur.
Klinika ofron shërbimet e saj vetëm në ditët e javës
Orari: 08:00 - 16:00 E Shtunë, E Diel dhe Festat zyrtare: PUSHIM
Vizitat kryhen me planifikim paraprak.
Kontakt: Sekretaria: **04 2400 669** dhe **068 23 96287**
E-mail: **sadikhlala@gmail.com**

printime dixhitale

me ngjyra dhe bardh e zi

shpejtësi | cilësi | çmime të favorshme
libra | broshura | revista | fletëpalosje
katalogë | kalendarë | postera | ftesa etj.

duke filluar nga 1 kopje e vetme

për informacion: mbbotime@gmail.com / Cel. 069 20 68 603

Rruga e Arbërit nr. 122
vendlindja

Përpiqem t'iu shpëtoi dallgëve ujëshumta të lumit Drin e Murra, aty ku ato në shekuj bashkohen, bëhen njësh e udhëtojnë në një shtrat të gjerë për shtatë palë qejfe. Por mua nuk më sjell dobi kështu i hardallosur, prandaj dua të projektoi, të argumentoi, të zbatoi që ai dallgëshumti të më bindet duke kaluar në shtratin që unë me mençuri, bashkëpunim me bashkëfshatarët e mi, të krijojmë realisht.



Algjonet, Lacet, Sinët, Xhamia. *Foto S. Meziu (2014)*



Kodra e Gjareces. *Foto S. Meziu (2014)*

MUHURRI

Vështrim ekonomik, historik dhe etnokulturor

Nga **SELMAN MËZIU**

Përpiqem t'iu shpëtoi dallgëve ujëshumta të lumit Drin e Murra, aty ku ato në shekuj bashkohen, bëhen njësh e udhëtojnë në një shtrat të gjerë për shtatë palë qejfe. Por mua nuk më sjell dobi kështu i hardallosur, prandaj dua të projektoi, të argumentoi, të zbatoi që ai dallgëshumti të më bindet duke kaluar në shtratin që unë me mençuri, bashkëpunim me bashkëfshatarët e mi, të krijojmë realisht.

Por kjo nuk është aq e lehtë se ai i damllosun kështu në mijëvjeçar ka udhëtuar i shkujdesun. E njerëzia brigjeve të tija nga burimi në liqenin e Ohrit e deri në detin Adriatik shumë mirë janë sjellur me atë. Por ja që tani fshatari e qytetari kërkojnë ndryshime. Prandaj....

BINJAKËZIMI I DY BISEDAVE

Ashtu i qeshur, me fytyrën borë të bardhë, flokët e shtati si një lis shumë vjeçar i harlisur Inxhinier Halimi më përshëndeti. Pasi u pyetëm, në bisedën shumëtemëshe ai më thotë me një mimikë që i fitoi papritur një pakënaqësi, një zhgënjim, një keqardhje: "Ka shumë intelektual Muhurri, por nuk po gjejmë një që të shkruaj, për historinë e lashtë e të sotme, për zakonet e pasuritë e mbitokës e nëntokës. Nuk po gjejme farën e bashkim vëllazërimit.,,

Unë i shpreha disa mendime, por sinqerisht ai më gozhdoi, se e vërteta peshon kur e njeh, mendon dhe e gjykon të tillë. U ndamë duke shtrënguar miqësisht duart e përqafuar përmallueshëm.

Në një mbrëmje të gushtit të kaluar po udhëtoja me veterinerin Ilir Qoka. Kishim udhëtuar monopateve të dijes nga shqiptimi e shkuarja e shkronjave shqipe deri tek gjeografia e kontinenteve dhe shteteve, historia e lashtë dhe e sotme e Shqipërisë dhe e botës mbarë. Në ballin e ngushtë në mes rrudhave pashë të rrokulliseshin pika djerse, e fytyra vuante nga dhembshuria për bashkëfshatarët, që dukesh mjaft mirë.

Murmurita disa fjalë, dhe nuk më punonte truri për t'i thënë diçka, një rrugëzgjidhje, një ide të qartë, një projekt që dikush kishte realizuar etj. Dhe ja ky shërbëtor i zellshëm i Muhurrakëve më shprehet:"Ne Muhurrakët jemi të paqanun. Populli i thjeshte po vuan për bukën e gojës, i varfër ekonomikisht, i leckosur, shikohen udhëve fëmijë me opinga si të Lulit Vocërr. Janë shumë familje që iu sëmuret lopa, dhe unë i vizitoi e shëroi por të shkretët nuk kanë me më dhanë as 200 lekë të reja.,,

Ai më nxori nga xhepi bllokun me emrat e tyre që i kishin borxh dhe vazhdoi: "Pse të mos investojnë ato që janë të pasur? Pse të mos tërheqim investime të huaja?Miniera e specialist të shumtë ka treva jonë, apo jo!,,

Këto biseda kam një vit që i bluaj e stërbluaj me mëndjen time, se me të vërtet intelektualët dhe biznesmenët muhërrak zotërojnë energji mendore, fizike e monetare për të krijuar vepra të tilla në shërbim të këtijë populli të urtë, të zgjuar, bujk të apasionuar, mjeshtër ndërtimi, blektor i mrekullueshëm, pemtar i zoti. Por....

VETËM ME DISA LULE NUK.....

Dukuritë e thella politike, ekonomike e shoqërore që ndodhën në Shqipëri në fillimet e viteve '90 padyshim lanë gjurmë të thella edhe tek fshatarësia muhurrake. Së pari me shkatërrimin e strukturave organizative ekonomike, ato mbetën pa të ardhura financiare, kështu që rinia e ndikuar edhe nga propaganda e egër për "xhenetin,, perëndimor, filloi emigrimin në masë. Kjo vetë përbëhet nga dy prirje, shpërngulje të shumë familjeve drejt Tiranës, krahinave e qyteteve bregdetare dhe largimi me të gjitha mënyrat drejt Greqisë, shteteve perëndimore, Turqisë, Sh.B.A., Kanadasë, Australisë etj.

Popullsia që mbeti, mori tapinë e tokave, dhe bujku muhurrak filloi të lëroi tokën, por jo ma me traktorë por me kafshët e punës etj, filloi me blegtorinë, tregtinë etj. Të ardhurat financiare nga burimet e mësipërme deri në vitin 1997, e ruajtën ekonominë shtëpiake fshatare në standarde të pranueshme. Me pas kemi një ulje graduale të të ardhurave për arsye të një politike të braktisjes së bujqësisë e ekonomisë fshatare në mbarë vendin dhe fillimi i një krize ekonomike e financiare mbarë botërore.

Megjithatë të ardhurat monetare nga kurbetlinjt, nxitën ndërtimin e shtëpive të reja, e dikush duke kuptuar investimet në disa veprimtari me dobi të përbashkët për fisin, fshatin apo zonën, si faktor zhvillimi ekonomiko shoqëror investoi. Emigranti Haxhi Xhemal Mëziu, investoi në hapjen e rrugës automobilistike, Fushë-Muhurr- Kodra e Mëzeze, e të tjerë në lidhjen e Shorokanit më rrugë, në lidhjen edhe me ndihmën e Komunës hapja e një rruge Qafa Shënlleshe, lagjia Veshe, e të tjera degëzime brenda fshatrave Bulaç, Hurdh-Muhurr, Shqath, Vajmdhej, Shehri i Vajmdheje etj. Inisiativa e Selman Vokës për hapjen e një Baxhoje, ku prodhohen djathra të ndryshme etj. Blloku i qershive të cilat kane filluar të mbjellin Artan Xhavit Qoka dhe Refik Dan Xhaninë Vnesht në Gjerth. Haxhi Mani në Shqath, ka bllok me pemë frutore, bletë dhe sipërfaqe të mbjellë me sherebelë. Inxhinieri Hazis Lleshi ka një ndërmarrje ndërtimi të fuqishme në Sarandë etj.

Asfaltimi i unazës së Fushë Muhurrit nga Komuna e Muhurrit me kryetar Rrahim Lalën, vumja në funksionim e shkollave tetëvjeçare, të çerdheve në Fushë Muhurr, etj ishin disa nga sukseset, ku ekonomia muhurrake filloi të gjallërohet e të hyjë në udhën e zhvillimit. Por të gjitha këto, nuk sollën në rritjen e mirëqenies së fshatarëve, sepse bujku Muhurrak me tokën shumë të pakët që i takon për frymë, nuk mund të arrijë të nxjerr prodhimet e tija në treg, prandaj me kalimin e viteve gjëndja ekonomike e banorëve muhurrak filloi të ulet shumë. Kjo edhe për arsye të kthimit të shumë emigrantëve nga Greqia dhe Italia nga kriza e thellë ekonomiko –financiare që përfshiu këto vende. etj.

Si përfundim, duke mos patur pjesëtar të familjeve në marrëdhënie pune, me rroga fikse, e të siguruara, e mundësinë për të derdhur lekë për pensione, e ka vështirësue jetën ekonomike, por edhe ka vëne në pikëpyetje të ardhmen e tyre. Kjo gjendje e mjeruar ekonomike, ka ndikuar jo vetëm në rrënimin ekonomik, por edhe në shkatërrimin moral, psikologjik, e detyrimin për t'u larguar drejt vendeve të huaja të rinise deri edhe të fëmijëve nën moshë apo largimin drejt vendeve bregdetare të familjeve të tëra, si zgjidhje ekonomike edhe pse kjo ndoshta dhe e dështueshme.

INTELEKTUALËT, SPECIALISTËT DHE POLITIKA

Kapitalizmi si rend ekonomiko shoqëror i mbështetur kryekëput mbi pronën private, duhet e mund të zgjidh kërkesat për të jetuar nëpërmjet iniciativave të shtetit, shoqatave të llojeve të ndryshme, investimeve nga vendasit dhe tërheqia e të huajve. Nga politikanët, kemi vetëm investimet në ujësjellësa të ndryshme p.sh. ajo që kreu deputeti Paskal Milo, të cilat edhe sot e kësaj dite shfrytëzohen, e muhurrakët e falënderojnë atë. Ne vitin 1997, u shkatërrua përfundimisht Ndërmarrja e Mermerit Muhurr, e kthyer në një gërmadhë të shëmtuar dhe në një mallkim për këtë krahinë. Në vitin 2013 u hap për disa muaj me shumë pak punëtor dhe u zhduk, vetëm një vinç ka mbetur dëshmi e një shprese të humbur, ndoshta përgjithmonë. Prita që mbronte 8 hektarë tokë u shkatërrua, bashke me atë edhe toka bujqësore, një ndër prodhueset me të mira të fasules e mori ujët e Drinit. Vetëm në verën e viti 2012 u ndërtua prita e re. Ndërsa rrugët automobilistike, Lindërsat e Lace, Bulaç, Kroi i zi, Ura e përroit të Losnes Shorokan por edhe ajo qe kalon nga Ura e Drinit deri në perroin e Shehit, janë për tu qarë hallin, gropa kanale, shkëmbenj, mjaft të përshtatshme për të kaluar traktorat me zinxhir.

Agronomi Zaim Rina, ka krijuar nje fidanishte pemësh frutore dhe është treguar gjithmonë i gatshëm për të hartuar projekte për të mbjellë peme frutore në blloqe të vogla ose të mëdha, por edhe ky drejtim zhvillimi ekonomik ka ecur shumë ngadalë. Deri më tani nuk kemi investime, në fusha të ndryshme për të krijuar një veprimtari ekonomike që të punësoi disa dhjetëra muhurrakë, në ndërmarrje të vogla apo të mesme.

Përsa i përket fushës së artit e të letërsisë etj., kemi së pari Naim Osman Berisha me më shumë se 22 libra me poezi, tregime, romane e letërsi për fëmijë si dhe përkthime të disa veprave të Shekspirit. Fadil Islam Hoxha e filloi me vëllimin me poezi "Marshi i çmendur" dhe në dorëshkrim një poem kushtuar Adem Demançit dhe një libër me poezi. Halil Rama një gazetar i shkëlqyer krahas dy librave me bashkautor ka botuar edhe "Fundi i rrugës së vetme", "Testamenti i atdhedashurise", "Memoria historike" etj; Vajmdheasi Astrit Balliu sapo ka dalë përpara lexuesve me vëllimin e dytë poetik "Jeta nuk do gjumë", duke u prezantuar denjësisht në këtë zhanër të letërsisë, pas vëllimit të parë "Princesha ime". Ndërsa në fushën e historisë kemi botimin nga Besnik S. Këbej i studimit "Origjina dibrane e Skënderbeut,, Tirane 2010, i cili jo vetëm shquhet për një këndvështrim origjinal të figurës së Gjergj Kastriotit por edhe zbulimin e rrënjëve të tija prindërore, në Mazrekat e Muhurrit, Gardhin e Poshtëm, Sinë dhe Kastriot duke shfrytëzuar një literaturë të gjërë historike. Monografia e Sami Dodës mbi historikun e arsimit e kulturës në krahinën e Muhurrit është një tjetër studim historik nëpërmjet konsultimit me një dokumentacion të pasur, fotografi e faksimile dokumentash bibliografi të gjerë duke na dhëne historinë pothuajse një shekullore të arsimit e kulturës të kësaj krahine.

Nga muhurraket kemi doktorë shkencash si Veli Lalën, Selman Mëziun, të cilët edhe pse në fusha të ndryshme janë një tregues i qartë i zgjuarsisë, kulturës e mençurisë të muhurrakëve. Ndërsa në fushën e gazetarisë duhet të nënvizojmë gazetarin Kamber Farruku, ku pena e tij lulëzoi për një periudhe të gjatë duke pasqyruar me mjeshtri, kompetencë e vërtetësi punën e madhe të dibranëve në të gjitha veprimtaritë ekonomike, kulturore, politike. Kanë lenë gjurmë të pashlyeshme në shtypin e kohës, Shefqet Disha, Hysni Bruçi, Lik Berisha etj

Nga Bulaçi në prehërin e Runjës, tek Hurdhë Muhurri, Shqathi, Fushë Muhurri, Vajmdhej, Rreth Kale, janë shquar e diplomuar, qindra mësues të të gjitha fushave, inxhiniera te profesioneve të ndryshme, gjeologë, avokatë, agronome, veteriner, zoteknik, oficer me karriere të shkëlqyer, teknikë ndërtimi, gjeometra, jurista, avokatë etj.

Këto kapacitete materiale, intelektuale dhe specialistësh, kërkohet që të vlerësohen, organizohen e të vihen në lëvizje në kahun pozitiv, për të rritur mirëqenien e banorëve të mbetur në këtë trevë duke zgjuar traditat e



Vnesht ne Gjerth, Pasmari. *Foto S. Meziu (2014)*

hershme e të mëvonshme, si punues të gurit, mjeshtra ndërtimesh, prodhues tjegullash e tullash, si peshkatar, gjahtar, prodhues verash e rakie, prodhues të misrit gjushtak e te fasules muhurrake që në vitin 1928 fitoi çmimin e parë në panairin e Parisit, në prodhimet me thuprën e shelgut, në ndërtimin e mullinjve me ujë etj., dhe pasqyrimin e historisë së krahinës së Muhurrit që në Neonolitin e hershëm deri në ditët tona dhe etnografisë së tij.

ZGJIDHJET EKONOMIKE

Ekonomia e një shtëpie, fshati, zone, rrethi apo kombi është stërmbullari i jetës të banorëve. Prandaj marrja në shqyrtim e burimeve ekzistuese në Muhurr, së pari për t'i njohur, zbuluar, vëndjen në shfrytëzim e shpërndarjen sa më rigoroz te të ardhurave fshatarësisë të të gjitha fshatrave.

Miniera e mermerit mbetet një nga burimet më të vlefshme, më të fuqishme për të punësuar banorët e këtyre fshatrave. Që nga prodhimi i blloqeve për ekonominë kombëtare, për eksport, i gurëve për ndërtime shtëpishë etj. Ndërtimi i punishteve të vogla, apo fabrikave për prerje pllakash, prodhimin e tyre me çimento e granil apo copëra mermeri. Sigurimi i tregjeve të shitjes, është një objektiv tjetër për tu realizuar.

Gjithashtu, është për të tërhequr vëmendjen një projekt që duhet të jetë ne arkivin e Ministrisë së Ndërtimit, e cila parashikonte hapjen e një Fabrike çimentoje në Botat e Krrashe, ku uji i bollshëm, argjila e nxjerrë këtu, përdorimi i gurit gëlqeror nga Suka e Leke, mund te ndërtohet një fabrikë çimentoje. Mundësi të tjera janë ndërtimi i furrave për pjekje tullash e tjegullash, në Vnesht në Garth, ku ka patur një përvojë nga fisi Rina e Laci.

Një pasuri tjetër që duhet të shfrytëzohet janë, shelgjishtet, ne shtretërit e Murrës, të Losnës, Drinit etj., për të ngritur punishte në thurjen e shportave, tavave, prodhim karrikesh, tavolinash e zbukurimeve artistike për nevojat e fshatit, Dibrës dhe eksport duke u bërë një burim të ardhurash dhe punësimi.

Guri me damar ngjyrë shumtë, e figura të ç'rregullta që e pret çekiçi dhe e skalit dalta me një bukuri të rrallë, duhet vëne në shfrytëzim për prodhime kollonash, qoshesh dhe zbukurime të tjera që gjendet ne Sukën e Leke, Gjuri i Marke në Hurdh Muhurr, Kepi i Robit në Bulaç? Këto gur tanimë njihen nga banorët e këtyre zonave, të cilat i kanë shfrytëzuar në shekuj në ndërtime shtëpiash etj. Mjeshtrit gurëgdhendës, Hysni e Xhemal Mikli, dhe Sinan e Gani Mëziu, kanë lënë gjurmët në arkitekturën ndërtuese të kullava në fshatrat e Muhurrit që edhe sot të lënë mbresa e të habitin me bukurinë e tyre fal duarve mjeshterore në artin e skalitjes, gdhendjes se shqiponjës pellumbit etj. Përdorime të tilla të këtyre gurëve i gjen edhe në shtëpitë e ndërtuara ne Bulaç, Hurdhë Muhurr e Shqath, tregues i cili të inkurajon për vazhdimësinë e kësaj mjeshtrie. Burim te ardhurash dhe tregues civilizimi në fillimet e shekullit të ri.

Posht Kroit të zi në vendin e quajtur Kronëza gjendet guri i shtufit, i cili është njohur nga banorët e dikurshëm te këtyre trevave afërsisht në vitin 1200, janë përgatitur qoshet e kishës së Shën Maris në Maje të malit me të njëjtin emër. Ndërsa sot ai është mbuluar nga dheu e dushqet. Mjerisht banorët e këtushëm nuk ia dinë vlerat ndërtuese, zbukuruese, për lulishte, bahqet, korita, skulptura e objekte zbukurimi të panumërta. Ai pritet edhe me tesk (sqepar), me sharrë druri dhe mund të skalitet lehtësisht me dalta. Ja pra edhe një material tjetër i mbitokës muhurrake me vlera të mëdha për tu përdorur, prodhuar, shitur duke sjell të ardhura.

Arti i shrimit të tortuarve, rreth shtëpive, zyrave, spitaleve, vilave e kudo ato janë të domosdoshme, mund të shfrytëzohen, "kacupat" siç i quajnë muhurrakët, të përmasave e ngjyrave të ndryshme, dhuratë këto e prurjeve ujore të përrenjve e lumenjve që lagin trevën muhurrake. Kombinimi i ngjyrave e madhësive jep mundësinë të krijohen vizatime, simbole e figura të ndryshme. E të gjitha këto mund të mblidhen sipas madhësive e ngjyrave duke u futur në thasë arka etj. Kështu mund të tregtohen ose të përdoren nga mjeshtrit murator muhurrak në ndërtime të ndryshme. Përdorim tjetër është vendosja si zbukurime mbi saksitë e luleve ose të shkurreve zbukuruese në restorante, brenda dhe jashtë, në zyra, shkolla në lulishtari në njollat zbukuruese etj. Tregtimi i kësaj pasurie të parapërgatitura nga prurjet e ujërave gjatë transportit të tyre, edhe në qytetet e mëdha si Tirana, Durrësi, Fier, Kavaja, Kruja etj.

Nuk dëshiroi të zgjerohem në idenë e shfrytëzimit të uraniumit, sepse së pari mungon teknologjia e shfrytëzimit, e përpunimit, si dhe njohja e tij si mineral në trevën e Muhurrit, ngjall urrejte e tmerr, sepse ka marrë mjaft jetë njerëzish gjatë kërkimeve gjeologjike. Por si mineral, ai tanimë është vërtetuar gjeologjikisht se ekzistojnë rezerva të konsiderueshme.

Përmtaria ka qenë veprimtaria më e përhapur për fshatarin muhurrak sidomos të mbjella përqark oborrit të shtëpisë, në kopshte, në mejet e arave etj. Njihen arrat me kurora gjigande, të cilat me kalimin e kohës u zhduken. Por edhe kultivimi i mollëve, kumbullave, pjeshkëve, zërdelive, manave, dardhave, rrushëve, ftoive, lajthive, thanave, arrave etj., ka qenë një traditë e shkëlqyer. Ngrënia të freskëta, ose tharja e tyre, berja e reçelëve, likereve apo ruajtja në kashtën e grurit apo tallos deri në ditët e verës hynë në fondin e mjeshtrisë muhurrake. Mbjellja, shartimi, krasitja e plehërimi ka qenë një art i njohur ndërmjet pemtarëve muhurrak. A nuk është Hysen Mikli një mjeshtër i madh i artit të rritjes e shërbimeve në pemtari? Sigurisht! Tanima janë mundësitë që të krijohen sipërfaqe të mëdha me disa nga këto kultura në tokat private.

Nuk mund të shprehesh se muhurraku nuk ka patur tradita në kultivimin e kulturave bujqësore, këtë mund ta shprehim tani nëpërmjet dy fakteve. Nga të dhënat gojore Kastrioti i madh i quante muhurraket "bujqit e mi". Kjo është e lidhur edhe me toponimin me vlera historike "hambaret e Skenderbeut" mbi fshatin Grishqan në përroin me të njëjtin emër. Tjetra, "Guri i mokres" i trasporuar nga mazrekat në Mullirin e Shqefe ishte përdorur nga familia princërore e mazrekaseve. Mulliri i parë me ujë në zonën e Muhurrit është ngritur nga mezi i shekullit të XIX nga Dede Ballashi, tek gjurra e Dik Laçit, në përroin e Shqathit. Pa folur për gjushtakun e Muhurrit, ku po të gatuash një bukë të norë, do të ndjesh një shije të admirueshme. Nuk mund të lemë pa përmendur fasulem muhurrake, shija dhe vlerat ushqyese krahasohen me mishin e viçit etj.

Blektoret muhurrak janë me za në Dibër të Poshtme. Trimërinë e kanë shprehur me betejën për mbrojtjen e kullotave të pllaut nga Haxhi Pashe Zogu nga Nezir Lleshi, Nuz Meta, Lik Rina, Ali Lala, Selman Losha etj. Por ato kanë qenë e mbetën mbarështrues të shkëlqyer të blegtorisë e përpunimit të bulmetrave. Ritja e dhisë së vendit, me trup mesatar, me qumësht të yndyrshëm e mishin e shijshëm janë rritur me qindar vjet nga blegtorët muhurrak. Ndërsa delja rudë dhe reçka të vlerësuar për leshin me përdorim të shumtë në veshëmbathje, shtresa dhomash, mishin e shijshëm dhe qumështin e trashë e mjaft të yndyrshëm. Lopa e vendit që paraqitet me trup mesatar, e shkathët e durueshme ndaj të ftohtit e vapës së nxehte prodhon qumësht me vlera ushqimore të shkëlqyera.

Pyjet janë një pasuri që po të administrohen sipas silvoteknikës dhe me kursim, japin të ardhura për popullsin e Muhurrit. Si në prodhimin e drurëve të zjarrit edhe me vlera përdoruese në ushqimin e blegtorisë. Qoftë ky i gjelbërt apo i thatë në stinën e dimrit. Ndërsa masivet e vogla të aheve përgjatë shpatit lindor të vargmalit të Runjës nuk kanë vetëm vlerat e nje arkitekture të gjelbër në projeksionin vertikal e horizontal, por edhe si mbrojtës mjaft i rëndësishëm dhe me domozdoshmëri të jashtëzakonshëm për tu mbrojtur nga orteqet e borës. Verrijt, shelgjet, plepi i zi ne përrue të shehit, plepat kanades e kavak të mbjellura në brigjet e përrenjve, mejat, vijat e ujit përbëjnë një pasuri të madhe për kullotje, mbrojtjen e brigjeve të përrenjeve, material ndërtimi, dru zjarri dhe si ushqim për blektorinë. Por edhe për prodhim lënde ndërtimi ose prodhime artizanale etj. Rëndësi ka mirëadministrimi i tyre sipas pronësive dhe shfrytëzimi nën udhëheqjen teknike të specialistëve të pyjeve.

Por kjo pasuri, dhuratë e natyrës, mund ti merret me kujdes nga natyra, për jeshilimin e mjediseve të shkollave, kopshteve, çerdheve, komunave, klubeve, dyqaneve etj., si mjedise që duhet të shprehin kulturë, dhe të shfaqin bukurinë e tyre nëpërmjet projektimit, mbjelljeve të këtyre shkurreve e drurëve pyjor me veti biologjike e morfologjike zbukuruese.

(Vijon numrin e ardhshëm)



Nga **ERMIR HOXHA** - Reportazhin mund ta lexoni në linkun: **http://tesheshi.com/spasi-rilindja-e-nje-fshati-te-braktisur-ja-cndodh-kur-shqiptari-ka-vizion-amerikan-mbi-jeten/**



"RRUGA E ARBËRIT" ËSHTË NJË GAZETË E LIRË.

Kontribuo edhe ti për lirinë e saj me vetëm një pajtim!

Gazeta "Rruga e Arbërit" këtë vit mbush dhjetë vjet nga dalja e numrit të saj të parë dhe çdo muaj përcjell informacione, komente, opinione, reportazhe, recensa dhe rubrika të tjera për artin, kulturën, historinë dhe gjithçka që ka të bëjë me qarkun e Dibrës.

Gazeta është një botim i pavarur dhe këtë e ka dëshmuar gjatë këtyre dhjetë viteve me integritet dhe profesionalizëm.

Redaksia mbetet gjithmonë e hapur për sugjerimet tuaja, jo vetëm në trajtimin e tematikave, por edhe për të shkruar mbi veprimtari, individë apo organizata që veprojnë, kontribuojnë apo kanë lidhje me qarkun e Dibrës.

"Rruga e Arbërit" është një gazetë e lirë dhe liria e saj është e garatuar jo vetëm nga redaksia, por edhe nga lexuesit e saj, të cilët ndodhen larg vetëm një pajtim.

Gazeta shpërndahet në Tiranë, Durrës, Burrel, Klos, Bulqizë, Shupenzë, Maqellarë, Peshkopi dhe Dibër e Madhe në versionin print dhe në të gjithë botën përmes emailit në versionin PDF.

Një pajtim vjetor në Shqipëri dhe Dibër e Madhe, si deri më tani, kushton 600 lekë. Në Europë 10 Euro, në SHBA dhe vendet e tjera 15 USD.

Pajtimet jashtë Shqipërisë janë vetëm në versionet PDF dhe mund të kryhen përmes PayPal.

Më shumë mund të shikoni në faqen e gazetës në FB:
Rruga e Arbërit
https://www.facebook.com/Rruga-e-Arb%C3%ABrit-259603234230025/

Fotoreportazh / Udhëtim në kohë

Kur punohej të futeshin burimet në “gotë”...

Ka qenë një dëshirë imja që të mbush grushtin me ujë burimesh e të pi pa u ngopur...

E kam bërë këtë që nga burimi në krye të fushës së Ponairit, në burimin e virgjër të Preshit, në burimin në qosh të Lanë Lurës, në Prat, Kovashicë, Sopanikë, Burimet e Setës, malet e Steblevës...

Kam qenë pjesë e punës për tu marrë burimeve të ftohta ujin për tua çuar njerëzve në gotë.

Në mbi njëqind shkrepje fotografike burimeve malore gjeta ata që punuan me shpirt për ti sjellë Peshkopisë ujin e Korabit, Kastriotit, Kandrit, Nrezhdanit, Ushtelencës ujin e Sopanikës, Maqellarës ujin e Kovashicës...

Në fotografitë e këtij fotoreportazhi kudo gjendet figura e një njeriu të pasionuar pas ujit, një njeriu që ngriti shatërvanë, BAJRAM STOJKUT me shokë. Janë shumë, nuk mi nxë hapësira e shkurtër ti përmend emrat. Janë të gjithë të nderuar për punën dhe përkushtimin e lartë.


Ata i “molën malet” paçka se ata që erdhën pas e derdhen kusinë, shkulën tubat dhe e lanë Dibrën me bucelë në shpinë...

Abdurahim Ashiku

Athinë, 25 qershor 2016



Ura e Topojanit



Sopanikë



Peisazh



Inxhinierë e teknikë



LIQENI I PRESHIT-KORAB



Ura e Topojanit



Saldatorët



Një gotë ujë Korabi



Bajram Stojku



Meditim



MONTATORËT



Fëmijë në radhë te çezmat



Gëzojnë shumbatasit



Gaz e hare

Fletë nga cikli BURRAT E DIBRËS: Udhëtim në një bisedë...
Udhëtim në një rrëfenjë për malet dhe njerëzit e Okshtunit...
Udhëtim në një letërkëmbim të vazhdueshëm me një fëmijë, djalë e burrë të Prodanit...

Me Nazmi Koçin, "pesë orë udhëtim në këmbë"

Nga **ABDURAHIM ASHIKU**





Kam qenë në Prodan, disa orë në përurimin e një muzeu, larg në kohë. Hipur në një makinë të vogël me katër rrota aktive, na u desh ti binim nga shumë larg, nga Klenja e Stebleva për të "kërcyer si skracell" gropave të një rruge shfrytëzimi pyjor.

Kam në arkiv edhe disa fotografi banorësh nga ai çast që hyri e mbeti në kujtesën tim paksa fosforeshent...

Nuk më takoi që të shkoj sërish në Prodan. E kam në merak ashtu siç kam në mungesë rastet tu bije atyre pyjeve pash më pash e ti ngrijë në celuloid njerëzit e mrekullueshëm të atyre maleve, kala trimërie e burrërie...

Ndodhi që një ditë të "udhëtoj me shpirt", "udhës pesë orë në këmbë" të Nazmi Koçit.

Udhëtim në një bisedë...

Udhëtim në një rrëfenjë për malet dhe njerëzit e Okshtunit...

Udhëtim në një letërkëmbim të vazhdueshëm me një fëmijë, djalë e burrë të Prodanit...

Kam shumë për të treguar. Pak sot, e shumë më shumë nesër...

Ato fjalë, ato ngjarje, më rinuan në shpirt e më morën në fluturim atyre vendeve me shumë trimëri e dije e me pak shkronjë në letër...

* * *

...Një fëmijë, dhjetë vjeç, me një çantë bezeje varur krahaqafë, udhëton pesë orë në këmbë për të ndezë në shpirt një dritë, dritën e dijes. Kaq ishte rruga këmbësore ngjitu e zbrit nga Prodani në Ostren. Udhëtim në këmbë, në shi, në dëborë, në vapë, udhëtim si në legjenda...

Në këmbë do të udhëtonte Nazmi Koçi fëmijë, i ri, burrë, prind...një jetë të tërë. Udhëtim në rrugë pa rrugë, rrafsh e me gropa.

Kam lindur në Prodan të Okshtunit më 17 prill të vitit 1947- e nisim bisedën ndërsa gjerbnim kafenë në një lokal në "Rrugën e Dibrës". - Aty kam bërë shkollën fillore. Kam pasur fatin e mirë si unë edhe pjesëtarët e familjes, që kisha mësues babanë tim. Babai im Selman Koçi kishte punuar në komitetin ekzekutiv të qarkut të Dibrës, kryetar lokaliteti dhe detyra të tjera nëpunësie por më në fund e lidhi jetën me arsimin.

Ishte shkolluar në Lis të Matit në vitin 1934. Kishte bërë internatin atje. Kishte bërë disa kurse për arsimin në Elbasan, Tiranë. Ëndrra e tij ishte arsimi dhe përfundoi arsimtar në fillim në Borovë pastaj në Prodan.

Dhe bëri një shkollë që të gjithë ata që e kishin parë, përfshi edhe ish shefin e arsimit, Mësuesin e Popullit Selim Alliu kishte deklaruar se ishte shkolla më e mirë në rrethin e Dibrës.

Në Okshtun nuk kishim shkollë shtatëvjeçare kështu që unë në moshën 10 vjeçare u detyrova të shkoj në Ostren të Madh. Të mëdhenjtë e bënin atë rrugë për katër orë kurse unë si i vogël e bëja për pesë. Atje kam bërë klasën e pestë. Kisha një avantazh sepse kisha hyrë i vogël në shkollë. Më 30 nëntor mbarova klasën e katërt kurse me 1 dhjetor fillova të pestën. Brenda një viti bëra dy klasë. Gjithnjë kam qenë në avancë për efekt të këtyre rrethanave sepse në Prodan ishte shkollë verore që hapej në mars dhe mbyllej në fund të nëntorit.

Në Ostren të Madh kam pas fatin të kem mësues të shkëlqyer. Drejtor i shkollës ishte Idriz Biba nga Okshtuni, një normalist i madh, një mësues që do të bëhej pedagog në Institutin e Shkodrës ku jepte matematikë. Mësues kujdestar imi ishte Halim Shehu nga Sllova. Kisha edhe mësues të tjerë dhe nganjëherë me shaka u thoshim: "shkolla është tek ju kurse mësuesit janë nga Okshtuni".

Okshtuni ka qenë fole mësuesish që në vitin 1907-1908 me Hoxhë Muglicën dhe që vazhdoi e vazhdon edhe sot të ketë shumë arsimtarë.

Në Ostren të Madh kam bërë dy klasë, klasën e pestë dhe klasën e gjashtë. Kisha mësues edhe Selami Muglicën, edhe Jona Muçën.

Mësuesi im Halim Shehu i tha njëherë babait pjesë e kështillit pedagogjik.

"Selman! Djemtë tanë janë fëmijët më të mirë të shkollës, por të shkollës së Ostrenit ama".

Këtë e kuptova më vonë kur klasën e shtatë e bëra në shkollën Demir Gashi në Peshkopi. Atje, megjithëse kisha qenë me të gjitha pesa pata shumë vështirësi në gjuhën shqipe sepse shkolla që kisha bërë unë, edhe në klasën e gjashtë merrej me ndarjen e fjalës në rrokje kurse mësuesit e mi në Peshkopi Adem Shehu e Ilir Ramizi bënin gjuhë shqipe të nivelit të klasës së shtatë. Lënda më e vështirë për mua në klasën e shtatë ishte kjo. Në matematikë sipas vlerësimeve që bënte Xhelil Kulemani u radhita më i miri i klasës.

Kam pas shokë klase njerëz që janë bërë figura të nderuara. E mora me vete fjalën e profesorit tim Halim Shehu se ne ishim "nxënës të shkëlqyer të kësaj shkolle".

Kam mbaruar shkollën shtatëvjeçare "Demir Gashi" në vitin 1960.

Babai më detyroi të bëja dy klasë në një vit, pesë orë larg me idenë që të më arsimonte. Ai ndikoi edhe si baba, edhe si mësues, modeli im për jetën edhe sot ndikoi që unë të kaloja në mjekësi.

Fillimisht ishte ideja për të ndjekë rrugën e babait, të vazhdoja për arsimtar. Duke qenë se babanë e kisha mësues priresha. Më dukej vetja në ëndrra sikur isha mësues dhe jepja mësim përpara fëmijëve. Babait tim i pëlqente mjekësia. Duke qenë një zonë ndërtuesish më dhanë të drejtën e studimeve për teknik ndërtimi. Babai tha se nuk më pëlqen. Në qoftë se nuk do të bëhesh mjek atëherë më mirë të bëhesh mësues. U konsultua me Selim Alliun. Ai e donte shumë Selmanin, kishin punuar shefa seksionesh bashkë pastaj e donte babanë tim dhe ishte një kolos i vërtetë ashtu siç e di gjithë Dibra dhe i tha Selman ti e ke shumë mirë, edhe unë e kam çuar vëllain për mjek. Dibra ka nevojë shumë për mjekë. Unë nuk kam bursa në mjekësi kështu që ai duhet të shkojë me pagesë. Ishte një e drejtë me gjysmë burse. U bë razi ta paguante, të më çonte me pagesë, ama atje ku donte ai dhe unë.

Në shtator të vitit 1960 fillova shkollën në Politeknikumin Mjekësor të Tiranës. Ëndrra e babait tim u realizua. Po ashtu ajo u bë edhe ëndrra dhe qëllimi i jetës time.

Si i ardhur nga periferia isha pak i ndrojtur. Shikoja të tjerët që ishin më të shkathët, më të zhdërvjellët, pse jo edhe më të veshur. Mendoja në se do ta përballoja këtë apo jo. Iu kushtova mësimeve dhe shumë shpejt u evidentova si nxënës i mirë që përparoja në të gjitha disiplinat dhe ecja mirë si në letërsi, matematikë kaq sa mësuesi i matematikës njëherë më tha "Po ç'ke ardhur këtu? Të shkoje në gjimnaz dhe të ishe një profesor matematike në gjimnaz."

Kisha marrë drejtimin tim, nuk bëja koncesion me atë që kishim vendosur me babanë. Dhe në qoftë se gjatë jetës kam arritur sukses i dedikohet asaj që nuk kam qenë njeri i mëdyshjeve. Nëse kam marrë një drejtim kam ecur në atë drejtim. Këtë ua kam sugjeruar edhe fëmijëve të mi, edhe studentëve të mi.

Vazhdova të studioj dhe në semestrin e parë kisha dalë me nota shumë të mira dhe bashkë me një mjek tjetër nga Dibra, të nderuarin Qemal Çadri i cili kishte mbaruar vitin e tretë, bashkë me një mjek tjetër që më vonë u bë një politikan i madh, në shkurt të vitit 1961 na nxorën para shkollës dhe për rezultate të shkëlqyera, na dhanë bursë. Kështu që unë e shpërbleva sakrificën e babait. Unë isha më i vogli midis atyre të dyve dhe suksesi im u quajt më i madh. Unë e mora në një semestër bursën kurse ata pas dy vjet e gjysmë. E kompensova sakrificën që kishte bërë familja dhe arrita ta mbaroj shkollën e mesme me rezultate shumë të mira.

Dibra kishte nevojë për kuadro dhe nuk mu dha bursë pasi mbarova shkollën e mesme. Rrethi kishte bërë një kërkesë që na donte atje në punë.

Im atë hoqi dorë. Më tha se ti bëre shkollën e mesme, je rritur, unë të them shko në punë dhe unë do të rris fëmijët e tjerë. Në se do të merresh me shkollën më tutje këtë punë duhet ta bësh vetë.



Unë kam ecur vetë. Harxhova disa muaj duke shkuar e duke ardhur. Veja nga Ballenja dhe nga Mali me Gropa... Kam udhëtuar mbi makina ngarkuar me dru, pa pi e pa ngrënë dhe nuk u tërhoqa kurrë derisa takova ministrin... Nuk fola si fëmijë shumë i edukuar po i lodhur dhe i mërzitur nga gjërat i thashë që nuk gjej asnjë shkak pse nuk duhet të shkoj në shkollë të lartë përveç origjinës që jam nga Dibra. A ka ndonjë politikë të tillë që nuk duhet të shkoj pse jam dibran?

Unë kam ecur vetë. Kjo është një histori më vete që ia vlen ta kujtoj. Harxhova disa muaj duke shkuar e duke ardhur. Veja nga Ballenja dhe nga Mali me Gropa sepse i bije ta kemi më afër si fshat. Kam udhëtuar mbi makina ngarkuar me dru, pa pi e pa ngrënë dhe nuk u tërhoqa kurrë derisa takova ministrin të cilit më duhet ti jem mirënjohës. Nuk fola si fëmijë shumë i edukuar po i lodhur dhe i mërzitur nga gjërat i thashë që nuk gjej asnjë shkak pse nuk duhet të shkoj në shkollë të lartë përveç origjinës që jam nga Dibra. A ka ndonjë politikë të tillë që nuk duhet të shkoj pse jam dibran?. Ma thoni? Unë notat i kam, qëndrimin e kam, babanë e kam mësues...

Ai e thirri drejtorin e arsimit të lartë dhe e pyeti se pse nuk e keni çuar këtë djalë në shkollë.

Plani i tha...

Ai mori listën, më pyeti se si e kam emrin dhe shkroi poshtë listës emërore emrin tim 1/1 Nazmi Koçi. I tha afishoje listën. Mua më dha emrin e sekretares së fakultetit dhe më tha do të shkosh të takosh Donika Budo, një grua zonjë, me dekan Hiqmet Dibrën. Ajo ishte strumbullari i fakultetit.

Fakulteti kishte vështirësitë e veta sepse unë e fillova më 1 dhjetor të vitit 1964. Kishin kaluar disa muaj mësim dhe në janar ishin provimet. I pari që më nxori kartonin e kuq ishte profesori i fizikës i cili më tha se po mungove qoftë edhe një orë je i pa klasifikuar. Më vonë e tërhoqi.

Mësuesja e rusishtes në orën e parë më pa me skepticizëm kurse orën e tretë më nxori para klasës dhe u tha të tjerëve bëjeni siç e ka bërë ky.

Kështu avash - avash erdhi sezoni i provimeve. Në atë kohë sapo kishin ikur pedagogët rusë. Fakulteti kishte problemet e veta, vështirësitë e veta. Libra nuk kishim. Kishim përkthime të literaturës ruse të përkthyera keq. Pedagogët kishin qenë asistentë të rusëve dhe tashmë u bënë titullarë dhe shumë herë na kishin deklaruar se do të hyni në vrimë të gjilpërës, mund të ishit bërë traktoristë, kuzhinierë...

Ishte një kohë që kishte vështirësitë e veta mjafton të përmend. Kemi hyrë 24 vetë në provimin e fizikës dhe kanë kaluar 4 vetë. Njëzet janë rrëzuar. Hynë njëqind vetë në vitin të parë dhe në vit të dytë kalonin tridhjetë. Unë nuk pata asnjë mbetje.

Në vitin 1969 u diplomova. Diplomën ma dhanë me një motivacion të shkruar me dorë sa një faqe gazete ku thuheshin shumë fjalë të mira për mua që lidheshin si me rezultatet në mësime por edhe me pjesëmarrjen dhe suksesset në veprimtari jashtëshkollore.

Në vitin e dytë më bënë komandant të një brigade të njëmijë e ca studentëve të mjekësisë. Në klasë kisha figura si Sabit Brokaj, Kristo Pano, Mua një djalë të ri më vunë komandant brigade.

Në garat e GPM që na bënin në atë koha arrita të kap kategorinë sportive në garat 800 dhe 1500 metra derisa profesori i fizkulturës donte me çdo kusht të më merrte në ekipin sportiv. Unë kisha një akord të hershëm me familjen dhe babanë që të mos leja mjekësinë.

(Vijon në numrin e ardhshëm)

Rruga e Arbërit nr. 122
publicistikë

Uliksi në Itali



Nga **DIONIS XHAFA**

Uliks e kishte emrin dibrani 19 vjeçar i cili mbante këtë emër për shkak se në zonën ku kishte lindur kultura oksidentale kishte ndikim tejet të madh tek shqiptarët. Aq më tepër që Uliksi kishte lindur në vitin 1993 viti i "shpërthimit të madh demokratik" në Shqipëri. Ishte pikërisht kjo koha kur fëmijëve iu liheshin emra nga më të ndryshmit nga oksidenti, madje edhe nga ata më të çuditshmit duke braktisur emrat tradicionalë si Mira, Besa, Beni, Luan apo Fatmir. Uliksi pak e nga pak ishte rritur fizikisht, kishte kryer jo pak vite shkollë dhe se pak e kishte njohur egërsinë e jetës. Ai kurrë nuk kishte udhëtuar jashtë kufijve të Republikës së Shqipërisë dhe për se çfarë ndodhte jashtë shtetit të vet amë vetëm në radio e television e kishte dëgjuar dhe rrallë kur kishte lexuar ndonjë gazetë.

Uliksi periudhën e fëmijërisë e kishte kaluar disi mirë. Kurse me rritjen e tij trupore, ai vetë dhe familja e tij kishin rënë ndjeshëm ekonomikisht. Situata nuk ishte aspak e mirë. Vizat për shqiptarët e Shqipërisë sapo ishin liberalizuar. Djali dibran kështu e kishte mundësinë që për tre muajt e verës të ikte për në Itali, aty ku punonte dhe jetonte prej shumë vitesh babai i tij. Nuk kishte se ç'të humbiste. Në mëngjesin e asaj dite vere mamaja i kishte përgatitur gjithçka dhe ishte bërë gati për ta përcjellë. Uliksi do të nisej për në Itali. Kishte qenë djalë i urtë, i mirë. Sistemi politik shtypës, shoqëria tepër inatçore e Shqipërisë me siguri që ishin ndër faktorët kryesorë se përse Uliksi po e linte vendin e lindjes për disa muaj dhe për të punuar paksa në vend të huaj.

Djali 19 vjeçar kishte për tu nisur drejt një rruge të panjohur, me një valixhe në dorë dhe me një pasaportë në xhep. Përshëndeti familjarët. Mamaja e tij nisi të qajë. Në ikje shihte mjegullisht gjithandej. Shihte zezonjë të sistemit. Me valixhen në krah u nis për në një rrugë qorre. Shkon në qendër të qytezës dhe aty merr një furgon. Heshtje varri. E kryen udhëtimin normalisht deri në Tiranë. Në kryeqytet merr tjetër furgon për në Durrës.

I vetëm ecën rrugëve të Durrësit. E merr një biletë trageti deri në Bari. Kushtonte 60 euro. Edhe tre orë bëhej nisja e tragetit, në 23.00. E piu një kafe zhytur thellë në mendime. Ngadalë-ngadalë nisi të errësohej. Me valixhen në krah u drejtua për tek porti. Dorëzoi pasaportën, ia miratuan, dhe vijoi të ecë për të hyrë brenda në traget. Pasi bëri një copë rrugë nëpër betonin e portit me valixhen në dorë, gjithnjë i menduar, hyri brneda mjetit lundrues. Aty zuri një vend. Valixhen e mbështeti për një cepi të tragetit, u ul dhe me pamje prej njeriu të vuajtur, po sodiste qytetin natën.

TRAGETI LË PAS DURRËSIN

Uliksi, pasi qëndroi njëzetë minuta ulur dhe mjeti nuk po lëvizte, më në fund diktoi se trageti u ndez. Ora shënonte 23.00. Uliksi, që aty ku ishte ulur, në pjesën e pasme të tragetit dhe në ambjent të hapur, mendueshëm sërish po shihte Durrësin. I zunë sytë fillimisht farin e portit. I la përshtypje ngjyra e kuqe që e kishte fari dhe drita e gjatë të cilën e lëshonte ky far nga Durrësi drejt tërë bregut të detit. Qyteti ishte i zi si nata, por me drita e poça të shndërritshëm që e bënin jo pak romantik. Hera-herës Durrësi bëhej si vetë fati i Uliksit: I zi fort dhe me drita shumëngjyrëshe diku tek –tuk. Edhe pallatet., gradaçelat ishin zhytur në zi e pak drita dalloheshin.

Uliksit i bëri mjaft përshtypje ajo pamje. Në qytezën nga ai ishte, sapo ora të shënonte 23.00 askënd nuk e gjeje rrugëve dhe se shuhej çdo poç e jetë nuk kishte më. Durrësi në sytë e Uliksit sa vinte e largohej, teksa trageti "çante" detin drejt Italisë. Më tutje, si bëri e u zhduk pak nga Durrësi, Uliksi ndjeu aromën e detit. Nuk e dinte se deti kishte aromë. Ishte vërtetë fantastike për të aroma e detit që po shijonte. Por tek deti diçka e habiti më së tepërmi: vetëm lëvizte.

Mendoi se deti qenka i veçantë, si ujët e lumit për shkak se nuk ndalej. Por se iu bë se ishte i veçantë nga lumi pasi vëzhgoi se deti ishte i paanë. Mendoi sesi ky det e lidh një shtet me një tjetër shtet, një kontinent me një tjetër kontinent. Botë e habitshme. Aty Uliksi u njoh edhe me disa djem të cilët po luanin me letra. Kurse 19 vjeçari dibran ishte ulur në dyshemenë e tragetit, kokën e kishte mbështetur për muri dhe donte të flinte. Kjo pasi kishte ngrënë çka mamaja i kishte përgatitur. Kjo edhe sepse po kursente dhe nuk hëngri në restorantin e tragetit. Ra gjumë rëndshëm.

ZBRITJE NË BARI

Uliksi ishte mbështetur në "murin" e tragetit dhe aty kishte fjetur gjumë të rehatshëm për tetë orë rresht. Pranë tij, disa djem, kryesisht nga Kavaja kishin luajtur me letra thuajse tërë natës. Uliksi shpesh i kishte ndjerë, ishte çuar për pak kohë, sytë diç i kishte hapur sikur në mjegull dhe prapë kishte rëndë gjumë rëndshëm. Tashmë u çua. Sapo hapi sytë, vërejti se pranë tij gjendej çanta blu me rrota që e kishte marrë nga shtëpia. Edhe njëherë iu kujtuan me dhëmbshuri në shpirt lotët e nënës teksa e përcolli për në emigrim.

Me shpejtësi, doli jashtë, tek kuverta, tek pjesa e përparme e tragetit. Vërejti mjegull përmbi det. Kurse teksa kulloti sytë larg, vërejti brigjet e Italisë. Në atë freski mëngjezore, vërejti qytete e ishuj në anën tjetër të Adriatikut. Pikërisht aty do të shkonte. Veç pesë kiulometra larg Barit gjendej tanimë. Trageti me ngadalë u ndal. Uliski pa sesi për nja njëzetë minuta punëtorët italianë të portit e ankoruan tragetin. Ai pa sesi gjatë koordinimit, italianët lëshonin litarët dhe bërtisnin me të madhe që të dëgjonte tjetri për karshi. Trageti u ankorua. Njerëzit filluan të shpërndahen. Uliksi, gjithmonë me valixhen me vete, zbriti tëposhtë.

Ai përnjëherë pa plot me kërshëri qytetin e Barit. Ky ishte qytet tepër i qetë. Tek tuk shihje karabinierë të veshur tepër me sqimë të cilët flisnin me njëri tjetrin. Ujët e detit aty, kurse makinat ecnin pa ndërprerë në xhadenë tepër të rregulluar. Bari si qytet në përmasa ishte pak a shumë sa Durrësi por shumë më i qetë dhe më i rregulluar. Uliksi në Bari pa edhe pallatet e rradhitura kaq bukur, kaq me finesë dhe me ngjyra të shumta.

Ai kaloi edhe për nga stacioni i trenit i qytetit. Teksa ecte ashtu habitshëm dhe i yshtur me kuriozitet, Uliksi vërejti se thuajse në qendër të Barit gjendej një lapidar. Ky ishte lapidari i Luigj Gurakuqit, mbrojtës dhe krahu i djathtë i Fan Nolit si dhe thonë se urdhërin për ekzekutimin e tij e ka dhënë Zogu. Pra u vra për hesape të pastra politike në një kohë kur egërsia e politikës në Shqipëri ishte në kulmin e vet, diku nga vitet 1930 e tëhu. Në sytë e Uliksit bëri habi fakti se një hero shqiptar, të cilin e kishte mësuar në librat e historisë, ta kishte varrin në Bari të Italisë. Atëherë mendoi se bota qenkërka vërtetë e madhe dhe thuajse e paanë.

DREJT NAPOLIT

Uliksi thuajse e shëtiti Barin por se destinacioni final i tij ishte Napoli. Dhe se Napoli ishte qytet gjeografikisht shumë më lart në very të Italisë sesa Bari. Napoli gjendej thuajse në qendër të shtetit italian. Për të ikur drejt Napolit, uliksin do ta ndihmonte Seadi kushëriri i dytë i tij i cili e njihte mjaft mirë Italinë. Uliksi hipi në makinë dhe do të udhëtonte disa orë të mira deri në Napoli. Rrugës ai pa gjelbërim, pisha, drunj, ullinj e vreshta.

Kishte plot plantacione rrushi dhe frutash nga më të ndryshmet. Madje pa edhe helika të mullinjve të erës. U mahnit nga ajo pamje. Shqipëria, që aq e lëvdojnë këtej nga anët tona, pak ose aspak i ka ato bukuri natyrore. Kjo për shkak se Shqipëria është thuajse 70 përqind e mbuluar nga malet. Për orë të tëra Uliksi, e shijoi natyrën kryesisht baritore mes Barit dhe Napolit, vend ku Uliksi kishte babain.

Në fakt makina e la Uliksin në një fshat tjetër të Napolit dhe jo në Nola, ku gjendej babai i tij. Uliksi zbriti nga makina pasi kishte udhëtuar mjaft kohë. Ishte pikë vape. Dielli thuajse të piqte. E kishin dërguar pranë një vendi ku qëndronin shumë emigrantë shqiptarë. Anës rrugëve si të humbura me asfalt të fshatit napolitan pa se kishte gjethe duhani thuajse dy metra të gjatë. Diellli vijonte të përvëlonte. I thanë Uliksit se disa shqiptarë emigrant po punonin duhanin edhe pse ora ishte afërisht 14.00 dhe dielli të përvëlonte. Shqiptarët ishin future nëpër rreshta të parcelës me duhan dhe punonin me aq sat ë kishin fuqi. Pak më tutje ishte një derë. Këtu, pasi Uliksi hapi derën iu shfaq drama e vërtetë...

KULTURË

Ringjallje, një ekspozitë e piktorit Afrim Shatku në Shkup



Në fillim të muajt qershor, në shtëpinë e kulturës "Koco Racini" arkitekti dhe piktori dibran me banim në Shkup, Afrim Shatku, hapi ekspozitën e tij personale të titulluar "Ringjallje".

Në prani të artdashës të shumtë, miq dhe familjar të piktorit të ardhur nga Tetova e Dibra, Struga e Gustivari, Kumanova e Shkupi, ishin të pranishëm dhe ministri i Mjedisit të Republikës së Maqedonisë z.Bashkim Ameti, prof. Sabahudin Zhuta, poetët Sami Sherifi, Kalosh Çeliku, aktori Megdi Alidemi e tjerë.

Moderatorja, gazetarja e njohur Arlinda Kalisi, bëri prezantimin dhe foli për krijimtarinë e arkitektit dhe piktorit Afrim Shatku, pastaj për të folë më gjatë ja dha fjalën prof. Reshat Ameti, profesor në fakultetin e Arteve Figurative në Universitetin Shtetëror të Tetovës.

Gjatë vizitës së ekspozitës u bënë pyëetje e përgjigje nga piktori, një bashkëbisedim artistik me të pranishmit.

I. Dervishi

traditë

Jeta fetare në fshatrat e krahinës Kala e Dodës, është e lidhur ngusht me besimin e tre shtresave fetare: parakristiane, kristiane e islame, të cilat kanë përftuar një sinkronizim të dalluar mirë e që shfaqet në të gjitha sferat e jetës e aktivitetit të tyre

Jeta dhe besimit Islam në Kalanë e Dodës

Nga **ERMIRA SHEHU - TOCA**

Pesëmbëdhjetë fshatrat e bashkësive blegtorale të krahinës së Kalasë Dodës, shtrihen në zonën veri-lindore të Shqipërisë, në veriperëndim të masivit malor të Korabit.

Krahina e Kalasë Dodës, me pozicionin e saj gjeostrategjik shumë të rëndësishëm, nga ku sigurohet lidhja më e shkurtër dhe më e lehtë midis ultësirës bregdetare e luginës së Drinit të Zi me Kosovën e Pellgun e Pollogut, me kullotat alpine nga më të mirat në të gjithë zonën e Ballkanit Perëndimor, ku me sukses, banorët e kësaj krahine, që në lashtësi kanë mbarshtuar delen rudë, kanë krijuar një shtrat etnokulturor që krahas dukurive të përbashkëta kombëtare e makrokrahinore, kanë spikatur edhe disa veçori dalluese, jo vetëm në zakone e tradita, por edhe në mënyrën e jetesës, duke e përcaktuar Kalanë e Dodës një krahinë etnologjike me vlera të veçanta në tabllon e mozaikut kombëtar të krahinorizmit. Ndër vlerat më të veçanta të këtyre blegtorëve, ka qenë e mbetet, përjetimi i besimeve fetare.

Jeta fetare në fshatrat e krahinës Kala e Dodës, është e lidhur ngusht me besimin e tre shtresave fetare: parakristiane, kristiane e islame, të cilat kanë përftuar një sinkronizim të dalluar mirë e që shfaqet në të gjitha sferat e jetës e aktivitetit të tyre. Ky sinkronizim është arritur duke përthithur e ndërthurur shumë elementë të paganizmit nga besimet e më vonshme, të cilat janë përshtatur duke marrë edhe emra të ri shenjtësh, por në përmbajtje e ritual ruajnë element të besimit pagan (fetishizmit, totemizmit, animizmit, magjish etj.) Këto zbulohen tek kultet e natyrës, të bujqësisë e blegtorisë, të familjes, përfshi dhe kultin e të parëve, të festave e ditëve në shenjë të figurave mitologjike etj.

Besimi islam, i bazuar në parimin e unitetit të shpirtit e materies, forma më e lartë e të cilit është jeta njerëzore, gjeti aq përshtatshmëri dhe pika takimi me proceset e zhvillimit të jetës, të zakoneve e traditave të banorëve të krahinës së Kalasë Dodës, sa duket sikur vetë jeta e këtyre banorëve e gjeti rrugën e Islamit.

Duke u mbështetur në të dhënat gojore, si dhe punimet e studiuesve Selami Pulaha në përkthimin e studimin e defterëve kadastral osman të shek.XVI.(1529-1539,1571-1591), të M.Tërnavës, të G. Gjinit, të B.Ahmetit, të D.Shan Zefit, të Shefqet Hoxhës, etj., si dhe nga shkrimet e udhëtarëve dhe diplomatëve të huaj që e kanë vizituar këtë krahinë si: E.Durham, Hahn, Jastrebov,etj., mund të themi se myslimanizmi, si proces, nuk qe i menjëhershëm edhe në fshatrat e Kala të Dodës. Ai ka hyrë shkallë-shkallë e fshat pas fshati edhe në këtë vis, por duke patur gjithmonë veçori, që erdhën si rezultat i pozitës gjeostrategjike të fshatrave të këti visi, të drejtimit ekonomik që kishin banorët e këtyre fshatrave, kryesisht mbarështimin e deles rudë, si dhe të kaluarës fetare, e zhvillimeve historike-shoqërore, veçanërisht të gjysmës së dytë të shekullit XV dhe fillimit të shekullit XVI.

Zhvillime të dukshme të përhapjes së islamizimit në krahinën e Kalasë Dodës filluan që në periudhën e Sulltan Sulejmanit (1527- 1565), i cili me reformat e guximshme ushtarake e administrative krijoi një mjedis të sigurt pune dhe veprimtarie shoqërore në të gjitha skajet e perandorisë. Në Kala të Dodës u vendos një garnizon i përhershëm ushtarak në roje të rrugëkalimeve, dhe të institucioneve të Kazasë (Kalaja e Dodës ishte Kryeqendra e Kazasë së Lumës). Për blegtorët e Kalasë Dodës, rruga e shtegtimit të blegtorisë për në kullotat dimërore në brigjet e Egjeut, njohu sigurinë më të madhe, dhe njëkohësisht solli edhe kontaktet e para me fenë islame, parimet e së cilës përshtateshin në mënyrë të përsosur me veprimtarinë e punën e blegtorëve si dhe me mënyrën e jetesës së tyre.

Procesi i islamizimit të banorëve të fshatrave të Kalasë Dodës, do të përfundoi plotësisht nga mesi i shekullit XVII.

Ndërtimi i xhamive dhe teqeve, në 15 fshatrat e krahinës si dhe hapja e shkollave fetare (mejtepeve) pranë tyre, ku jepnin mësim



Xhami në Kala të Dodës. Foto: FB/Kala e Dodes

> Islamizimi solli në Kala të Dodës, ndryshime të dukshme në organizimin shoqëror, dhe veçanërisht, në kulturën e jetesës së këtyre banorëve, si dhe në formimin e personalitetit të tyre me vlera më të lartësuara, në fe, moral e qytetari. Këto vlera nuk u shuan edhe pas tronditjeve të mëdha të luftës kundër zakoneve prapanike e paragjykimeve fetare të vitit 1967, ku u shembën teqe e xhamia, por nuk u arrit kurrë, që këta njerëz të largonin nga jeta e tyre vlerat morale dhe ushtrimin e riteve dhe parimet e fesë islame, pasi ato ishin bërë pjesë e pandarë e jetës së tyre.

intelektual të njohur të klerit mysliman vendas, edhe me tituj e grada shkencore, si Hafuz Shtini e Hafuz Darsi në Fshat, Hafuz Nexhipi e Hafuz Tasim Ahmati në Radomirë, Hafuz Potja në Palush e Hafuz Shabani nga Prishtina, si dhe imamllarët Molla Vehbia, Hoxhë Cereni, Molla Sadiku, Molla Tefiku e Molla Gafurri në Radomirë, Ceren e Ploshtan, Hoxhë Vasia, Haxhi Rexhepi e Sheh Veseli në Vasije, Molla Sadik Potja, Molla Halil Palushi, Hoxhë Lita e Molla Osman Hasa në Palush, Bushtricë e Gjegje etj. të cilët me interpretimet dhe predikimet e tyre dhe në bashkëveprim me shehëlerët e teqeve, krijuan një mjedis fetar, larg intolerancës e fanatizmit doktrinor, ku parimet e Islamit gjetën një shtrat përbashkësish dhe pika të shumta kontakti, me kulturën e jetesës dhe zakonet e traditat e këti visi. Në Salnamen e Vilajetit të Prizrenit të vitit 1873, (Hasan Kaleshi, H. Jurgen,Vilajeti i Prizrenit, I,"Përparimi" 2, Prishtinë,1967,f.298), shënohet se, "në nahijen e Kalasë ka 7 mejtepe me 350 djem e 100 vajza". Thuhet gjithashtu se "në këtë nahije ka kullota të begatshme sa që kullosnin në to me qindra e me mijëra gjë e gjallë".

Çfarë ndryshimesh u shënuan në jetën fetare, kulturore dhe zakonore, të banorëve të Kalasë Dodës, me myslimanizmin e tyre?

Që kur ka filluar jeta mbi tokë, njerëzimi vendosi rregulla për të jetuar. Ato janë transmetuar nga brezi në brez në formë ndalimesh e lejimesh. Shumë prej këtyre rregullave dhe ligjeve janë shkruar në libra shumë të hershme të kulturës sumerjane dhe janë bërë të detyrueshme për tu zbatuar, kryesisht në popujtë që hynë në një organizim shtetëror më të hershëm. Rregullat Kuranore, në saj të zbatimit të vullnetshëm të tyre, se kjo botë e kjo jetë nuk janë të vetmet, detyronte zbatimin vullnetmirë të tyre.

Njohja me këto rregulla të Islamit dhe detyrimi religjioz për t'i zbatuar ato, gjeti përshtatshmëri dhe pika takimi me proceset e zhvillimit të jetës, të zakoneve e traditave të banorve të Kalasë Dodës, sa duket sikur vetë jeta e këtyre banorëve e gjeti rrugën e Islamit.

Një nga rregullat themelore të Islamit që gjeti një shtrat kulturorë dhe përbashkësi deri në intimitet të jetës së banorëve të Kalasë Dodës ishte Namazi, (lutja islame). Namazi nëpërmjet dy aspiratave: "As lutje pa pastërti dhe As përpjekje shpirtërore pa përpjekje të njëkohshme fizike e shpirtërore", ndërtoi një dimension të ri në organizimin e jetës për banorët e myslimanizuar të këtyre fshatrave.

Namazi Islam, duke mos qenë vetëm lutje por edhe disiplinë, duke e shpallur pastërtinë aspekt besimi; "Zoti i do më shumë ata që janë me shpirtë e trup të pastër", solli dukuri të reja në kulturën e jetesës, veçanërisht të gruas, në krahinën e Kalasë Dodës. Ndërtimi i hamameve dhe pastrimi i detyruar, pesë herë në ditë, para faljes së Namazit, jo vetëm që krijoi një kulturë higjenike të admirueshme, trupore dhe në mjedisin ku jetonte, por higjena, duke mos qenë vetëm dituri por edhe virtyt, solli edhe organizimin e jetës në një nënyrë të re, duke u bë shprehi, kryerja e punëve në kohë të caktuar.

Rregullat islame duke mos synuar të kultivojnë te njeriu cilësi që nuk bazohen në natyrën e tij: "Që bota materiale nuk është mbretëri e djallit dhe trupi nuk është vatër e mëkatit", ishin për një jetë të natyrshme, "Besimtarë, mos ia ndaloni vetes gjërat e bukura dhe të pastërta që j'ua ka lejuar Zoti, por mos e teproni". Pranimi i kënaqësisë së dashurisë, duke e quajtur martesën një kontratë me të cilën lidhet çifti për të qenë ortak në jetë dhe ndalimet e lejesat e përcaktuara në ajetet kuranore, formuan për institucionin e martesës dhe jetën familjare, në këto bashkësi, rregulla që e ngritën në një stad më të qytetëruar organizimin e jetës në familje dhe statusin shoqëror të gruas.

Nga rregullat islame, Zekati "lëmosha e detyruar", gjeti një përshtatshmëri ideale me zakonet e traditat e jetës së banorëve të bashkësive blegtorale të Kalasë Dodës. Shtegëtimi i blegtorisë për dimërim në zonat e ngrohta bregdetare, dhe verës në bjeshkët e Korabit, përbënte një nga aktivitetet jetike më të rëndësishme të banorve të bashkësive blegtorale të Kalasë Dodës, nëpërmjet të cilit sigurohej ekzistenca e dhenve, burimi kryesor i jetesës së tyre. Rrugët dhe veprimet e përbashkëta të blegtorëve e çobanëve dhe përballimi i vështirësive duke ndihmuar njëri-tjetrin, krijuan lidhje tepër të sinqerta dhe të qëndrueshme, të cilat reflektoheshin edhe ndërmjet familjeve të tyre, duke i kthyer në zakone tepër njerëzore e fisnike. Tek këto zakone e tradita tepër të veçanta, veçanërisht të ndihmës ndaj njëri-tjetrit dhe njerëzve në nevojë, që nuk jepej në formë lëmoshe, por si ndihmë për të kaluar fatkeqësinë apo gjendjen e vështirë ekonomike, me myslimanizimin e banorëve të këtyre bashkësive blegtorale, u bë i detyrueshëm, si i pari tatim që i pasuri duhej të paguante ndaj të varfërve. Ashtu si nga lutja u bë i detyrueshëm Namazi, nga lëmosha u bë i detyruar Zekati.

Ndikim të rëndësishëm në lartësimin e vlerave morale e shpirtërore të banorëve të Kalasë Dodës, kanë patur lejimet dhe ndalimet e urdhëruara nga Ajetet kuranore.

Të gjitha lejimet dhe ndalesat e detyruara në ajetet kuranore bazohen në dysinë e natyrës së njeriut, nisur nga fakti se ai s'mund të ekzistojë vetëm si qënie biologjike pa anën shpirtërore të tij. Shpjegimi thjesht, kuptueshëm dhe shkencor i vlerave që do të sjellnin në jetën e njerëzve, lejimet dhe ndalimet që urdhëronin rregullat kuranore, nga imam e shehler të përgatitur, që i kryenin me korrektesë në jetën personale dhe familjet e tyre këto rregulla, krijuan një opinion të fortë dhe detyrues në zbatimin e tyre dhe u arrit që niveli i jetesës tek banorët e kësaj krahine, të arrinte një hop cilësor, që ishte i dukshëm, në krahasim me krahinat për rreth.

Në përfundim mund të themi se islamizimi solli në Kala të Dodës, ndryshime të dukshme në organizimin shoqëror, dhe veçanërisht, në kulturën e jetesës së këtyre banorëve, si dhe në formimin e personalitetit të tyre me vlera më të lartësuara, në fe, moral e qytetari. Këto vlera nuk u shuan edhe pas tronditjeve të mëdha të luftës kundër zakoneve prapanike e paragjykimeve fetare të vitit 1967, ku u shembën teqe e xhamia, por nuk u arrit kurrë, që këta njerëz të largonin nga jeta e tyre vlerat morale dhe ushtrimin e riteve dhe parimet e fesë islame, pasi ato ishin bërë pjesë e pandarë e jetës së tyre.

LITERATURA

1) Përzhita, Luan: Kështjella e Pecës në periudhën e antikitetit të vonë dhe në mesjetë,"Iliria",1,1960.
2) Johann G.von Hahn,"Nëpër viset e Drinit",kapitulli Radomira.,Tiranë,2001.
3) Mazreku,P.Relacion i vitit 1638, në,"Relacione mbi gjendjen në Shqipërinë Veriore dhe të Mesme",II (1635-1650) Tiranë,1965.
4) Hoxha Shefqet,"Kërkime për besimet fetare në Lumë".Tiranë,2005
5) Selami Pulaha,"Krahina e sanxhakut Dukagjinit gjatë Shek.XVI",në "Studime Historike",3,1973.
6) E.Durham,"Brenga e Ballkanit"(Shqipëria e Epërme).Tiranë,1998.
7) Hasan Kaleshi,"Veliki Vezir Sinan Pasa" në "Gjurmime Albanologjike,"nr.2,1965.
8) "Historia e Popullit Shqiptarë" I,Tiranë,2002.
9) Hasan Kaleshi,"Vilajeti i Prizrenit"në,"Përparimi,nr.2,Prishtinë 1967.
10) -Alia Izetbejgoviç, "Islami midis Lindjes e Perendimit", Sarajevë 1990, Kap:Islami dhe jeta.

Bëj pajtimin tënd me

PayPal

përmes emailit

<rrugaearberit@gmail.com>

Një pajtim vjetor kushton:

Në Shqipëri: 600 lekë.

Në Europë: 10 Euro.

Në SHBA dhe vende të tjera: 15 USD.

Pajtimi në Europë dhe SHBA

është vetëm në versionin PDF.

Rruga e Arbërit nr. 122
botime

Ndriçimi dhe shkëlqimi i veprës së klerikut Raif Kadiu, në librin e Arian Kadiut është edhe shprehje e humanizmit dhe e dashurisë për njerëzit, që për ta dhe Atdheun bënë gjithçka që mundën, ashtu si e përçon edhe feja të cilës i përkiste.

Reif Kadiu i Dibrës, fjala dhe vepra e tij vuri "vulën" në jetën e një krahine

Nga **prof. dr. MUHARREM DEZHGIU**

Historia dibrane është shpalosur me mjeshtri nga prof. dr. Arian Kadiu në disa botime të mirëpritura të tij. Në mënyrë të natyrshme, pjesë e kësaj historie kanë qenë jo vetëm traditat atdhetare historike të popullsisë së kësaj treve, por edhe traditat kulturore e shpirtërore familjare, të cilat janë përcjellë ne vazhdimësi nga një brez tek tjetri.

Aktorë të kësaj historie kanë qenë personalitete, të cilët, me veprimtarinë e tyre kanë mbetur në memorien tonë kombëtare. Jeta dhe vepra e tyre është bërë pjesë e pandarë e ngjarjeve dhe proceseve historike. Formimi i gjerë kulturor i atyre personaliteteve dhe me përmasa të dallueshme atdhetare dhe historike, i ka nxjerrë ata në evidencë të vlerave kombëtare.

Një ndër këto personalitete është Reif Kadiu, i shpalosur në librin, me një titull domethënës, "Raif Kadiu i Dibrës", me autor Arian Kadiun.

Ndërmarrja e një studimi monografik për gjyshin e tij nuk ka qenë qëllimi në vetvete i studjuesit. Vendosja e këtij personaliteti të mirënjohur për dibranët, në shtratin historik të kohës, kur jetoi, në kapërcyell të shekujve XIX dhe XX, i ka dhënë mundësinë autorit të jap një kontriibut të vlefshëm në historinë e shqiptarëve.

Raif Kadiu, siç del qartë në monografi, nuk i përket vetëm Dibrës, por ai ishte një personalitet me përmasa që i kalon kufijtë e trevës së vendlindjes.

Është meritë e autorit që me punën hulumtuese në burime arkivale dhe burime të tjera të autorëve të shquar, materiale të shkruara dhe ato gojore, na ka dhënë qartë dhe në mënyrë bindëse jetën dhe veprimtarinë e pasur të Raif Kadiut, si dhe veçanërisht rolin e dukshëm të tij në ngjarjet vendimtare të kohës, të cilat lanë gjurmë në procesin historik të kombit shqiptar.

Personaliteti i Raif Kadiut u ngrit lart dhe u afirmua jo vetëm në veprimtarinë e tij si klerik i fesë së cilës ai i përkiste, por edhe në veprimtarinë e tij atdhetare qysh në moshë të re. Duke iu referuar rolit të institucioneve fetare të kohës në organizimin e ngjarjeve jetike, ku luheshin fatet e Atdheut, autori ka pasqyruar në përmasa reale edhe rolin e Raif Kadiut, në këto ngjarje historike madhore.

Emri dhe vepra e Raif Kadiut, ka lënë gjurmë të thella në ndërgjegjen e dibranëve, të cilët edhe sot i referohen dijeve të tij, si burim mençurie, duke përmendur jo në pak raste, shprehjen: "siç e ka thënë edhe Kadiu i Parë".

Dimensionet e mençurisë dhe atdhetarizmit të Raif Kadiut "zbulohen" hap pas hapi. Guximi i tij i kalonte përmasat e rrethanave të kohës. I tillë ishte guximi i tij për të kundërshtuar pushtimin e vendit nga Italia fashiste, duke iu përgjigjur me ironi kërkesës italiane për të qenë pjesë e delegacionit shqiptar, i cili do t'i dorëzonte kurorën e Skënderbeut, mbretit Viktor Emanueli III.

"Mbreti dhe Duçja juaj e kanë marrë Kurorën e Skënderbeut, që ditën që "na çliruat"- deklaroi ai në sy të autoriteteve italiane të pushtimit. Ai kishte besimin e madh se flamuri kombëtar shqiptar do të valonte edhe në Kosovë e Çamëri, të shkëputura padrejtësisht nga Fuqitë e Mëdha të kohës, të veçuara nga harta e shtetit të pavarur shqiptar.

Mjedisi natyror e shoqëror, ku veproi Raif Kadiu, është Dibra me njerëzit e saj, e pasur, me një botë shprtërore të gjerë. Ndaj janë të shumta dëshmitë vlerësuese të bashkëkombasve për personalitetin e Kadiut. Studjuesi dhe autori –shkrimtar Arian Kadiu, siç e shpreh në libër, me të drejtë është krenar për gjyshin e tij, për personalitetin e tij të gjithanshëm (ai punoi për t'u mësuar fëmijëve shkrim e këndim, se ato për herë të parë uleshin të mësonin, u muarr me zell me shuarjen e gjakmarrjes, sa edhe sot Dibra nuk është rob i këtij zakoni dhe shquhet se nuk ka asnjë familje të ngujuar) duke i dhënë lexuesit shqiptar një zë të denjë në vargun e figurave që kanë zënë vend nderi në Encikopedinë Shqiptare e më gjerë. Në prag të 100-vjetorit të Pavarësisë, Enciklopedia Shqiptare e përgatitur enkas, e përfshiu në faqet e saj, si një figurë e shquar, me dinjitet duke paraqitur edhe botën e tij shumëdimensionale.




Ndriçimi dhe shkëlqimi i veprës së klerikut Raif Kadiu, në librin e Arian Kadiut është edhe shprehje e humanizmit dhe e dashurisë për njerëzit, që për ta dhe Atdheun bënë gjithçka që mundën, ashtu si e përçon edhe feja të cilës i përkiste.

Në vend të një reçence për librin "Një jetë në 36 shkronja

Të dashur profesorët e mij fisnikë
Hatixhe dhe Ismail Erebara,

U gëzova shumë që u takuam në Hotel Tirana pas afro 40 vitesh dhe që jeni mirë me shëndet. Ju jam shumë mirënjohës që ndoqët aktivitetin për Nënë Terezën më 26 Maj. Po kështu, ju falenderoj për librat që më dhuruat.

Gjatë udhëtimit për Londër më 27 Maj isha në shoqërinë e librin tuaj autobiografik "Një jetë në 36 shkronja", që është edhe monografia juaj e parë. E lexova me një frymë, gjë që nuk më ka ndodhur shpesh kohët e fundit. Sa prekëse, sa sublime, sa frymëzuese dhe sa kuptimplote jeta e familjes tuaj dhe veçanërisht dashuria dhe mirëkuptimi juaj për njëri tjetrin në këtë rrëfim të sinqertë prej 178 faqesh.



Hatixhe Erebara, "Një jetë në 36 shkronja", Tirane: M & B, 2011

Në autobiografinë tuaj ju detajoni me realizëm Zolaesk sfidat e fatit, të traditës zakonore dhe veçanërisht të poshtërsive institucionale që u përballuan me stoicizëm dhe fisnikëri nga familja juaj dhe të afërmit tuaj, por veçanërisht nga tre matriarkë – gjyshja juaj, nëna juaj dhe ju – të përshkruar njëkohësisht me liricizëm dhe patos.

Por libri juaj nuk është thjesht një autobiografi. Ky libër plotëson historinë e Dibrës dhe veçanërisht të Peshkopisë që nga fillimi i shekullit të njëzetë. Kjo është një nga arsyjet se përse ky libër duhet të lexohet gjerësisht nga lexues të moshave të ndryshme, veçanërisht në Peshkopi, në këtë vatër qytetarie ku në vitet e diktaturës shpesh të qënit qytetar përbënte një sfidë jo të vogël.

Megjithëse ju njoh dhe respektoj familjarisht që në femijërinë e hershme, u desh të kalonin afro pesë dekada nga momenti kur si mësuesja ime e parë më mësuat ABC-në që tju njoh më nga afër. Dhe kjo në sajë të librit tuaj për të cilin ju jam mirënjohës që e shkruat. Tani ju njoh dhe ju admiroj edhe me shumë jo vetëm ju të dy, një çift kaq simpatik, po edhe Peshkopinë tonë me hallet, mëkatet, fisnikërinë dhe shpresat e saj.

Edhe një herë, ju falenderoj për kënaqësinë e veçantë që ndjeva nga prania juaj në leksionin publik për Nënë Terezën dhe për pesë librat që patët mirësinë të më dhuronit. Çfarëdo që të bëni, mos pushoni së shkruari pasi ju keni dhuntinë për t'i thënë gjërat me një çiltërsi dhe freski që nuk hasen shpesh në letrat shqipe këto ditë.

MENDIME RRETH LIBRIT TË RI TË POETIT HYSNI BUSHI TË TITULLUAR "USHQIMI I SHPIRTIT"

Hysni Bushi, poeti i dhimbjes

Nga **MEVLUD BUCI**

Ky libër e themi që në krye të erës se është pasqyrim i jetës në liri, i dhimbjes dhe krenarisë, i portretizimit të njerëzve të thjeshtë, i lartësimit të virtyteve njerëzore, i familjes, fisit, shoqërisë dhe virtyteve të çmuara të brezave. Autori shkruan në fillim: Më i miri është ai që është më i mirë për familjen e tij! Familja është fillimi dhe mbarimi i atdheut! Në këtë libër kanë dhënë ndihmesën redaktori Zenun Fero si dhe në kompjuter z.Zabit Cuku. Që në hyrje thuhet midis të tjerave nga autori: "Mendova që t'u shërbej njerëzve duke sqaruar se ç'është burri dhe ç'është gruaja? Si të forcojmë familjen që të forcohet kombi mbasi familja është zemra e kombit... familja është: syri, veshi, bukuria, forca dhe truri i një kombi. Atje fillon dhe mbaron atdheu. Libri hapet me poezi të bukura të titulluara "Shkrimtarët", "Vend lavdie", "Telini", "I larguar", "E vogëla", "Një zog", "Atdhetari", "Mbretëresha", "Kol Brana", "Porosia e Babës", "Dritë e pashuar", e plotë të tjera ku poeti shpërfaq një botë të pasur shpirtërore, vlerat e njeriut, rolin e individit në shoqëri, bukurinë e ndjenjave të pastra, nderimin për familjen e mbi të gjitha për atdheun e lirinë.

Autori shkruan: Lavdia e Shqipërisë / Në shekuj shkruar historia / Aleksandrin e Madh / E njeh Europa dhe Azia / Lavdi pati dhe në mesjetë / Ku sundoi ai Skënderbeg / Bëri luftë,luftë të drejtë/ Ishe Strateg, ishe mbret / (Poezia "Vend Lavdie" faqe/7 strofa 3.4)

Ky libër ndryshe nga libri i parë i poetit Bushi të titulluar "Për Mësuesen " ka një tematikë të pasur, vargje plotë frymëzim e ngarkesë emocionale, lartësi të vlerave krahinore e kombëtare, gjetje artistike e figura të spikatura letrare. Autori ngre lartë vlerat e historisë, i pasqyron realisht dhe në mënyrë mjeshtërore nga ana artistike. Ndonëse në disa vargje të duket sikur bie në prozë, në fakt gdhend fakte, ngjarje, portrete, figura, tema dhe gjetje të cilat të mësojnë shumë dhe përmbajnë tone liroko-filozofike. Duke përshkruar Pogradecin e liqenin e Ohrit autori flet edhe për atdhetarin e madh Komandantin trim Kol Brana.

Autori shkruan: Luftëtarët treguan trimëri / Luftojnë për atdhe/Luftojnë për liri /Kol Brana u ka pri / (Poezia "Kol Brana" faqe/20 strofa 4)

Në vargjet e librit "Ushqimi i Shpirtit" autori gdhend me gjuhën e urtësisë e të artit të fjalës atë që të jep jetë e dritë, atë që të bën krenar në breza : "Porosia e Babës"


Besë duhet të kesh/Çdo kujt mos i beso/Para se të flasish/Çdo fjalë e mendo/,

Babai ishte i besës/ I donte besnikët/ Jetoi i nderuar/ Me gjithë fisnikët/ (Poezia "Porosia e Babës" faqe/22 strofa 3.4)

Kur përfundon së lexuari këtë libër kronik të jetës e të fisnikërisë njerëzore të kujtohet thënja e urtë e popullit italian: Kush ka qenë në pranga ja di vlerën lirisë. Ky autor nga qelitë ka gdhendur vargjet e shpirtit, ka përjetësuar qëndresën, dhimbjen, padrejtësitë, dukuritë njerëzore si dhe ka lartësuar vlerat e çmuara të popullit e të brezave. Në poezinë " Dritë e Pashuar " përshkruhet figura e të persekutuarës, qëndrestares Rukie Rama.

Autori shkruan: "Rukie Rama/ E jona heroinë/ Ku flitet Shqip/ Mir është ta njohin/ Rukie Rama/ Kujtohet gjithënji/ Plot vuajtje jeta/ Jeta

(Vijon në faqen 23)



studim

Çidhna është boshti qëndror të rrugëve dhe kuvendeve i Dibrës, Lurës, Matit, Mirditës. Vendi i strategëve, vendlindja e kastriotëve, ndërtuesit dhe mbrojtësit, rimëkëmbësit e kalave në gjithë vendin. Oena kalaja mbrojtëse e fiseve të hershme, qyteti i Çidhnës trungu kryesor në qendër të Dibrës, Matit e Mirditës...

Në kërkim të qyteteve të rrënuara të Ilirisë

Nga **Dr. ISLAM CANI**

Qytetërimet e vjetra evropiane kanë qenë vepër e popullit pellazgo-ilirë, pasi kjo dëshmohet nga të dhënat historike dhe qytetërimi antik. Është detyra jonë ti ruajmë, të shkruajmë dhe ti respektojmë, se kjo është struktura e historisë.

Në historiografi qytetet antike njihen si qytetërime të humbura! Një ndër qytetet e humbura ashtu si shumë të tjerë është ai i Çidhnës me kalatë e saj njëra Oena ose kalaja e maleve të egra dhe tjetra Kithina në hyrje të qytetit. Marr shkak nga një shkrim për qytetet e humbura ilire nga M. Pollozhani, i cili radhit disa prej tyre, por të dhënat studimore që kam grumbulluar në arkiva flasin për 70-100 qytete të shkatërruara të Ilirisë. Sipas M. Shuflaj, aithotë se u rrafshuan mbi 70 qytete të Ilirisë në jug dhe në veri nga luftërat e përgjakshme..... me romakët. (M.Shuflaj, 2009 " Historia e qytete e Ilirisë së Veriut")

Një ndër qytetet e rrënuara nga luftërat e shumta ka qenë dhe Çidhna, shpesh herë është përdorur emërtimi qyteti i Çidhnës e herë Oena, por këtë zgjidhje e tregon qartë harta e vendbanimeve antike të trevës dibrane dhe ajo e rrugës që përshkroi dërgata maqedonase nga Stuberra për në Shkodër. Pas pushtimit të qytetit dhe të kalanës dërgata ndoqi rrugën e shkurtër: Çidhën- Lurë nëpër malet e egra, rrugës për në labeate).

Të shohim se ç'thotë prof. akademiku K. Frashëri i cili citon dhe jep mendim të prerë: Oena e Qidhna e gjemë në hartën e vendbanimeve antike.(K.Frashërit. Historia e Dibrës. 2012 fq. 52). Në hartën e rrugës që ndoqi perseu për në Shkodër (kalimi për Qidhën, kalanë e saj Oenë (K. F. 55). Hartat treguese shpjegojnë se Qidhna si pika kyçe rrugore dhe kalaja strategjike, pika vrojtuese e tre krahinave Dibër, Mat, Mirditë. Nga cilado kala, qytet e qytezë të niseshe, për në Oenë ose kalanë e qytetit do të kalojë nga qyteti i Çidhnës, grykës së Setës, në Sheh të Thatë, shkalla e diellit, qaf kala- kala.

Rruga që shkon nga Çidhna në Lurë, fusha e Pelave, zbret në kalanë e cila njihej si qendër administrative dhe ushtarake. Rruga nga kalaja që shkon në Pllajë, deri në Stellush Mat. Krahas rrugëve këmbësore të dhënat tregojnë dhe rrugë më të gjëra që kalonin me kafshë. Shenjat e rrugëve tregojnë që janë përdorur dhe karroca. Rrugë tjetër nga Çidhna në kala, fusha e pelave, zall Gjoçe, ku ndahet në tre degëzime, njëri shkon në Kthellë-Mirditë, tjetra Kthellë rrugës së labeatëve- Shkodër, tjetra Kthellë –Durrës e Tiranë. Një rrugë tjetër nga Kalaja, dhe nga Çidhna për në Lurë që dalin në rrugën e vjetër të dardanëve që lidhet me Shkodrën, Lezhën, Durrësi etj.

Jeta e banorëve prehistorikë të Kidhnës, kanë lënë gjurmët e tyre në male, në shpella, në kala e vendburime. Njihet kalaja prehistorike e maleve të egra e vendosur në shkallën e diellit qe banorët e emërtuan kalaja e egër ose kalaja Oena. Vetë emri "oena" ka ardhur nga fjala e egër, e ashpër, zhurmuese, për të cilën kanë thënë fjalën e tyre gjuhëtarë, historian e studjues të shumtë. Emërtimi Oena vjen nga fjala e egër oena/e egër, e ashpër. Ja referencat përkatëse për Oenën; (Fjalori E.Latin Shqip.1975.30, 420, 421. Xh. Lloshi 2010258,436 F.Lacaj, Fishta 343; E Çabej, 1982 Studime dhe Etimologjia 69-71), Fjalori Shqip 1954/360.

Kalaja është në pozicionit natyror e gjeografik mes maleve e runjave të egra dhe të shkreta siç i ka cilësuar: Durham, Baroni, Frashëri, Shuflaj etj. Në këto male, shkrepa e pyje ku strehoheshin kafshë dhe shpendë të egër si; pëllumbi (Columbia oena), shqiponja, turtulli, korbi etj. Banorët e lashtë kanë jetuar në këto vendbanime e strehë, ku mbi këto shpella është oena. Kështjella që ndërroi disa pushtues dhe që u ruajt si pikë stretegjike në mbrojtje të Dibrës, Matit, Mirditës. Ky trung malor me grykat e shumta mori emrin oshëtima që do të thotë oenë, zëra, e zhurma , ... pra ushëtima e maleve dhe e egërsisë zhurmuese të rrjedhjes së lumit. Oshëtima komunikuese e grykës së Setës, e shprehur me jehonë e me zë, duke



Foto: **Haki Përnezha**

marrë trajtën e pasthirrmës oee oeee naa ...(ja ku jemi, ne jemi këtu). Të sqaruara përkatësisht nga E. Çabej me "Studime Etimologjike V. I. 1982/70 (onomatopenë, imitime, pas'thirrma) dhe fjala përngjasje "oshëtim". (Fjalori shqip 1985/ 827), I; Cani V. I Çidhna Dje Sot, Nesër, dhe V. II Rrënjët historike të Kastriotëve në Çidhën 2015. Thamë më lart së Çidhna kishte dy kështjella: Qyteti i Çidhnës kishte kështjellën në hyrje, siç njihet Kepi i Qytetit, sipas arkeologut Adem Bunguri, kjo kështjellë njihet kalaja e shek. VI pas Kr, e quajtur "Kithinas", e njohur në mesjetë me emrin "Kidna"(BARLETI 1510 (1964), XII, 469) dhe kalanë Oena (e oshëtimave, e maleve të egra në shkallën e diellit). Theksoj se emri "Kidna:" ka ardhur nga Kidhna prehistorike. Kështjella në kepin e qytetit kishte funksionin e një pike vrojtimi, pritëse për vetë pozicionin që ajo gëzonte. Kjo pikë vrojtimi ishte 25 metra e gjatë dhe 8 metra e gjërë dhe me dy rrethime, me dy pozicione vrojtimi një drejtim të qytetit dhe tjetri rrugës që vinin nga gryka e Setës. Kishte kapacitet mbajtës të forcave ushtarake deri 10-15 veta. Në periudha të hershme njihet "Gjitet", sepse aty ishte hyrja për në Çidhën, ishte pika kyçe rrugore, shrytëzoheshin ujrat për peshkim dhe realizohej shkëmbimi i mallrave. Ndërsa kështjella e malit të diellit (shkalla e diellit) dhe në qoftë se kalohej prita e parë në K. Qytetit pra kështjella Kithina, kalaja Oena nuk lejonte kalimin për në e rrugën e labeatëve. Kjo ishte arsyeja që Perseu shkatërroi qytetin e më pas Oenën.

Kalaja Oena kishte kapacitet të madh njerëzor, ishte vendi sekret, vendi i strategëve, udhëheqësve, zotave, kala mban emrin e maleve të egra. Kalaja njihet nga populli me disa emra si: kalaja e diellit, e maleve të egra, e oshëtimave e Skënderbeut, e Sheut të Thatë. Fjala e Sheut të Thatë do të thotë se; sa herë që sulmohej qyteti popullsia kalonte në mbrojtje në kalanë natyrore të Sheut të Thatë(pra Shehri i thatë).

Për Oenën e Çidhnës antike, Artatusin dhe malet e egra gjatë periudhës së luftrave e masakrave po kaq të egra me maqedonasit dhe romakët e përkatësisht gjatë periudhës së viteve 169-168-167 para erës sonë, kanë shkruar autorë e historianë të ndryshëm vendas dhe të huaj. Një pjesë e tyre janë: T. Livi, Polibi, E. Durham, P. Budi, E. Jacques, N. Bozbora, Oliver J. Ch, Gj. Ndoj, K, Frashëri, Xh. Lloshi etj. Në respekt të akademikut Frashëri referuar burimeve të Tit Livit për Oene-në, (H. Dibrës, fq.52, 53) kemi katër argumente të tij që e "lokalizojnë" kalanë e famshme pikërisht në Qidhën/Çidhën. Ato janë:

1. Oene-ja, kalaja e Çidhnës ka pozitë të mirë nga pikëpamja strategjike e ushtarake, kala e fortifikuar natyrore.
2. Nëpër qytetin e Çidhnës, kalonte Udha për tek Labeatët: ishte pika e domosdoshme dhe e siguruar nga katër malet e Çidhnës që të çon në kryeqendrën e mbretërisë Ilire në Shkodër.
3. Oene-ja, e Çidhna mbrohej nga njëra anë nga lumi Artatus (Seta);
4. Oene-ja, e Çidhna mbrohej nga njëra anë nga një mal shumë i lartë Pleshaj ose faqja rrëpirë e Ponereve e Pllaju.

Rruga që lidhte trevën dibrane me viset e labetarëve kalonte në grykën e Artatusit (Setës). Pika e burimit të Artatusit është Biza që rrugëton në mes të maleve të Lurës, Matit, Mirditë dhe zbret në Xhaxhenj. Nëpërmjet rrjedhës që kalon nga mali i Arthit nga njëra anë dhe faqa e malit të Njetit. Mali i Njetit nuk është gje tjetër por faqa e malit të shkallës së diellit ku është vendosur kalaja. Në vazhdim te mali i Diellit (shakalla e diellit) e quajtur nga banorët e asokohe "perëndia ilire", "babazoti".

Rrjedhja vazhdon drejt malit të Xhaxhenjve e njohur me emrin antic "Jarra" ku banonin fiset e ilire të vjetra "Jarrë", fisi Guri që sot është Gurë –Lura, Rrënza dhe "Arti". Pra ajo që quhet artatus sot ka bazën nga këto fise të hershme dhe bashkë me liqenin e lashtësisë prehistorike. Për këtë pamje magjike të Çidhnës së rrethuar me ujra e male disa shkrimtarë e studjues e kanë emërtuat oazë, unazë, ishull në mes maleve të egra. (Oliver Jchmid.2007/ për Çidhnën 34-36). Artatusi është fjala më e vjetër dhe autoktone si vetë ujrat, tokat dhe banorët prehistorikë të kësaj zone. Artatusi është emërtim burimi me prejardhje nga gjuha ilire ose shqipja e moçme. (P.Imami. Bot.2011, fq.79). Emërtimi vjen me bazë toponimike vendore nga mali i Arthit. Fjala "Artat" në kodin e gjuhës pellazgo-Shqipe vjen në këtë formë: ar=diell, i ndritshëm, ar /ara;. pjesa e fjalës "tat"=At, baba, zoti. (Kodi Pellazgo-Ilir M. Abazaj, 2011/48). Lumi që furnizonte qytetin dhe banorët e saj me peshkun e troftës. Në në periudhën e fundit të shek. I. para Krishtit njihet "Seta". Kuptimi gjuhësor vjen në trajtën i ngushtë i rrëmbyeshëm. Ndërsa në pamjen vizuale na jep figurën e "sigmës", pra paraqitja e rrjedhjes së Artatus si gjarpërushe dhe formon sigmën, arterie. (Enciklopedia Latine 1975, 30,420-421). Tregues tjetër arkeologjik i Oenës së Çidhnës janë objektet e gjetura, sopata e bronxit, thesari, enë të ndryshme, vegla pune dhe stoli të shumta. E rëndësishme është gjetja e monedhës në kalanë e Çidhnës (Oena) me mbishkrimin "Aneni". E cila tregon prerjen e monedhës në atë periudhë të zhvillimit të qytetit dhe shkëmbimin tregtar me kryeqendrën e Ilirisë, me qytete e qyteza të shumta. Kalaja e qytetit (Oenës) ishte vendimtare për suksesin dhe për pushtimin e qytetit nga mbreti maqedonas.

Nisur nga fakti i luftrave, Perseu pasi mori Uskanën ju drejtua qytetit të Çidhnës. Ku gjeti një rezistencë të madhe, atëherë bëri një pushim dhe shumfishoi forcat ushtarake. Perseu u ndikua një një person i zënë rob, i cili në momemtet e fundit të jetës ju kish thënë se: "Ju e morët Uskanën, por e pamundur është marrja e qytetit të Çidhnës, sepse mbrohet nga kalaja, katër malet e Çidhnës dhe dy shtigje; njëri te kështjella Kithina dhe tjetri në Gjalicë që mbrohej nga kalaja Oena. Vendasi i shitur orientoi Perseun për të rrethuar qytetin në tre drejtime:

1. Një goditje nga K. Qytetit (Kithina)
2. Rrethimi i dytë nga që vinte nga qyteza e Draj Reçit, rrjedhja e Mallës e Lurë duke i dalë kalasë nga pjesa e prapme dhe e sipërme, por Gurë Lura (Boria Lura) nuk la të kalojnë dhe pse humbi forca të shumta.
3. Rrethimi i tretë që doli në anë jugore do realizohej, nga maja e Vangut, rrafshja e Topit në pjesën e Ponereve.

Forcat që pushtuan qytetin e Çidhnës, kryen masakra, vrasje, djegie, shitje të banorëve jashtë trevës Dibrane. Forcat që morën qytetin, ai i drejtoi për në Oenë, Sheh Të Thatë, malit të shkallës së Diellit për në kala.

Perseu urdhëro që gjitha forcat ushtarake do të mbushin thasët me rërë e dhe, në Sheh të Thatë, ti ngjiteshin malit të diellit me drejtimin e kalasë, duke u ngjitur e krijuar taraca për hyrë në kalanë egër. Do ti lutesha Pollozhanit të lexojë K. F që shpjegon hollësisht taracat dhe malet e pakalueshme Pleshaj(Ponere) në V. Historia e Dibrës 2012.

Perseu dobësisht e fitoi rrugën për në labeate. Duke realizuar kështu misionin e tij, arritjen për në Shkodër. Kështu pas pushtimit dhe masakrave nga ushtria maqedonase, luftës iliro-romake në vitin 169- 168 -167 e gjithë dibra dhe ilira ra në duart e pushtuesëve. Pas pushtimit të Ilirisë qyteti ynë lëngoi po nuk u shua...qyteti u pushtua 5 herë ku goditjen e fortë e mori nga luftrat iliro- maqedone. Më pas nga pushtimi romak, sulmet e fiseve barbare, pushtuesit sllav, bullgar e serb deri ne pushtimin osman. Ky i fundit rrënoi, dogji e shkatërroi çdo gjë mbi sipërfaqen e tokës dhe gurët i bëri shkrum e hi për të zhdukur jo vetëm njerëzimin por çdo monument historic e kulturor, sepse ishte pikërisht këtu rrënjësia e Kastriotëve.(Oliver J.Schmitt Arbëria venedike. bot; 2007 f.557 – 559)

Çidhna është boshti qëndror të rrugëve dhe kuvendeve i Dibrës, Lurës, Matit, Mirditës. Vendi i strategëve, vendlindja e kastriotëve, ndërtuesit dhe mbrojtësit, rimëkëmbësit e kalave në gjithë vendin. Oena kalaja mbrojtëse e fiseve të hershme, qyteti i Çidhnës trungu kryesor në qendër të Dibrës, Matit –Mirditës, lidhja rrugore për në Dardani, Labeatë, Shkup. Respekt ndaj kërkuesve, të individëve që shkruajnë, që tregojnë për qytetin antic, që kur iku akulli dhe u zbuluan malet. Natyra bujare ju lëshoi troje dhe ju dha jetë, begati e fisnikëri!

Dëshironi të **BOTONI PAK KOPJE LIBRI**, por nuk mundeni sepse shtypshkronjat ju kërkojnë të paguani për një tirazh të madh... Tani nuk është nevoja të prisni...

JU OFROJMË BOTIME NGA 1 KOPJE E VETME!

Njëlloj si në shtypshkronjë...

Çmime të favorshme dhe shpejtësi!

Telefono: **068 65 08 441** ose shkruaj email: **mbbotime@gmail.com**

Rruga e Arbërit nr. 122
krijimtari

TREGIM I JETUAR / MËSIMI I NJË PLAKU TË PASHKOLLUAR

Mazi ka nevojë për fre...

Nga **AHMET KAMBERI**

Ishin fillimvitet '60 të shekullit të kaluar. Në spitalin e Peshkopisë kishte gjashtë mjekë. Vetëm në dy qendra të tjera të rrethit kishte spital rural, me një mjek ose ndihmësmjek: në Bulqizë dhe Shupenzë. Në zonat e tjera kishte ambulancë në qendër. Aty-këtu edhe në ndonjë fshat të largët. Komunikacioni ishte i vështirë. Kishte shumë pak mjete që lëviznin. Për të sëmurët rëndë që mendohej se ishin për spital, infermieri ose ndokush nga autoritetet lokale kërkonte autoambulancën e spitalit, e cila u dërgohej menjëherë. Por kur fshati ishte larg rrugës së makinës, të sëmurin duhej ta zbrisnin me vig deri aty. Shumë të sëmurë mjaftoheshin me ndihmën mjekësore të infermierit. Të tjerë u drejtoheshin hoxhallarëve, të cilët shkruanin ca zhgarravina, gjasme arabisht, në një rrip të ngushtë letre, të cilën e mbështillnin me një cope pëlhure në formë trekëndëshi. I sëmuri e varte atë në qafë ose e qepte në rrobat e trupit dhe priste shërimin. Tek-tuk, kishte edhe ndonjë shërues popullor, që përpiqej t'i shëronte të sëmurët me barna natyrore, kryesisht lule ose fara lulesh, ose të mjekonte frakturat e vogla me imobilizim me jaki.

Në këto rrethana seksioni i shëndetësisë i rrethit programonte që një ekip mjekësor, i përbërë nga një mjek i spitalit të Peshkopisë, një farmacist i qytetit dhe një mami e materniteti të qytetit, të shkonte herë-pas here për 1 deri 5 ditë në zonat e largëta. Mjeku vizitonte të gjithë të sëmurët, të mëdhej e të vegjël; mamia vizitonte grate shtatzana ose që kishin probleme. Mjekimet u jepeshin në vend nga farmacisti. Barra u binte më shumë patologut, infeksionistit dhe ftiziatrit, pasi kirurgu dhe pediatri nuk mund të largoheshin asnjë ditë nga spitali. Kjo ishte gjetur si zgjidhja më e mirë e mundshme në atë kohë për shtrirjen e kujdesit mjekësor në zonat larg qendrës së rrethit. Ekipit mjekësor i binte të njihej me njerëzit e zonave të ndryshme, me zakonet, kushtet e vështirësitë e jetesës, si edhe me mendësitëe me mençurinë e tyre.

Në një ditë të bukur maji, doktor Agimi me farmacistin dhe maminë, që përbënin ekipin mjekësor, u përcoll me autoambulancën e vjetër të spitalit deri në katundin Arras. Aty ata zbritën. I priti infermieri i Mustafajt, me një mushkë për bartjen e arkave me barna. Pa e zgjatur, u nisën përmes rrugës së fortë malore për në zemër të fshatit ku ndodhej një ambulancë e vogël. Aty ishin mbledhur burra, gra e fëmijë, të cilët ishin në dijeni për ardhjen e ekipit mjekësor dhe donin të vizitoheshin. Kishte edhe një grusht fëmijësh kureshtar që hidheshin e përdridheshin si keca lozonjarë.

Pasi kishin punuar deri pasdite vonë në ambulancën e fshatit, infermieri u kishte thenë doktor Agimit, me farmacistin dhe maminë që e shoqëronin se do t'i çonte për të bujtur te Xheladin Coli. Kur ekipi mbrrini në oborrin e Colit, infermieri thirri:

-O, Xheladin Coli! A don miq?

-Urdhnoni,- u përgjigj nga brenda një zë i mpreftë, -bukë e kraipë, për miq, ka sa të duesh shpaia e Colit.

Mustafaj është një fshat i Çidhnës që shtrihet përsëgjati shpatit të malit si një tablo e skalitur. Kulla e vogël e Colit sikur i vinte majën atij. Në katin e dytë me dy dhoma, njëra prej të cilave shërbente si odë miqsh, kishte një oxhak në faqen juglindore. Anash oxhakut kishte dy dritare të vogla, prej të cilave përshfaqej një pamje e mrekullueshme e luginës së Drinit dhe e maleve përballë që nga Kalisi i Kukësit, Korabi e deri në Deshat, me gjithë fshatrat që shtriheshin shpateve të tyre si rruaza. Oç'bukuri të shohin sytë në të dalë të majit nga ato dy dritare të vogla! Një visore e tillë të mbush me fuqi në mëngjes kur ngrihesh dhe të zbut, në buzëmbrëmje, rraskapitjen nga rropatja stërmunduese e ditës. Kjo mund të ketë qenë edhe arsyeja që ata banorë janë ngulur prej kushedi se kur n'atë shpat mali, me ngastra të vogla toke të punueshme, gjithsesi të pamjaftueshme për t'i ushqyer ata.

Xheladini i priti ata në krye të shkallëve prej dërrase. Ishte një burrë jo shumë i gjatë, i thatë dhe krenar. Në dy gropa të thella në ballin e tij me rrudha, dy sy të qeshur që xixëllonin dhe poshtë hundës së tij të mprehtë, një palë mustaqe me ndonjë thinjë aty-këtu, të jepnin përshtypjen e një bashkëbiseduesi interesant.

Infermieri i paraqiti të tre të ardhurit, duke përmendur edhe ç'punë bënte secili. Xheladini i përshëndeti ata me shtrëngim të duarve dhe i ftoi të hynin brenda në dhomën me oxhak, të lyer me gëlqere prej kohësh dhe me dysheme të mbuluar me një cergë të madhe. Në dy anët e oxhakut kishte nga një shilte të vogël dhe jastëk për t'u mbështetur. Më poshtë, në të dyja anët kishte edhe nga një postiqe (lëkurë deleje). Ekipsat zbathën këpucët që përjashta dhomës dhe hynë brenda. Xheladini e drejtoi doktor Agimin të ulej në qoshen e miqve e poshtë tij farmacistin. Mori postiqen që ishte në anën tjetër të oxhakut dhe e shtroi në anë të farmacistit, për të ulur maminë. Pastaj u ul edhe vetë në qoshen e tij, duke marrë në anën e vet infermierin e fshatit. Pasi i pyeti njërin pas tjetrit për shëndetin e për familjet e tyre, Xheladini iu kthye doktor Agimit:

-Kha t'kemi tai, or doktorr?

-Këtej – ia ktheu doktori, nga Dibra jam edhe unë. Dhe i tregoi fshatin nga vinte.

-Po si ia kaluet sot, a u lodhët? -pyeti Xheladini.

-U lodhëm pak, tha doktori, se kishte shumë fëmijë të sëmurë dhe nënat nuk dinin si t'i tregonin shqetësimet e tyre. Po për fat të mirë, koha qe e bukur dhe nuk u mërzitën shumë duke pritur përjashta. Më erdhi keq sidomos për disa të moshuar që ndenjën gjatë ulur për toke. Njërin prej tyre dhe nja dy fëmijë do t'i marrim nesër me vete, se kishin nevojë për mjekim në spital.

-Mair, e paski ba or doktorr qi keni ardhë, se si e patë vetë, kena nevojë. Këtë infermierin tonë - doktorr i thomi na – boll të mair e kena, po sa e ka takatin i shkreti. Ene na, presim sa t'na vije ke gurmazi i faitit e masanajt' kërkojmë doktorr. Po ene të vish deri n'Peshkopi n'kamë për pak gjâ, ene kjo s'âsht e kollajshme or doktorr. Po, falna nerës, kur kena pasë nevojë e i kena kërkue spitalit maqinën, na e ka çue.

Pastaj, muhabeti u soll rreth vështirësive të jetesës dhe punëve në fshat. Doktori foli gjatë për higjienën, për gropat e zeza (septike), të cilat mungonin në fshat, si edhe për domosdoshmërinë e nxjerrjes së bagëtive jashtë banesës. Ai i lidhi këto me zhvillimin e shëndetit dhe me mënjanimin e sëmundjeve. Përmendi edhe disa raste të shpërthimit të tifos së zorrëve që kishin ndodhur kohët e fundit në zonën aty për rreth. Pastaj, muhabeti kaloi edhe në politikë. Në këtë fushë, si shumë të rinj të kohës, edhe doktori kujtonte se ishte kompetent. Nuk i pushoi goja së foluri për zhvillimet e fundit politike, për shkaqet e prishjes me Bashkimin Sovjetik e për marrëdhëniet e reja me Kinën e Mao Ce Dunit, duke e ilustruar fjalosjen e vet edhe me shembuj nga leximet e tij të shumta. Xheladini dëgjonte me vëmendje. Nuk ndërhynte. Vinte buzën në gaz nganjëherë; nganjëherë tundte kokën. E merrte fjalën rrallë, pasi doktori të kishte mbaruar një argument, sa për të bërë ndonjë pyetje, për të tentuar t'i jepte bisedës një drejtim tjetër, për të lavdëruar vetveten – kur gjente rastin - ose për të nxitur edhe të tjerët të mernin pjesë. Muhabeti vazhdoi gjatë. Doktorit po i pëlqente vetvetja, duke shpalosur dijet e tij, por kishte ardhur koha për të shtruar darkën.

Në një çast, kur doktori ndaloi pak për të kërkuar ndonjë argument tjetër, Xheladini ndërhyri:

-A e di or doktorr? Kishte njani nji maz këtu. Shumë i mair ishte. I pashëm, si ai. I shpejtë, sa gurët shtajshin xixa kur mairrte hov. S'kishte kalë t'ia dilte. Mairpo, s'ishte e mundun të punojshe me tâ. Si t'ia boj, si t'ia boj, thoshte me vete i zoti. Ta shaiste, s'ishte punë qi bahej. Ta mante ashtu, prapë ishte e zorshme. Hall i madh! Ene ia qau nji maiku të vet hallin. "Po pse mërzitesh o burrë – i tha maiku. Veni nji fre të mairë ene ke për të pa sa shpejt do të zbutet e të bahet si s'ke ku ta gjejsh". Ene ai ashtu bani, ne kshilla e majkut i duel e vërtetë.

-Ç'ma kujtove mair or mixha Xheladin, ia priti infermieri, i cili ishte vendës. Ene unë kam nji maz si puna e atai qi na dëfteve tai. Them t'ia boj ene unë ashtu atai temit.

Doktor Agimi ishte naiv, por jo aq sa për të mos e kuptuar se ky muhabet po rrotullohej rreth tij. U mendua pak dhe duke vënë buzën në gaz, tha:

-Edhe unë tamam ashtu do t'ia kisha bërë atij mazit, derisa të mësonte se kuajt e vjetër kanë qenë edhe ata njëherë maza".

-Heu, të pastë Coli, or doktorr- ia bëri Xheladini, duke lëvizur në vend. Për këtë besë, ia ke mush menen Colit sande, dhe bëri shenjë të shtrohej sofra. Hëngrën në një sahan të madh bakri të kallaisur, të vendosur në mes të sofrës. Doktori, hëngri duke futur lugën e alumintë në të njëjtin sahan pa bëzâ.

Pas darke, u shtruan për të fjetur. Doktorit dhe farmacistit i shtruan nga një dyshek me pambuk e jorgan pambuku, që prodhoheshin nga ndërmarrja e artizanatit në Peshkopi. Në anën tjetër u shtrua për Xheladinin. Maminë e morën gratë, kurse infermieri shkoi në shtëpi të vet. Doktor Agimi fjeti keq atë natë. Truri i tij bluajti shumë. E zuri gjumi kur erdhi në përfundimin se freri ishte një mjet i domosdoshëm për të mos prashitur n'mal e n'zallë dhe se mençurinë nuk e gjen vetëm në libra, por edhe te njerëz të thjeshtë.

Të nesërmen, para se të ndaheshin duke u përqafuar me Xheladinin, në oborrin e tij të ngushtë, doktor Agimi i a nguli edhe një herë sytë luginës së Drinit dhe shpat-maleve rreth e rrotull, për ta ngulitur në kujtesën e tij atë pamje të mahnitshme maji, së bashku me natën që bujti në kullën e thjeshtë të Colit.

15 qershor 2016

POEZI NGA IRA BRUCI



MALLË

Krijuesit dibranë këtë vit vijnë jo vetëm më cilësorë, por dhe me risi dhe prurjet artistike në të gjitha gjinitë. Pas Panairit të librit në Peshkopi pati krijues të rinj që jo vetëm me cikle poezish, por dhe me vëllimet e para të botuara, u pritën mirë nga lexuesit. Një nga të cilat është dhe krijuesja Ira Bruçi, që sapo ka mbaruar studimet e larta dhe po pret të dalë nga botimi vëllimi i parë me poezi.

Ajo vjen me një poezi të shkruar bukur e me frymëzim, trajtimi artistik me ndjenjë të temave të ditës, aktualitetit të sotëm, plagës së kurbetit etj. Poezia e saj ka brenda saj ngjyrat e ylberit por herë-herë dhe një gri, si tufa resh nëpër rreshtat e poezisë.

Duke i uruar sukses, mendoj se poezia e saj ka tematikën dhe frymëzimin që lexuesi të ndjejë shijen e mirë të leximit.

Ilmi Dervishi

KJO NATË

Dhe kjo natë me shqyen shpirtin,
Ashtu si shiu që me sjell mall.
Unë brishtësia. Arsyeja më e shurdhët.
Në një cep atje gërmoj, të gjej ndonjë fjalë...

Kërkoj mes errësirës, shiut, melankolisë,
Iluzionet e humbura në konturet e trupit,
Ndenjen e injektuar mbi eshtrat e rrahjes,
Dashurinë e humbur në hapësirën e turbullt.

Ndjehem robinë e vetvetes,
Skllave e bindur e dashurisë.
Qëndroj e përhumbur në botën që ndërtova.
E burgosur në burgun e vetëgjyqësisë.

HËNA

Sonte dhe hëna u bë bashkë me yjet,
E humba në shkëlqimin e tyre..
Doja ta gdhendja të provoja
Atje, tek varej pafund gjithësia.

Mijëra mendime imagjinare,
Ngritur nga pasioni që kam për natën
Fryma e preferencës spikati në sy
Yjet dhe hënën, në botën e madhe..!!

MALL

Loti ndrin në sytë e nënës ,
E lumturia është shuar.
Kur të përcolli, vëlla i dashur,
Rrugëve të kurbetit kur ke emigruar.

Ikja jote është kthyer në dhimbje,
E malli për ty e ka tretur.
Sheh teksa vitet ikin
E lotët lum i rrjedhin.

U bënë vite që s'të ka pranë
Në vend të lotëve pikon gjak
Zemër nëne i thonë
Zemra saj pret të shoh prap..!

portret

Xhelal Roçi, njeriu që nuk e lodhi kurrë jeta

Nga **DESTAN RAMA**



Mora shkas për ta bërë këtë shkrim nga vizita që bëra atë ditë të shënuar të 23 majit në qytetin e bukur të blirëve, Peshkopi, në familjen e shokut dhe mikut tim të nderuar z.Xhelal Roçi.

Aty gjeta me të vërtetë një familje të mrekullueshme; mikëpritëse, bujare dhe shumë dashamirëse. Xhelali me doli përpara tek pragu i derës dhe krahëhapur, ashtu siç bën shqiponja kur bëhet gati për fluturim, me shtrëngoi fort me përzemërsi dhe më uroi mirësëardhjen.

Adivija, e shoqja, na bëri kafen ashtu siç dinë ta bëjnë andej nga Dibra dhe na e vuri mbi tavolinë. Mbi filxhane dredhonin avujt, si të ishin valët e Drinit dhe e shpërndanin nëpër dhomë aromën relaksuese të kafes.

Krahas gjithë asaj rregullsie, pastërtie e sistemimi të gjithçkaje, në dhomë të binte në sy biblioteka e vendosur në vendin e duhur, në faqen e murit lindor të dhomës. Ajo ishte e mbushur plot me libra të gjinive të ndryshme letrare: romane, novela, libra me tregime të ndryshme, me poezi, monografi, ditarë të ndryshëm , koleksione gazetash dhe revistash, libra për sekte të ndryshme fetare etj.

Biseda me Xhelalin u ndez ashtu siç ndizet ajo ne mes dy shokësh a dy miqsh, e këndshme dhe tepër dashamirëse. E shikon këtë bibliotekën këtu, - thotë Xhelali, -këtë e kam që kur isha nxënës në fillore.

Ato pak lekë që më jepnin prindërit në atë kohë për të blerë sheqerna, unë i kurseja dhe i bleja libra. Kështu në vite u bë kjo që shikon sot. Mua më duket sikur edhe libri ka lindur bashkë me mua. Nga viti në vit e kam pasuruar bibliotekën me librin e ri. E kemi për zemër librin ne si familje. Libri për ne është ushqim i dytë. E ndërkohë bashkohet me ne në bisedë edhe Adivija. Ajo flet për kujdesin që tregon për bibliotekën, për librin, pastrimin, sistemimin dhe mirëmbajtjen e saj, njëkohësisht edhe vetë është një lexuese e rregullt e librit.

Xhelal Roçi u lind në fshatin Sofraçan të krahinës së Zerqanit, në një familje atdhetare. Shkollën fillore e mbaroi në vendlindje, ndërsa atë 7-vjeçare në Shupenzë.

Në vitet 1957 – 1962 punoi llogaritar arkëtarë në ndërmarrjen e grumbullimit Shupenzë. Nga viti 1962 deri më 1965 kreu shkollën e Bashkuar të Oficerëve të Ministrisë të Punëve të Brendshme në Tiranë, me rezultate shumë të mira.

Në periudhën gusht 1965- 1992 punoi oficer i Sigurimit të Shtetit, kryesisht në rrethin e Dibrës dhe ka kryer detyra të ndryshme. Gjatë kësaj kohe, pa u shkëputur nga puna, ka dhënë provime plotësuese dhe mbaroi kështu arsimin e lartë në degën përkatëse. Por arsimimi i tij nuk merr fund këtu. I shtyrë nga etja për dije bën që në vitin 1976 ai të mbarojë edhe Institutin e Lartë Pedagogjik Shkodër në degën Histori-Gjeografi dhe u diplomua mësues i Histori-Gjeografisë.

Gjatë viteve të punës së tij si oficer i Sigurimit të Shtetit, Xhelali u vlerësua si kuadër me moral të lartë, korrekt në detyrë, i thellë në mendime, i zgjuar dhe i vendosur në zgjidhjen e situatave të ndërlikuara dhe me kompetencë, i përpiktë në zbatimin e ligjit, gjithmonë i dashur dhe i sinqertë me masën e popullit.

Pasi e kreu me sukses misionin e tij si oficer i Sigurimit të Shtetit në vitin 1997 Xhelali nisi rrugën e bukur të mësuesisë, emërohet mësues i Histori-Gjeografisë në shkollën 8 – vjeçare Katund i Ri, Luzni dhe një vit më pas në Shkollën e Mesme "Gjergj Kastrioti" , Kastriot të Dibrës dhe në vazhdim shkollën e mesme Pedagogjike Peshkopi.

Pasi doli në pension punoi në shkollat 8-vjeçare "Demir Gashi" Peshkopi dhe Dovalan. Xhelalit i pëlqente shumë profesioni i mësuesit e veçanërisht aii mësuesit të Histori-Gjeografisë. Gjithmonë i dashur me nxënësit, i afrueshëm me ta, korrekt në shpjegimin dhe argumentimin e fakteve historike, saktësi dhe precizion në vendodhjen e fakteve të ndryshme gjeografike.

Por Xhelali ishte i palodhur edhe në veprimtaritë shoqërore. Ishte i pranishëm shpesh herë në odat dibrane. Aty ai ndiqte me vëmendje bisedat dhe dialogët e burrave. Alegoritë dhe metaforat e thella që përdoreshin aty, i shërbyen atij për thellimin e arsyetimit e të gjykimit dhe dhënien udhë problemeve që i dilnin përpara në jetë. Po ashtu u tregua i palodhur dhe i kujdesshëm në mbledhjen dhe studimin e pasurive gjuhësore historike e folklorike të rrethit.

Shumë fletë i mbushi ai me fjalë të urta, gojëdhëna, toponime, legjenda, anekdota, thënie të ndryshme popullore dibrane, tregime historike, këngë historike, gjëegjëza etj.

Gjatë gjithë viteve të punës së tij, por edhe tani në pension Xhelali, nuk u lodh kurrë në fushën e krijimtarisë. Me shkrimet e botuara në disa organe të shtypit të kohës ia ngriti lart vlerat vetes dhe e radhiti atë në radhët e studiuesve dhe hulumtuesve të rrethit për probleme a ngjarje të ndryshme historike, apo të tjera që ceknin shoqërinë e kohës. Kështu ai botoi disa shkrime në gazetat: "Ushtima e Maleve" , "Luftëtari" , "Në shërbim të Popullit" , "Zëri i Popullit" , "Bashkimi", në revistat "Ylli", "Nëntori" dhe pas përmbysjes së diktaturës në organet e shtypit brenda dhe jashtë vendit, si : "Kushtrim Brezash", "Rruga e Arbërit", "Magazina Familjare e Shkupit". Këto shkrime kanë qenë monografi për persona që kanë bërë emër në histori, për Teqen Bektashiane të Bllacës, për dëshmorët e luftës, për bazat e luftës, reportazhe, ese, portrete, tregime etj.

Ka botuar librin "Mision i Posaçëm" (kujtime për Zenel Shehun), i cili është mirëpritur nga masa e madhe e lexuesve. Ka faqosur dhe bërë gati për botim librin "Prova e besës" dhe "Flaka", kushtuar Heroinës së popullit Hibe Palikuqi. Ka përgatitur monografi për Faik Shehun e Peshkopisë, si edhe libra me karakter historik për organet e zbulimit dhe të kundrazbulimit gjatë kohës së Zogut, gjatë Luftës Antifashiste Nacional-Çlirimtare dhe lufta me bandat dhe mbeturinat e reaksionit, një libër me tregime, kujtime për familjen si edhe disa materiale që janë të vlefshme për historinë e Dibrës. Ka në përfundim "Monografi për vendlindjen - Sofraqan". Për arsye pune Xhelali me 1983-1984 shërbeu si oficer i sigurimit të shtetit në rrethin e Mirditës. Atje ka shkruar dhe bërë gati për botim ditarin: "Me detyrë në Mirditë".

Ka botuar librin "Mision i Posaçëm" (kujtime për Zenel Shehun), i cili është mirëpritur nga masa e madhe e lexuesve. Ka faqosur dhe bërë gati për botim librin "Prova e besës" dhe "Flaka", kushtuar Heroinës së popullit Hibe Palikuqi. Ka përgatitur monografi për Faik Shehun e Peshkopisë, si edhe libra me karakter historik për organet e zbulimit dhe të kundrazbulimit gjatë kohës së Zogut, gjatë Luftës Antifashiste Nacional-Çlirimtare dhe lufta me bandat dhe mbeturinat e reaksionit, një libër me tregime, kujtime për familjen si edhe disa materiale që janë të vlefshme për historinë e Dibrës. Ka në përfundim "Monografi për vendlindjen - Sofraqan". Për arsye pune Xhelali me 1983-1984 shërbeu si oficer i sigurimit të shtetit në rrethin e Mirditës. Atje ka shkruar dhe bërë gati për botim ditarin: "Me detyrë në Mirditë".

Xhelali ka mbajtur për disa vite Postin e Sekretatit të Komitetit të Veteranëve të Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare. Në mbledhje të ndryshme që ka zhvilluar ky komitet, ai ka mbajtur aty kumtesa, referate, ka shkruar informacione, portrete për lufën, të cilët janë botuar kryesisht në gazetën "Kushtrim Brezash". Ka marrë pjesë në veprimtari të përbashkëta me "Lidhjen e Luftëtarëve të Dibrës së Madhe". Në takime a seminare të përbashkëta që janë organizuar, Xhelali ka treguar vlerat e tij si historian i kohës.

Tek Xhelali gjeta edhe modelin e familjes shembullore qytetare, ku aty ndriste shembulli i tij si kryefamiljar, si baba i mrekullueshëm, si bashkëshort i devotshëm dhe edukator i pazëvendësueshëm. Ai është babai i pesë djemve të cilët i ka edukuar me një personalitet dhe karakter të fortë, me cilësitë e vetëdisiplinimit, tolerancës dhe ndjenjën e përgjegjësisë.

Të shkruash për Xhelal Roçin ndjehesh i kënaqur dhe krenar, por mbetesh disi i pishmanosur në vetvete, mbase vetëm me këto rreshta nuk e ke plotësuar tamam portretin e tij, pasi ka edhe shumë e më shumë...

Hysni Bushi, poeti i dhimbjes

(Vijon nga faqja 20)

e saj në rini"/ (Poezia "Dritë e Pashuar" faqe/23 strofa1.2)

Autori përshkruan bukur Dhimitër Mishën nga Tushemishti mësues qëndrestar e atdhetar, i cili prehet në Vërdovë. Në vargje përjetësohet mësuesi të cilët autori i quan sinan : " Lavdi o mësues/ Gjithnji për ty/ Ti na jep diturinë/Që s'ta jep njeri.../ (Poezia "Sinan" faqe, 29-30 strofa 7)

Në shumë poezi si psh."Libri","Shteti", "Alarm", " Armiku", "Tha", "Kënga Ime", autori ngre lartë vlerat njerëzore, jep mesazhe diturie e dashurie, këngë përmalli për atdhe, për nënën për të dashurën, për jetën e shoqërinë, për traditat. Vjen si krye mesazh e hymn, vjen si thirrje njerëzore ku me të drejtë autori e titullon librin : " Ushqim i Shpirtit"

Duajeni Atdheun/ Që fillon në familje/Duajeni njëri-tjetrin/ Duajeni pa hile/Kënga ime për ju/ Ushqimi i shpirtit/ Mirë me e këndu/ Këngëtarët e Kombit/ (Poezia "Kënga Ime", faqe 39-40, strofa 8,9)

Te ky libër çdo lexues, intelektual, gjuhëtar, sociolog, psikolog, mësimdhënës apo drejtues arsimi do të zbulojë psikologjinë njerëzore, virtytet, veset, vlerat, portretizimin e figurave, dhimbjen njerëzore, rëndësinë e vlerave të njeriut në shoqëri. Në poezinë "Çift pa fat" poeti Hysni Bushi shpërfaq vlerat e rralla të dashurisë njerëzore. Lexuesi po të vështrojë me kujdes nga lartë poshtë gërmat e para do të gjejë domethënjen reale , vlerën e dashurisë. Pa as më të voglën hiperbolë poeti dibran ecëm në stilin mjeshtëror Lasgushjan, duke na dhënë nëpërmjet vargjeve përshkruese plotë lirizëm, ndjenja, mesazhe,dukuri dhe vlera të cilat i zbulon me shpirtin e tij duke gjurmuar në jetën e njerzve e të karaktereve, duke përshkruar figura , ngjarje, vende e momente që të ngjallin emocione e frymëzim. Poeti Bushi në libër midis të tjerash këndon mjeshtërisht për Kastriotin, Donika Kastriotin, për Migjenin, për Lurën, djemtë e Mokrës, për vallet, për vëllanë, për pemët, për ndryshimin, për pafajësinë, për aministinë, për njerëz të thjeshtë gjurmëlënës si Zenun Fero, për Bardhul Feskaj për moralin, për Sami e Abdyl Frashërin, për Haxhi Vebi Dibra e Nikoll Kaçorri, për zonjën Merkel, për Presidentin Bush i cili erdhi e nderoi Shqiptarët e deri te Komshiu e Durimi e plotë të tjerë: Poeti shkruan bukur vargjet për djemtë e Mokrës:

"Djemtë e Mokrës/ Djemtë e Shqipërisë/ Ruajnë nderin/ Nderin e shtëpisë/A moj Mokër lule-lule/Asnjëherë s'u përkule/ Ke rrit burra me nam/ Si Çorodol e Vemiran"/ (Poezia "Djemtë e Mokrës" faqe/110 strofa 3,4)

Ky libër në të 206 faqet na jep pasqyrën e jetës, dhimbjen njerzore, shpirtin në liri, vlerat e njeriut e demokracisë, luftën ndaj indiferentizmit dhe lartësimin e vlerave. Mbyllet me poezitë " E Vërteta", "Fe e Atdhe", "Ushqimi i Shpirtit", Më i Miri", "Globi", "Gjysëm","Malli i Eminit", "Gëzo Vetë", " Shehërliu"," Pa Shpirt"," Për Ju", dhe "Këngë Malli".

Poeti jep mesazhin : "Zemra reh gjithnji/ Si ka rrahur në jetë/ Gjuha flet si në rini/ Për diçka të vërtetë."/ (Poezia këngë malli faqe/198 strofa 5)

Urime Poeti i dhimbjes dhe i krenarisë së jetës Hysni Bushi!Ju shkruani duke e provuar dhimbjen, lirinë,duke e vlerësuar demokracinë e vërtetë ashtu siç i ka hije poetit të lirisë.

10 vjet gazeta Rruga e Arbërit

ATA E PREMTUAN NDËRTIMIN E RRUGËS SË ARBRIT POR NUK E MBAJTËN FJALËN. NE PUNUAM SË BASHKU PËR GAZETËN "RRUGA E ARBËRIT" DHE E NDËRTUAM PËRMES LIRISË SË FJALËS DHE MENDIMIT, ME PËRKUSHTIM DHE DASHURI!

Abdi Baleta, Abdi Shehu, **Abdurahim Ashiku**, Abdyl Koleci, Adela Halo, **Adem Bunguri**, Adi Darsi, Adrian Blackledge, Afrim Karoshi, Agim Baçi, Agim Boba, Agim Çadri, **Agim Deva**, Agim Gjini, Agim Kaba, Agim Kasa, Agim Shenjatari, Agim Vinca, Agron Sela, **Agron Tufa**, Agron Xhagolli, Agustin Gjinaj, Ahmet Çaushi, Ahmet Kamberi, Ahmet Përleka, Albert Vataj, Albert Zholi, Aleko Minga, Aleksandër Çipa, Ali Hoxha, Ali Koçeku, Ali R. Berisha, Alma Mile, Andi Balla, Andon Andoni, Aneta Cani, Aqif Ademi, Aqif Karaj, Aqif Ymeri, Arbana Qormemeti, Arben Muka, Arbër Lleshi, Ardian Reçi, Ardit Selami, Ardita Abdiu, Aria Sukniqi, Arian Avrazi, Arian Kadiu, Ariola Lami, Arjana Tollja, Arjeta Tafçiu, Armond Duraku, Arqile Teta, Arsim Kolari, Artan Gjyzel Hasani, Artan Hoxha, Artan Lame, Arthur Nelsen, Artin Spahiu, Astrit Balliu, Astrit Gjunkshi, Astrit Hoxha, Atli Dema, Avni Alcani, Axel Kronholm, Baftjar Gazidede, Bajram Hyseni, Bajram Xhafa, Bardhyl Agasi, Bardhyl Berberi, Bardhyl Marku, Bardhyl Xhama, Bashkim Frangu, Bashkim Lami, **Bashkim Lleshi**, Bashkim Rama, Bedri Tahiri, Begzad Baliu, Behar Gjoka, Ben Andoni, Bena Kërluku, Beqir Ajet Shehu, Beqir Sina, Bernard Zotaj, Besnik Alku, Besnik Rama, Blerim Lazimi, Bleta Qormemeti, Bujar Kapexhiu, **Bujar Karoshi**, Bujar Leskaj, Bujar Plloshtani, Bujar Vitija, Dali Horeshka, Dali Noka, Dali Tërshalla, Dalip Greca, Danjel Bica, Dashmir Zaçe, Dashnor Kaloçi, Daut Shehi, Dedë Llesh Doçi, **Defrim Methasani**, Dejang Nova, Denis Lushi, Destan Rama, Dhimitër Shtëmbari, Dhori Qiriazi, **Dionis Xhafa,** Dita Torte, Dragush Totozani, Dritan Bocku, Dritan Murrja, Drite Ademi, Driton Zenku, Dukagjin Hata, Dylbin Reçi, Edibe Selimi - Osmani, Edison Balla, Edison Ypi, Edlira Haxhiymeri, Edmond Hasani, Edmond Zhulali, Eduard Abazi, Eduard Ilnica, Elliot Hasan Moglica, Elmaz Lala, Elona Mazari, Elvana Zaimi, Emrie Skuka, Engjëll Celibashi, Ëngjëll Musai, Enver Halili, Enver Hysa, Enver Kaloshi, Eqrem Basha, Eralda Skarra, Erisa Saraçi, Ermir Dizdari, Ermir Hoxha, Ermira Isufaj, Ermira Shehu, Esat Ruka, Eshref Ymeri, Esmeralda Bica, Esmeralda Ilnica, Eva Gjura, Eva Zaimi, Evi Melani, Faik Bruçi, Faik Prençi, Faik Xhani, Faruk Kaba, Fatbardh Cena, Fatjon Pandovski, Fatmir Delishi, Fatmir Minguli, Fatmir Terziu, Fatmir Zhuzhi, Fatos Baxhaku, Fehmi Lleshi, Fejzulla Gjabri, Femi Sufaj, Ferit Fixha, Fitim Dika, Flamur Hadri, Flora Nikolla, Florika Bushi, Gafur Muka, Gafur Zota, Gafur Zoto, **Gazmend Kërkuti**, Genc Melonashi, Genci Luarasi, Genta Nishica, Geri Selenica, Gëzim Alpion, Gjergj Marku, Gjergji Mima, Gjokë Beci, Gjon Fierza, Gjon Ndreja, Grehans Uka, Hajredin Toca, Hajri Mandri, Hajri Shehu, Hajrush Mani, Haki Duka, Haki Kola, Haki Përnezha, Halil Rama, Halil Robi, **Halil Teodori**, Hamdi Hysuka, Hamdi Skeja, Hamit Taka, Hamit Vata, Hane Burnett, Hasan Leka, Hasan Lleshi, Hasan Pasha, Hekuran Vladi, Hilë Lushaku, Hyqmet Gonxhja, **Hysen Likdisha**, Hysen Mirku, Hysen Repa, **Hysen Uka**, Hysni Bruçi, Hysni Stafasani, Ibrahim Egriu, Ibrahim Kolari, Ibrahim Milushi, Ida Nurçe, Idriz Xhomara, Ilir Krosi, Ilir Sinanaj, Ilir Spata, Ilirjana Sulkuqi, Iljaz Bobaj, Iljaz Kaca, Ilmi Dervishi, Ina & Erta Disha, Ina Xhaferi, Inva Halili – Kuhn, Isa Halilaj, Islam Cani, Islam Çenga, Islam Sharofi, Ismail Hysa, Isuf Miho, Isuf Salla, Iva Cipuri, Ivzi Çipuri, Jahe Delia (Selmani), Jani Thomai, Jera Isakaj, Jorgji Muzaka, Jorgo Bulo, Kadri Dauti, Kamber Faruku, Kastriot Gaka, Keze (Kozeta) Zylo, Klara Kodra, Krenare Ollogu, Kristo Zharkalliu, Kristofor Beduli, Kujtim Boriçi, Kujtim Osmani, Laura Papraniku, Laurant Bica, Lavderim Shehu, Liman Hoxha, Lindita Çela, Lisien Bashkurti, Llazar Semini, Luan Deda, Lulzim Çota, Lutfi Hanku, Lutfi Turkeshi, Mahir Jangulli, Mahmud Hysa, Majlinda Hoxha, Malvina Shehi, Marin Mema, Marius Dobrescu, Mark Tirta, Martin Cukalla, Mehdi Dema, Mehmet Dume, Melsi Tafa, Mendu Dema, Mentas Nasufi, Mentor Hoxha, Meral Ismaili, Mersin Hoxha, Metodija Velevski, Metush Skeja, Mevlud Buci, Mexhit Prençi, Mhill Velaj, Miftar Fana, Mimoza Erebara, Mimoza Shqefni, Mina Hysa, Mira Ymeraj, Miran Tafa, **Miranda Goleci**, Mirela Sula, Mirvet Lala, Moisi Murra, Molnar Kolaneci, Monika Stafa, Muhamet Bitri, Murat Gecaj, Murat Koltraka, Musa Kraja, **Musa Riçku**, Mustafa Tola, Muzafer Korkuti, Myhyr Hoxha, Myslim Islami, Nadire Skënderi (Murra), Naim Berisha, **Naim Plaku**, Naim Zoto, Namik Selmani, Naxhi Hasa, Ndue Dedaj, Nefail Spahiu, Neki Feta, Neki Kaloshi, Nerilda Meda, Nexhi Baushi, Nexhmie Mehmeti, Nikoll Kola, Nikolla Madzirov, Nin Gj. Rajta, **Nuri Abdiu**, Nuri Koleci, Odise Plaku, **Osman Xhili**, Pajtim Përnezha, Pandeli Koçi, Perikli Jorgoni, Përparim Luca, Përparim Spahiu, Përparim Tomçini, Petr Hlobil, Petrit Dunga, Petrit Fetahu, Petro Luarasi, Pjetër Jaku, Qamil Sula, Qazim D. Shehu, Qazim Hata, Qazim Prejsi, Qemal Skendo, Qenan Hasani, Qeram Cibaku, **Rakip Suli**, Ramadan Ajazi, Ramadan Ndreka, Ramazan Biba, Ramazan Buci, Ramazan S. Ilnica, **Ramiz Gjini**, Ramiz Lushaj, Ramiz Zekaj, Rasim Buci, Renato Totraku, Resul Bendo, Rexhep Doda, Rexhep Ndreu, **Rexhep Torte**, Rezehana Hysa, Rifat Malaj, Robert Reci, Roland Çene, Roland Zisi, Rovena Vata, Rozi Theohari, Rremzi Ndreu, Rruzhdi Bitri, Rustem Deva, Ruzhdi Lata, Sabri Cieci, Sadik Lala, Saimir Shatku, Sakip Cami, Sali Ajazi, Sali Bushi, Samet Zagradi, Sami Milloshi, **Sashenka Ndreka**, Sazan Goliku, Sazan Guri, Sefedin Shabani, Sefulla Kata, Sejdi M. Hashi, **Selman Mëziu**, Shaban Bitri, **Shaban Sinani**, **Shaqir Skarra,** Shefki Aliti, Shefqet Hoxha, Shehat Cami, Shehat Marku, Shemsi Daci, Shemsi Manjani, Shemsi Prençi, Sherif Delvina, Shinasi Rama, Shkëlqim Lusha, Shkëlqim Shemsi Hatipi, Shpend Topollaj, Shpetim Cami, Shpëtim Hyka, Shpëtim Pollozhani, Shuaip Marku, Shukri Hajdari, Skënder Minxhozi, Sokol Çobo, Sokol Demaku, Spiro Xhavarra, Srecko Sekeljic, Stephen Schwartz, Suat Saqipi, Suela Lala, Sulejman Borova, Sulejman Tomçini, Syrja Stafa, Tefik Jegeni, Tefik Skera, Tefta Cami, Tefta Nuredini, Thanas Feka, Theodhori Karaj, Ulkie Sinani, Ullmar Qvick, Valbona Zunçe, Valeria Dedej, Valmir Gashi, Valter Shtylla, Vehbi Bajrami, Vehbi Hoti, Veip Proda, Veli Vraniçi, **Vesel Hoxha**, Vezir Muharremaj, Virion Graçi, Viron Kona, Vita Koja, Vojsava Leka, **Xhafer Martini**, Xhafer Seiti, Xhavit Deda, Xheladin Çelmeta, Xhelal Luca, Xhelal Marku, Xhelal Roci, Xhelal Zejneli, Xhelil Cibaku, Xhemail Ali Peci, Xhemal Domi, Xhemal Mato, Xhezair Abazi, Ylber Nuredini, Ylli Molla, Ylli Prapa, Ymer Keta, Ymer Stojku, Zabit Lleshi, **Zaim Elezi**, Zaim Korsi, Zamira Gjeleshi, Zef Çoba, Zejnel Sula

Rruga e Arbërit - aty ku fjalët nuk i merr era!

Bej "**Like**" dhe "**Share**". Qëndro me gazetën #rrugaearberit më pranë #Dibrës!

Rruga e Arbërit rrugaearberit

Për më shumë informacion:
Tel: 00455 68 65 08 441. +355 **68 65 08 441** +355 **69 20 68 603**
Email: rrugaearberit@gmail.com | www.rrugaearberit.com